

# UNIVERSI TETOVË

Vizione për qytetin





# UNIVERSI TETOVË

Vizione për qytetin

[uPolisResearch.com](http://uPolisResearch.com)

© Universiteti Polis  
IKSH & Co-Plan  
Komuna Tetovë  
Tiranë 2010

ISBN: 0000-000-00-0

Universi Tetovë

© Universiteti Polis - Instituti Kërkimor Shkencor IKSH\_POLIS

Rr. "Vaso Pasha", Nr. 20, KP299S  
Tiranë  
Tel. +355 (4) 2 223922 / 2 237236  
Fax. +355 (4) 2 220517  
e-mail: [info@universitetipolis.edu.al](mailto:info@universitetipolis.edu.al)  
web: [www.universitetipolis.edu.al](http://www.universitetipolis.edu.al)



© Co-Plan

Rr. "Vaso Pasha", Nr. 20, KP299S  
Tirane  
Tel. +355 (4) 2 257808 / 2 257808  
Fax. +355 (4) 2 257807  
e-mail: [co-plan@co-plan.org](mailto:co-plan@co-plan.org)  
web: [www.co-plan.org](http://www.co-plan.org)



© Komuna Tetovë

Rr. Dervish Cara pn  
1200 Tetova, R. e Maqedonisë  
Tel: + 389 44 338 081  
Fax: + 389 44 339 420  
e-mail: [info@tetova.gov.mk](mailto:info@tetova.gov.mk)  
web: [www.tetova.gov.mk](http://www.tetova.gov.mk)



Korrektor letrar në shqip : Prof. Naim Balla  
Botues:

Universi Tetova  
Tiranë, korrik 2010  
Tirazhi: 1000 kopje

Drejtues projekti : Ark.Urb. Besnik Aliaj & Ark.Urb. Sotir Dharmo  
Këshillim profesional : Ing.Urb Dritan Shutina  
Grupi i punës : Ark. Giulia Macci, Ark. Sara Rossi  
Olesja Lami, Ina Musai, Eduina Jaup, Gjergji Dushniku, Klaudio Cari  
Asistenca lokale : Ark. Skënder Palloshi (Drejtor) dhe Enti për Urbanizëm  
Tetovë

## Mirënjohje

Komunës Tetovë, Prof. Dr. Sadi Bexhetit (Kryetar)

Entit për Urbanizëm Tetovë, Z. Skënder Palloshi

Z. Arbën Xhaferrit

Studentëve të Universitetit Polis, Tiranë,

Universitetit të Europës Juglindore, Tetovë

Qytetarëve të Tetovës



# Përmbajtja

10	Përse duhet një vizion strategjik për Tetovën? Besnik Aliaj
36	Projekti Universi Tetova Sotir Dhamo
54	Destinacioni Tetovë Eduaina Jaupi
82	Tetova 3T/Porta e re Klaudjo Cari
108	Water flakes Giulia Maci, Sara Rossi
124	Geni Tetovë/Hapësira e gjeneruar Gjergji Dushniku
150	Ekstrakti i hapësirës/Tetova skeleton city Olesja Lami
170	Rrjetat sociale/oda urbane Ina Musai
204	Përmbledhje Ekzekutive







Arbitrim se çka është e drejtë dhe çka s'është e

shkuj bashkëjetonin natyrshëm me shqiptarët

Çdo bisedë që ai zhvillonte atë kohë kishte

lotët nga sytë... **Sinkretizmi E**

procesit të dizenjimit dhe përkufizimit të brand-it të

shtegun e shpëtimit... **fo**

esenca e qytetit... Hipoteza te zhvillim

Gjeneza qytetformuese... **Ho**

të këtë brand-in e vet... **Gravitet**

qytetit... **vlerë antropologjike**

do të jetë këmbësore... **Nuk mund**

te fshehta strategjike... **Që nga aut**

e qytetit... **Shtresa histo**

drejtë... **Modeli i bashkëjeteses...** ne

tarët... a keni ndonjë 'zheni?'...

për temë shkollimin ... nga entuziazmi i dilnin

**European...** new-born... t'i paraprijë

ri të identitetit urban të vendbanimeve shqiptare...

**Formula e mbijetesës...**

nit rajonal... **Porta hyrëse...**

**Apesira gjenerative...** çdo qytet

te territoriale... simbole të

**e...** imazh i ri... Qendra

**nd te eleminojmë...** biseda

tostrada do të duket silueta

**rike...**



Arbën Xhaferri, është një nga liderat politikë me karizmatikë në Maqedoni, dhe një nga intelektualët më me influencë në territoret shqipfolëse e më gjerë. Është një nga ideologët kryesorë të Marrveshjes së Ohrit në Maqedoni 2001, si një akt stabiliteti për gjithë rajonin e Ballkanit. Sot i tërhequr nga politika aktive Xhaferri vijon të mbetet një referencë tepër e rëndësishme intelektuale e sociale për mbarë shqiptarët në rajon përmes prezencës në media dhe shtypin e shkruar.

## "NË KËRKIM TË GJENIUT"

Nga Arbën XHAFERRI

Daja im, ndjesë pastë, ishte 17 vjeçar kur, si shumë të rinj tetovarë u bë 'vullnetar' gjatë Luftës së Dytë Botërore për të mbrojtur lirinë e vendlindjes së tij. Pas kësaj aventure prej minoreni, ku përziheshin bashkë "gjermanët e Hitlerit" dhe "partizanët jugosllavë", ai u ballafaqua me një përvojë e re ku "fitimtarët" përmes instrumentave djallëzorë ideologjikë filluan procesin e spastrimit të terrenit nga "armiqtë" e vendit.

Ashtu si në çdo periudhë historike edhe sot e gjithë ditën, luftërat fillojnë dhe përfundojnë me fitimin e të drejtës për përkufizim të zhvillimeve shoqërore, ose thënë më qartë për arbitrim se çka është e drejtë dhe çka s'është e drejtë. Të fortit gjithmonë i imponojnë botëkuptimet e tyre.

Siç mund të parashikohej të drejtën e gjykimit sërish e fituan popujt sllavë, që në fakt me shekuj bashkëjetonin krejt natyrshëm me shqiptarët si të barabartë. Por dajën tim dhe të tjerë nacionalistë, ata i shpallën menjëherë si armiq të rrezikshëm, kundër-revolucionarë, rrënues të paqes, të rendit e të pushtetit popullor. E rrihnin çdo ditë, sistematikisht, derisa i gjori arratiset dhe gjen prehje në një ishull dalmatin - Braç.

Atje arrin të rikuperohet, deri sa bëhet modelist kryesor i një firme të njohur jugosllave - Jugoplastika. Duke u konfrontuar asokohe me zhvillimin marramendës të Dalmacisë në krahasim me vendlindjen e vet, ai kërkonte në heshtje shkakun për katandisjen në qytetar të klasit të dytë, të popullit të vetë të cilin e adhuronte. Shkakun e shkaqeve ai, si shumë të tjerët të ndjeshëm për të drejtat njerëzore të popujve, e gjente te niveli dhe cilësia e ulët e shkollimit. Çdo bisedë që ai zhvillonte atë kohë kishte për temë

shkollimin! Sidomos me mua kishte kërkesa të larta. Madje shpesh më kërkonte që t'i tregoja se a ka në mesin e studentëve shqiptarë "zheni". Por sa herë që tentoja t'ia imponoja variantin shqip të shqiptimit të kësaj fjale - "gjeni" - ai shtirej se nuk ka dëgjuar. Se di pse forma e gjuhës frënge i dukej më e besueshme për simbolikën e fjalës...

Kështu, gjithmonë kur takoheshim, gjenim mënyra që të rrinim vetëm dhe të hapnim temën e ndonjë studenti "zhenial", demiurgut të ri, shpëtimtarit, i cili do të gjente rrugën e rimëkëmbjes sonë si popull... Mбай mend se daja tentonte t'i jepte më shumë rëndësi shkencave natyrore, fizikës, matematikës, kimisë, por nuk e linte pa hulumtuar sektorin e kulturës, krijimtarinë kombëtare, etj.

Ishte kjo arsyeja pse në këto takime "biseda të fshehta strategjike", unë përgatitesha seriozisht, thujse si për provime, ngaqë ndoshta e respektoja shumë personalitetin dhe përkushtimin e tij ndaj çështjes kombëtare. Kështu në një farë mënyre sa herë që takoheshim gjatë pushimeve detyra ime ishte "raportimi vjetor" për zhvillimet në vendlindje në të gjithë segmentet e shoqërisë asokohe. Dhe pas "referatit" tim natyrisht që i vinte radha atij, dhe pyetjes së tij të pashmangshme "... mirë, mirë, por a keni ndonjë 'zheni?'"

Unë në kohë paqeje "zhenitë" i gjeja në fushën e kulturës dhe deri diku tek sporti, ndërsa në kohën e ngatërresave (tensioneve sociale/etnike) i shikoja në fushën e shkencave natyrore, si fizika, matematika, kimia, etj. Ndërkohë që për dajën tim "zhenitë" më të preferuar të tij mbeteshin studentët e degëve të rralla dhe specializuara të fizikës...

E kështu historia vijoi me vite, ku unë nga ana ime bëja shumë kujdes që të mos i shndërroja këto relacione tepër serioze në komedi... Ndërsa sa herë që e përfundoja rrëfimin tim, atij nga entuziazmi i dilnin lotët nga sytë, ashtu si edhe mua nga keqardhja për të, dhe për fiksimin e tij për çështjet kombëtare...

E pra sot e kësaj dite nuk di se çka mori ai prej meje, por e di fare mirë se çka mora unë prej tij: përkushtimin tipik të shqiptarëve të këtyre anëve për çështjet kombëtare. Sepse të them të vërtetën të gjithë së bashku dhe vazhdimisht ne jemi duke kërkuar atë GJENIUN, new-bornin, që do të na nxjerrë një ditë në rrugë të mbarë...

Rasti e solli kur isha për vizitë në Universitetin POLIS të Tiranës, me rastin e dhënies së Çmimit "Lidershipi Shqiptar" si mirënjohje për veprimtarinë time politike, të kisha mundësinë të mbaja një ligjëratë për zhvillimet sociale dhe politike në rajon, dhe vetvetiu më kaploi një pikëllim, madje do të thoja një dëshpërim, sepse nuk e kam dajën aty afër ose kudo qoftë, por të gjallë, e që me mburrje t'i them se kam zbuluar një varg "zhenish", djemsh dhe vajzash, që, si kudo në botën e kulturuar, i ndiqnin mësimet në kushte dhe në një kontekst intelektual të mrekullueshëm, të ngjajshëm me ambientet më avangardë të Evropës...

Në POLIS çdo gjë mu duk vërtetë bashkëkohore: ambienti, studentët, profesorët, të ftuarit. Pyetjet që m'i bënin studentët më befasuan dhe dëshmonin se emocionet e mia nuk ishin paragjykime, por një realitet i ri i arsimit cilësor, një plotësim i ri i ëndrrave të vjetra. Realiteti që përjetova më çliroi edhe nga një peng i madh moral: O Zot, nuk e paskam 'mashtuar' dajën tim, i cili lypte me dëshpërim dhe shpresë shtegun e shpëtimit... Për më tepër rrëfimet e mijë nuk kishin qenë aspak trillime e aq më tepër komike, por parashikime realiste...

Me drejtuesit dhe profesorët e këtij universiteti shumë shpejt gjeta një gjuhë të përbashkët. Parashtrova temën që e intrigon çdo urbanist, çdo arkitekt: mundësinë që çdo qytet të ketë identitetin e vet, ose siç thuhet në gjuhën e sotme, brand-in e vet, ashtu si kanë filluar të bëjnë, bie fjala përsëri kroatët, etj.

Duke marrë parasysh se Shqipëria ka perspektiva të mëdha zhvillimi (sidomos turistike), ajo bashkë me hapësirat më kontinentale në Kosovë dhe Maqedoni, dhe përmes kuadrove e profesionistëve të saj më të mirë, i takon detyra që t'i paraprijë procesit të dizenjimit dhe përkufizimit të brand-it të ri të identitetit urban të vendbanimeve shqiptare dhe përmes kësaj të japë një kontribut tepër të çmueshëm për korrigjimin e imazhit të vjetër të shqiptarëve...

Ndërsa në Shqipëri dhe Kosovë motivin për këtë "Projekt të ri" duhet t'a kërkojmë në interesin ekonomik, në Maqedoni dhe në viset tjera ku jetojnë shqiptarët motivin duhet t'a kërkojmë pikërisht në rrafshin kulturor!

Një model shpresëdhënës tashmë e konstatova ku pedagogët dhe studentët "zhenial" të POLIS-it, punuan disa muaj rresht në Tetovë e Tiranë përtej interesave banale të një obligimi shkollor, dhe në përfundim e hartuan dhe e paraqiten publikisht me sukses projektin 'UNIVERSI TETOVE'...

... Referues ishin edhe studentë me origjinë italiane e maqedonase... Mrekulli! Por jam i sigurtë se daja im do të kërkonte tashmë edhe më shumë...



Përse duhet një Vizion Strategjik dhe Inspirues për Tetovën?

Dr.Besnik Aliqj

### Parathënie

Në fillim të vitit 2010, drejtuesit e Entit për Urbanizëm, Komuna Tetovë, morën kontakte me drejtuesit e Universitetit POLIS, Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Politikave të Zhvillimit Urban, si dhe me Njësinë e Specializuar Kërkimore të këtij Universiteti, Institutit për Zhvillimin e Habitatit Co-PLAN.

Co-PLAN ([www.co-plan.org](http://www.co-plan.org)) është një institut profesional joqeveritar me reputacion, që operon prej mbi 15 vitesh në Shqipëri dhe rajon në fushën e planifikimit dhe të administrimit të territorit, duke punuar me komunitetet dhe autoritetet vendore, apo me qeveritë qendrore dhe institucionet ndërkombëtare.

POLIS ([www.universitetipolis.edu.al](http://www.universitetipolis.edu.al)) është një institucion alternativ i arsimit të lartë privat, që është themeluar mbi bazën e përvojës intelektuale-profesionale të Co-PLAN nga një grup akademikësh dhe ekspertësh të fushave





të arkitekturës, planifikimit urban dhe administrimit të mjedisit që kanë studiuar në Shqipëri, vendet e BE-së dhe SHBA-së. POLIS është institucion arsimor i licensuar dhe akredituar nga MASH/APPAL. Ai është përfshirë në database-in e UNESCO-s dhe "Kartes së Bolonjës" (Magna Carta Universitatum), si dhe është anëtar me të drejta të plota i Shkollave Europiane të Arkitekturës (EAAE) dhe të Planifikimit Urban (AESOP).

Komuna Tetovë ra dakord të angazhojë 3 ekspertë dhe drejtues të POLIS/Co-PLAN: MSc.Ark.Urb.Sotir Dhamo dhe Dr.Ark.Urb.Besnik Aliaj, si koordinatorë të projektit; dhe MSc.Ing.Urb.Dritan Shutina si konsulent i projektit. Së bashku ekspertët do të asistojnë Zyrën për Urbanizëm në Tetovë për hartimin e një dokumenti mbi vizionin strategjik të zhvillimit të qytetit të Tetovës. Ky dokument së bashku me Termat e Referencës – që do të hartohen nga ekspertet Ark.Urb.???? Graçevski, dhe Ark.Urb.Jasmina ???, pedagoge në Shkollën e Arkitekturës, Universiteti i Shkupit – do të përbëjnë dokumentet bazë për hartimin e Planit të Përgjithshëm Gjeneral Regullues të Komunës Tetovë përmes konkurrimit publik.

Duke qenë se mundësitë financiare të Komunës Tetovë për ekspertizë të kualifikuar ishin të kufizuara, POLIS/Co-PLAN vendosën me vullnet të mirë ta subvencionojnë iniciativën e procesit të hartimit të dokumentit strategjik-vizion, duke e përfshirë atë në kuadër të punës së Institutit Kërkimor Shkencor IKSH pranë Universitetit POLIS. Në këtë kuadër u ngrit një ekip pune

prej 10 ekspertesh, kërkuesish dhe studentësh, ku përveç tre koordinatorëve drejtues u përfshinë edhe kërkueset italiane Ark.Giulia Maci dhe Ark. Sara Rossi, si dhe studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajnit Urban: Olesja Lami, Ina Musaj, Eduina Jaup, Gjergji Dushniku dhe Klaudio Cari. Ky ekip ka bashkëpunuar ngushtë me drejtuesin e Zyrës për Urbanizëm në Tetovë, Ark. Skënder Palloshin, dhe kolegë të tjerë të kësaj zyre pranë Komunës së Tetovës.

Metodologjia e aplikuar për hartimin e dokumentit "Universi Tetova" përfshin 4 misione pune në terren në Tetovë dhe 3 periudha pune të ndërmjetme në Tiranë:

### **1. Kontaktimi në Tiranë nga Komuna Tetovë, janar 2010**

Z. Skënder Palloshi viziton POLIS/Co-PLAN në Tiranë. Palët diskutuan dhe ranë në ujdë për formën, termat dhe afatet e bashkëpunimit.

### **2. Punë përgatitore dhe kërkimore në Tiranë I**

Kërkime në literaturë dhe internet mbi Tetovën, Maqedoninë, dhe sistemin e planifikimit e zhvillimit urban në këtë vend. Studim dhe referim ndaj "Planit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë". Raste studimore: Tirana Metropolis, Instituti Berlage, Holandë 2004 etj.

### **3. Misioni i parë në Tetovë, 18-21 shkurt 2010**

Koordinatorët B.Aliaj, S.Dhamo, D.Shutina zhvillojnë një mision identifikimi dhe faktesh në terren në Tetovë. Takim me kryetarin e Komunës, Z.Sadi Bexheti dhe me drejtues institucionesh publike e private. Takim koordinues me ekspertët e Zyrës për Urbanizëm dhe ata të hartimit të Termave të Referencës Z.???? Gerçevski, dhe Znj.Jasmina ????.

### **4. Punë përgatitore dhe kërkimore në Tiranë II**

Ngritja e grupit të punës me 10 ekspertë dhe studentë. Ndarja e detyrave dhe tematikave. Kërkim literature dhe konceptimi i ideve paraprake. Mision i ndërmjetëm verifikues në Tetovë nga 2 ekspertë të ekipit.

### **5. Misioni i dytë në Tetovë, 10-13 mars 2010**

Thellim i kuptimit të Tetovës nga ekipi i ekspertëve dhe studentëve. Analizimi i qytetit në 4 rajone; identifikimi i problematikës dhe potencialeve; intervista kualitative me banorë, ekspertë të komunës dhe persona të rëndësishëm në çdo rajon të qytetit. Dokumentim i gjetjeve dhe inspirimeve paraprake.

### **6. Punë përgatitore dhe kërkimore në Tiranë III**

Përpunim i mëtejshëm i ideve dhe diskutim në grup për të koordinuar. Organizim i Këshillit Teknik të POLIS/Co-PLAN për të analizuar në mënyrë kritike idetë. Rishikim dhe evoluim i ideve. Përgatitje për misionin e radhës.

### **7. Misioni i tretë në Tetovë, 30 prill - 03 maj 2010**

Një ekip prej 30 ekspertësh dhe studentësh të POLIS/Co-PLAN zbatojnë në bashkëpunim me Zyrën për Urbanizëm dhe studentët e Universitetit të Europës Juglindore në Tetovë një pyetësor kualitativ për të tërhequr mendimin e banorëve të Tetovës mbi gjendjen aktuale dhe të ardhmen e qytetit.

Ndarja e qytetit në 25 zona/njësi. Zhvillimi i intervistave rastësore në çdo zonë dhe dokumentimi i kontekstit urban përmes fotografimit. Tur në akset kombëtare dhe qytetet kryesore të Maqedonisë për të kuptuar Tetovën në raport me nivelin metropolitan, kombëtar dhe rajonal. Hapja e një blogu për Tetovën në internet ([www.upolisresearch.com](http://www.upolisresearch.com)).

#### **8. Punë përgatitore dhe kërkimore në Tiranë IV**

Detajimi i projektideve. Organizim i Këshillit të dytë Teknik të POLIS/Co-PLAN për të analizuar në mënyrë kritike projektin. Hartim i projektdokumentit vizion dhe i prezantimeve publike.

#### **9. Misioni i katërt në Tetovë, 21-24 korrik 2010**

Prezantimi publik i vizionit “Universi Tetova” dhe marrja e komenteve nga qytetarët, komuna, grupet e interesit dhe profesionistët. Dorëzimi i draft raportit për koment nga Komuna Tetovë.

#### **10. Finalizimi i dokumentit vizion, shtator 2010**

Rishikimi, përfshirja e komenteve të vlefshme, finalizimi i vizionit “Universi Tetova” nga POLIS/Co-PLAN. Botimi nga Komuna Tetovë në gjuhët shqipe, maqedonishte e anglishte. Prezantimi publik i botimit në Tetovë e Tiranë.

Është e rëndësishme të kuptohet se ky dokument në vetvete nuk përfaqëson Planin Rregullator Urban. Ai është vetëm një vizion profesional që përfaqëson një moment reflektimi, analizë dhe inspirim për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e qytetit. Është një dokument vizion që shërben për frymëzim dhe orientim tek ekipi teknik që do të shpallet fitues i garës/tenderimit, dhe që shpesh për shkak të afateve kohore fokusohet ngushtë në dimensione teknike dhe ligjore. Dokumenti shërben për të artikuluar sa më mirë profesionalisht vizionin e Komunës Tetovë si dhe objektivat politikë të Kryetarit të Komunës dhe të Këshillit Komunal. Ky dokument, së bashku me materialet plotësuese/anekse dhe me Termat e Referencës që do të hartohen më pas, do të përbëjnë në një farë mënyre “kushtetutën”, që do të udheheqë hartimin e planit rregullator dhe zhvillimor urban të Tetovës me koncepte bashkëkohore.

Grupi realizues i këtij dokumenti falënderon në mënyrë të veçantë Kryetarin e Komunës, Prof.Dr. Sadi Bexheti; drejtuesin e Entit për Urbanizëm në Tetovë, Z. Skënder Palloshi, si dhe stafin teknik të këtij enti; studentët e Universitetit të Europës Juglindore në Tetovë, dhe partnerët e tjerë lokalë që mbështetën me ide, informacione dhe intervista, sidomos këshillat e veçanta të karakterit konceptual nga Z. Arbën Xhaferri.



## Hyrje

...Kur i përfaqesohet një qyteti të fillimshkullit XXI, nuk të bëhet ta përshkruash me shprehje idilike romantike të së kaluarës historike, me përjashtim të rasteve të rralla...

...Në fakt një qytet modern është si një frut i tej pjekur. Lëkura dhe tulli i frutit janë periferitë, në pjesën më të madhe të pakonsoliduara dhe ende në zhvillim. Shpesh ato janë aq të shëmtuara, sa duhet të bësh goxha rrugë për të mbërritur tek bërthama e vjetër, ose tek zemra e qytetit...

...Për fat prirja për modernizëm në disa prej qyteteve historike nuk ka prekur krejtësisht bërthamat historike. Kupolat, minaretë e xhamive, kambanoret e kishave, ndërtesat tradicionale, pazaret etj, shpesh i fshihen syrit të udhëtarëve e vizitorëve midis kullave prej betoni dhe çeliku. Këto kulla duket sikur i thërrasin nga majat e tyre zemëratës së Zotit në tokë, sepse me agresivitetin e tyre kanë lënduar kaq vrazhdë Parajsën e Tij tokësore...<sup>1</sup>

Tetova është deri diku një qytet i tillë, sepse për fat të keq shumica e kalimtarëve dhe udhëtarëve e kundrojnë dhe e përceptojnë atë kryesisht nga distanca, dhe zakonisht përmes unazave periferiko-tangenciale, apo në rastin më të mirë nga rruga kryesore që është si një lloj tuneli me mure massive urbane anash, e cila edhe pse depërton në qytet, në fakt nuk të lejon të shikosh e kuptosh në thellësi...

...Të paktë janë ata që arrijnë të depërtojnë në brendësi të qytetit dhe sidomos në bërthamën e tij të mrekullueshme historike. Përndryshe, ata që e bëjnë këtë gjë, zakonisht befasohen nga mospërputhja që ka imazhi i vakët sipërfaqësor me pasuritë dhe potencialet e jashtëzakoshme që ka në të vërtetë Tetova.

<sup>1</sup> Përshtatur nga: Tessa De Loo. Wen varken in het paleis. Bureau Stijl Zorg, Utrecht Nederland, 1998.



## Pak histori

Tetova është qytetet-qendër i komunës me të njëjtin emër në fushën e Pollogut në Maqedoni. Në këtë luginë mjaft të pasur bujqësore lartësohet masivi i Sharrit, dhe gjarpëron lumi i Vardarit, historikisht dy burime të jashtëzakonshme jete dhe mirëqenieje jo vetëm për Tetovën, por edhe për gjithë vendin.

Shumë historianë të sotëm të antikitetit në rajonin Tetovë në publikime zyrtare e lokalizojnë qytetin Ilir të Oaeneumit si pikënisje të 'big bang-ut' të sotëm urban. Me kohë, trashëgimia pagane e banorëve të zonës pasurohet gradualisht përmes besimit të krishterë, ndërsa gjithmonë e më shumë banorë nga zonat malore filluan të zbresin poshtë në brezin e ndërmjetëm të kontaktit fizik të malit me fushën. Ky status duket se favorizonte aksesin e shpejtë, shfrytëzimin e potencialeve bujqësore dhe blegtorale, si dhe mbrojtjen e nevojshme në kohë pasigurie.

Në shek. XI Tetova bie në sy mes vendbanimeve të tjera të zonës, kurse në shek. XIII-XIV përmendet si vendbanimi kryesor në luginën e Pollogut. Procesi i islamizimit në Tetovë dhe rrethina filloi në fund të shek. XVI, duke e pasuruar edhe më shumë larminë fetare të zonës. Gjatë kësaj periudhe Tetova njihet me emrin Kalkandelen (turqisht).

Nga gjysma e parë e shek. XIX Tetova raportohet të kishte rreth 5,000 banorë dhe 210 dyqane, gjë që dëshmon se qyteti ishte një nga qendrat më të rëndësishme të tregtisë jo vetëm në tregun shqiptaro-maqedonas, por dhe më gjerë në rajon. Në këtë kohë Tetova referohet si një qendër rajoni bujqësor dhe artizanal, përfshi prodhimin e pushkëve. Popullsia e Tetovës dhe e gjithë rajonit të Pollogut përfshihet aktivisht gjatë shek. XIX deri në vitin 1912 në lëvizjen për pavarësi nga Perandoria Osmane.

Gjatë Luftës I Ballkanike dhe më pas, Tetova përfshihet nën administrimin e Mbretërisë së Serbisë. Ndërsa gjatë Luftës II Botërore qyteti dhe rrethinat

përfshihen në territoret nën zotërimin e Italisë dhe më vonë të Gjermanisë fashiste. Në këtë periudhë popullsia e Tetovës ka qenë aktive edhe në rezistencën antifashiste në rajon, Maqedoni dhe më gjerë në ish-Jugosllavi. Gjatë kësaj kohe popullsia e Tetovës arrin deri në 19,000 banorë, dhe statusi i qytetit ngrihet deri në qendër prefekturë. Në vitet '30 evidentohet dokumentimi deri diku modern i zhvillimit urban dhe pronësor përmes një sistemi kadastral të arshivuar edhe sot.

Pas Luftës II Botërore, Tetova bëhet një qendër e rëndësishme urbane e Republikës së Maqedonisë, si pjesë e Federatës Jugosllave të kohës, edhe pse problemet ekonomike dhe sociale mbetën kronike. Për të atakuar këto probleme autoritetet e kohës hartojnë plane zhvillimore të qytetit, përfshi disa iniciativa në vitet '50 dhe sidomos në vitet '80. Objektet më të rëndësishme ekonomike të Komunës së Tetovës që u zhvilluan në këtë periudhë janë: Kombinati i Tekstilit dhe ai Elektro-metalurgjik, fabrikat e



konfeksioneve, e drurit, e plastikës, dhe lekurëve etj. Sidoqoftë, papunësia mbeti një problem shqetësues, duke inkurajuar emigrimin e një përqindjeje të lartë të popullsisë.

Sipas regjistrimit të vitit 1981, në Komunën e Tetovës jetonte një popullsi prej mbi 150,000 banorësh, kryesisht shqiptare, si dhe një komunitet banorësh maqedonas, që e pasuron dimensionin demografik të qytetit. Burime të sotme të Komunës flasin për një popullsi aktuale prej rreth 250,000 banorë, ndërsa së bashku me komunën dhe fshatrat e Gostivarit bëhet fjalë për një aglomerim urban prej rreth 400,000 banorësh. Sot Tetova është një nga 4-5 qytetet kryesore në Maqedoni. Ajo është padyshim qyteti më i rëndësishëm për shqiptarët në këtë vend, dhe ndoshta një nga 3 kryeqendrat urbane kryesore shqipfolëse, pas Tiranës dhe Prishtinës.






**Base Map of Southeastern Europe**  
 Including infrastructure and political boundaries

- |  |                        |  |                     |
|--|------------------------|--|---------------------|
|  | International boundary |  | 500,000             |
|  | Republic boundary      |  | 1 million or more   |
|  | Autonomous boundary    |  | 10,000 to 1 million |
|  | Intensity boundary     |  | 20,000 to 100,000   |
|  | Motorway               |  |                     |
|  | Road                   |  |                     |
|  | High speed rail        |  |                     |
|  | Water                  |  |                     |
|  | Island                 |  |                     |

Scale: 1:6,000,000  
 Largest Scale: 1:1,000,000  
 Smallest Scale: 1:10,000,000

Source: CIA World Factbook, 2007; CIA World Factbook, 2007; CIA World Factbook, 2007





UKRAINE

MOLDOVA

ROMANIA

BUCURESTI

BULGARIA

BLACK  
SEA

MACEDONIA  
(R.O.M.)

TURKEY

GREECE  
AEGEAN  
SEA



## Tetova: Korridoret dhe kryqëzimet

Edhe pse pa kontakte direkte me detin, Maqedonia ka një pozicion tepër strategjik dhe qendror në rajonin e Ballkanit, përfshi këtu disa akse ndërkombëtare rrugore me rëndësi mbareuropiane, si Korridori 8 dhe 10. Këto korridore rrugore të fuqishme ndërkombëtare kryqëzohen në rajonin e kryeqytetit, dhe formojnë një lloj skeleti kombëtar "cardo-decumanus" për zhvillimin e Maqedonisë në tërësi. Për më tepër, degëzimet lokale dhe rajonale të këtyre korridoreve i ofrojnë Maqedonisë jo vetëm një lidhje të shpejtë me Europën, por edhe me rajonin, duke kompensuar mjaft mirë një menu të pasur aksesit edhe në hapësirat detare portuale shqiptaro-malaziasë në Perëndim; ato helene në Jug; turko-bullgare në Lindje; si dhe me hapësirat kroato-serbo-rumune në Veri të Ballkanit dhe më tej.

Por, përveç këtyre korridoreve moderne pikëprerja e të cilave është Shkupi, Maqedonia ka në përdorim edhe të paktën dy korridore historike disi të palexueshme, të cilat pjesërisht ndërthuren me korridoret moderne dhe pjesërisht duhen zbuluar ose rilexuar. Këtu futen degëzimi maqedonas i korridorit historik lindje-perëndim "Via Egnatia" dhe kryqëzimi me "Korridorin Otoman" Stamboll-Sarajevë, të cilët kryqëzohen pikërisht në Tetovë. Korridori i fundit mori rëndësi sidomos kur mbretëria serbe dhe ajo greke fituan pavarësinë nga Perandoria Osmane, duke imponuar nevojën për një komunikim alternativ nga Stambolli në Sarajevë përmes një ure strategjike Tetovë-Prizren-Pejë. Krijimi i ish-Jugosllavisë dhe zhvillimet pas Luftës II Botërore e zbehën rëndësinë e këtij kryqëzimi alternativ. Ndërkohë zhvillimet gjeopolitike në rajon pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe procesi i integritetit të Ballkanit në BE, e kanë rihapur mundësinë për reflek-




tim edhe në këtë pikë. Me pak fjalë  
 nya e kryqëzimit rajonal në Tetovë  
 dhe nya e kryqëzimit mbareuropian  
 në Shkup jo vetëm që nuk e konku-  
 rrojnë, por plotësojnë më mirë njëra-  
 tjetrën në se do të alernoheshin midis  
 tyre. Ndërkohë që në këndvështrimin  
 e aglomerimit urban të Pollogut këto  
 akse alternative rrugore me im-  
 pakt rajonal (Tiranë-Tetovë-Kaçanik  
 dhe Shkup-Tetovë-Prizren) përbëjnë  
 gjithashtu një lloj "cardo-decumanus-  
 i" lokal për zhvillimin komunal dhe  
 urban të Tetovës.

**Tetova: Diversiteti Urban rajonal**

Maqedonia si shtet karakteriozohet  
 deri diku nga një kompaktësi terri-  
 toriale ku bie në sy në qendër të saj  
 një korridor qarkullimi ekonomik gati  
 rrethor: Shkup-Velez-Negotino-Prilep-  
 Bitola-Kërçovë-Gostivar-Tetovë-Shkup.  
 Kjo unazë rrugore përbën aortën e  
 kompaktësisë kombëtare territoriale,  
 të qarkullimit të mallrave dhe njerëzve,  
 dhe unifikimin e etnive shqiptare e  
 maqedone. Në qendër të saj ngrihet  
 një masiv malor me potenciale mjaft  
 të mira ekonomike pyjore e ujore,  
 ndërsa rrotull saj shquhen 4 rajone  
 ekonomike me potenciale intere-  
 sante të zhvillimit ndërkufitar rajonal.  
 Këtu futen rajonet ndërkufitare: 1)  
 Kumanovë-Shkup-Tetovë dhe raporti  
 i tyre me Kosovën dhe Serbinë; 2)  
 Dibër-Strugë-Ohër dhe marrdhëniet  
 me Shqipërinë; 3) Bitola-Negotino-  
 Gevgelia dhe raporti me Greqinë;  
 4) Strumica-Stip-Kriva Palanka dhe  
 raporti i saj me Bullgarinë.

Sidoqoftë, në kuptimin e rëndësisë  
 ekonomike mund të dallohen tri  
 përqëndrime kryesore urbane: 1)  
 Metropoli Tetovë-Shkup-Aeroport, me  
 rrezatim potencial në Gostivar, Ku-  
 manovë dhe Velez; 2) Rajoni turistik

Maqedonia dhe marrëdhëniet portuale në Rajon



Korridoret historike në Ballkan



Korridoret kryesore aktuale në Ballkan



i Ohrit me impakt në Prespë dhe Dibër; 3) dhe binomi urban Bitola-Prilep me ndikim në Demir Hisar dhe Krushevo.

Përsa i takon **Metropolit Shkup-Tetovë-Aeroport**, për fat ai bashkon dy kryeqendrat e etnive kryesore (maqedonase dhe shqiptare), duke formuar një aglomerim urban të mirëproporcionuar prej rreth 1 milion banorësh, dhe që ka nevojë të funksionojë si i tillë për të siguruar një ekonomi të qëndrueshme dhe të stabilizuar. Dhe në se vetë Shkupi si qytet paraqet një strukturë urbane disi kompakte për shkak edhe të trashëgimisë moderniste, Tetova nga ana tjetër, ka një diversitet dhe larmi formash urbane rajonalo.

Por përtej konceptit metropolitan, kur flet për Tetovën mund të mendosh për një sërë formash dhe strukturash, si: për **Aglomerimin Rajonal të Pollogut** (Komunat Gostivar e Tetovë bashkë); ose për **Qytetin Linear të Sharrit** (gjithë fshatrat dhe qendrat e banura nga Recane-Tetova-Jazince); ose për **Binomin Urban Gostivar-Tetovë** të lidhura me një autostradë+ hekurudhë aksiale, por edhe me një rrugë rurale lokale unazore rrëzë maleve që rrethojnë luginën e Pollogut. Ndërkohë që duke vrojtuar me pak vëmendje në Google Earth mund të konstatosh dhe flasësh edhe për **Qytetet Binjake Tetovë-Prizren** të cilat duken sikur janë dy gjysma identike të një entiteti të vetëm urban që ndahen nga mali i Sharrit, por që tentojnë të bashkohen nga luginat e lumenjve që i përshkojnë dhe pellgjeve ujëmbledhëse respektive. Pikërisht ky diversitet i pasur urbano-rajonalo si dhe lidhja e pasur me burimet ujore (mali, bora, lumi etj) përbëjnë krahas pozicionimit strategjik po-

tencialin dhe avantazhet më të forta për Tetovën sot dhe në të ardhmen.

### Tetova: Një lajtmotiv urban

Po t'i referohemi konstatimeve të mësipërme, Tetova si qytet më vete siç duket, e ka zanafillën e vet pikërisht aty ku lumi i Shkumbinit, që zbret vrullshëm nga mali i Sharrit, takohet me fushën e Pollogut. Tamam këtu ndodh drama, konflikti, që krijon energjinë e duhur qytetformuese. Uji shpërndahet në fushë përtej shtratit të tij kryesor, përmes kanaleve dhe vijave provizore në varësi të motit, stinës dhe prurjeve. Këto rrëkeza ujore shpërhapen në territorin fushor të Pollogut në formën e rrezeve radiale të një gjysmë rrethi, dhe pikërisht pikëprerja e tyre është origjina e qytetit, atje ku formohet tregu dhe kryqëzohen rrugët historike Veri-Jug (Shkup-Tetovë-Prizren), apo rruga rrëzë Sharrit Lindje-Perëndim (Gostivar-Tetovë-Jazincë). Kjo skemë provohet edhe nga përsëritja me dhjetëra herë përgjatë gjithë Qytetit Linear të Sharrit pothuaj në çdo fshat dhe qendër të banuar, edhe pse në përmasa më të vogla.


Pra, lumi Shkumbin dhe rruga Veri-Jug (Shkup-Tetovë-Prizren) me hapësirat rrotull janë aksi kryesor që provokon zhvillim urban. Nga ana tjetër, kryqëzimi i këtij aksi me korridorin historik Lindje-Perëndim (Raçice-Carshi-Poroj) lidh me qendrat e tjera dhe materializon tregun, komunitetet kryesore dhe objektet fetare. Nuk ka rëndësi gjuha, besimi apo raca e njerëzve. Kjo hapësirë është pikë takimi, kompromisi dhe shkëmbimi ekonomik e kulturor. Është një hapësirë urbane konsensuale që mbart genin qytetformues të Tetovës.





JAZINCE

CITY





AGLOMERIMI URBAN  
I POLLOGUT

AR


Me kalimin e viteve dhe duke u zhvilluar çdo ditë e më shumë, qyteti zbret natyrshëm e gradualisht në fushë. Qendra gjithashtu zhvendoset dhe zgjerohet po në këtë drejtim përgjatë aksit Veri-Jug. Më vonë një rrugë e re zhvillohet poshtë në fushë paralele me rrugën historike rrëzë Sharrit. Ndërsa lidhja Gostivar-Tetovë-Shkup përforcohet me tri unaza tangjenciale që i largohen gjithnjë e më shumë bërthamës historike.

Ndërrhyrjet urbanistike të ekonomisë së centralizuar fokusohen kryesisht në këtë sektor me formë thujse trekëndëshe, midis dy radialeve kryesore të qytetit (Ilindenska e Marshall Titos) dhe unazës periferike e hekurudhës. Pas origjinës organike të bërthamës historike të Tetovës, ky sektor i qytetit përfshin eksperimentin kryesor urban modernist-socialist të ish-Jugosllavisë, ku pjesë periferike të qytetit tradicional prishen për t'i lënë vend qytetit industrial dhe atij modernist, si një tentativë e dështuar për të maskuar vernakularitetin e origjinës dhe bërthamës historike. Ky pra është imazhi i sotëm sipërfaqësor i trashëguar në Tetovë, imazh i cili më shumë se inkurajues është një dekurajim për të eksploruar vlerat e jashtëzakonshme të Tetovës. Kjo situatë duhet ndryshuar...

Ndryshimet pas viteve '90, dhe sido mos mungesa e stabilitetit politik të Maqedonisë në fillim të viteve 2000, lanë gjurmë të forta në qytet duke e përkeqësuar situatën. Urbanizimi i shpejtë dhe informaliteti i egër ka virusuar ndërkohe ADN-në e qelizës urbane të qytetit në kurriz të interesit dhe hapësirës publike. Administrata e re e Komunës Tetovë aktualisht po kërkon pikërisht ta diagnostikojë dhe kurojë zhvillimin e deritanishëm urban, dhe t'i paraprijë zhvillimeve







të reja me një vizion, plan dhe instrumente zhvillimi urban bashkëkohor.

### Universi Tetova: Një vizion zhvillimi

Ekipi që ka punuar për këtë dokument strategjik zhvillimi ka pasur fatin ta eksplorojë Tetovën në një spektër të gjerë kohor dhe ngjyrash, që koha dhe Zoti i kanë falur këtij qyteti: nga bora masive e dimrit tek gjelbërimi impresionues i verës. Ky ishte një rizbulim surprizues i universit të pamatë të vlerave dhe potencialeve të Tetovës. Dhe pikërisht këtu ngjizën disa nga parimet inspiruese të propozimeve për zhvillim që trajtohen në detaje nga kapitujt në vijim mbi të ardhmen e qytetit.

**1. Tetova, qytet ekologjik dhe i qëndrueshëm** – Ky qytet ka potencial të jashtëzakonshëm ekologjik dhe mjedisor ku spikasin, burimet natyrore ujore. Masivi Sharr Korab është origjina e jetës/pasurisë jo vetëm për Maqedoninë (lumi Var-

dar), por edhe për Shqipërinë (lumi Drin), për Kosovën (lumi Ibër), dhe për Serbinë (Morava një nga degët kryesore lokale të Danubit). Ky potencial duhet analizuar, mbrojtur, kultivuar dhe mirëpërdorur në funksion të nevojave publike të qytetit dhe më gjerë. Integrimi më i mirë i lumit Shkumbin me jetën e qytetit mbetet një sfidë për dizenjimin dhe mobilimin urban të qytetit. Një politikë mjedisore dhe edukim ekologjik në shkolla i gjeneratave të reja, do të rriste cilësinë e jetës dhe të ndryshonte pozitivisht imazhin e qytetit brenda dhe jashtë vendit, duke rritur shanset për eko-, agro- apo forma të tjera të turizmit të specializuar, përfshi atë kulturor e dimëror. Ngritja e një sistemi dhe impianti modern për grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve urbane do të kontribuonte edhe më shumë në këtë drejtim.

**2. Tetova, qytet i aksesit dhe infrastrukturës** – Ky qytet ka një pozitë gjeografike të jashtëzakonshme dhe strategjike përtej territorit kombëtar. Tetova është një urë

lidhëse midis komuniteteve shqiptare dhe maqedonase në vend dhe më tej me Kosovën e Shqipërinë. Aksesimi shumë i mirë përveç rrugëve lokale, edhe me autostradat kombëtare, hekurudhën, si dhe lidhjet ndërkombëtare mund të përmirësohet më tej duke mundësuar lidhjen e shpejtë direkte në nivel metropoli me Shkupin/Aeroportin, si dhe me tunel me Prizrenin, gjë që do të shkurtonte ndjeshëm kohën dhe cilësinë e lidhjes me Kosovën, Shqipërinë, Malin e Zi dhe Serbinë etj; pavarësisht kostove fillestare në investim.

Ringjallja e infrastrukturës ekzistuese turistike në Sharr, sidomos asaj të sportit të skive (teleferikut), do të përmirësonte aksesin, kushtet mjedisore, dhe do të inkurajonte zhvillim ekonomik lokal përmes turizmit. Rehabilitimi dhe modernizimi i stacionit të trenit dhe i terminalit të transportit (inter-)urban do të krijonte një pol të ri zhvillimi në qytet dhe do të shtonte numrin e vizitorëve, duke inkurajuar burimin e investimeve dhe të sipërmarrësve. Ky Hub i ri urban me impakt rajonal do të merrte kuptim nëse mundësohej sidomos lidhja me tren të shpejtë në aksin metropolitar Aeroport-Shkup-Tetovë, dhe në një hap të dytë edhe me Prizrenin fqinj në Kosovë, ndërkohë edhe përmirësimi i aksesit infrastrukturor ekzistues edhe për lidhjen lindore të qytetit me Kosovën përmes Jazincës/Kaçanikut mbetet një prioritet.



Transporti publik urban do të minimizonte trafikun e panevojshëm privat, nëse do të stabilizohej një linjë ekonomike tramvaji në aksin Lindje-Perëndim nga zona universitare deri tek zona sportive, të cilat mund të konceptohen si porta hyrëse dhe imazhe bashkëkohore në qytet, respektivisht nga Gostivari/Shqipëria dhe nga Jazincë/Kosova. Kjo mund të kombinohej me një linjë teleferiku në aksin jug-veri, duke lidhur terminalin e qytetit me sheshin kryesor të qytetit, me zonën historike, terminalin e teleferikut të Sharrit, kalanë e Tetovës, dhe burimet termale në luginën e Shkumbinit. Një linjë e tretë alternative me mikrobuza do të mundësonte lidhjen e zonave rurale periferike përtej Porojt dhe Recicës së Madhe duke anashkaluar bërthamën historike përmes unazave të qytetit. Sheshi qendror, zona historike dhe pjesë të akseve kryesore 'Ilindenska' dhe 'Iliria' duhet të kthehen në zona këmbësore ose me akses të kufizuar. Linja të veçanta për biçikletat e itinerare këmbësore duhet të inkurajohen të përdoren në qytet.

**3. Tetova, zhvillim harmonik dhe i balancuar** – Qyteti ka trashëguar një balancë organike me natyrën dhe vetveten që në origjinë, e cila është cenuar ndërkohë nga iniciativat planifikuese dhe operacionet modernisto-jugosllave gjatë periudhës së ekonomisë të centralizuar. Korrigjimi i gabimeve të së kaluarës përmes rizbulimit të kodit gjenetik të qytetit



bëhet i domosdoshëm. Ky material siguron më pas shembuj ilustrues dhe metodologjinë në lidhje me këtë rekomandim. Heqja dorë nga koncepti i ngurtë i qytetit funksionalist dhe logjika e zonimit funksional si, dhe kalmi në konceptin e fashave urbane dhe skeletit strukturor do të shërbente që të kuronte ndarjet si me thikë të zonave të trashëguara, duke humanizuar, rehabilituar ose konvertuar qytetin postmodernist, që sot bazohet tek shoqëria e shërbimeve, komunikimit dhe miksimit të funksioneve që në nivelin e njësisë bazë urbane.

Balancimi i shërbimeve dhe zhvillimit të zonës lindore të qytetit me atë perëndimore do të ndihmonte në shmangien e tendencave të segregimit social, uljen e trafikut të panevojshëm ditor dhe zhvillimin e mëtejshëm të komuniteteve. Zhvillimi me prioritet i zonave të caktuara (si ish-zona e reparteve të policisë pranë kompleksit sportiv) për qëllime publike dhe me institucione që gjenerojnë shërbime e punësim është një mënyrë e mirë në këtë drejtim. Përmirësimi i infrastrukturës dhe akseve alternative të qarkullimit, pa qenë nevoja për të shembur zona historike, sado në gjendje të keqe të jenë ato, është një alternativë për të zbutur efektet e qytetit të ngurtë modernisto-socialist. Por, balancimi i zhvillimit fizik me ngritjen e kapaciteteve kulturore-arsimore vendore është ilaçi më i mirë i qëndrueshmërisë së zhvillimit.

**4. Tetova, Qytet i Sinkretizimit European** – Ky qytet ka një potencial të madh human falë diversitetit dhe larmisë së tij qoftë në aspektin demografik, social-kulturor, ashtu edhe në atë etniko-fetar. Prezenca e komunitetit maqedonas e ortodoks në një qytet me maxhorancë shqiptare e



muslimane duhet të përkthehet në një avantazh social-politik për qytetin për të dëshmuar një model realist perëndimor të bashkëjetesës dhe zhvillimit që impakton edhe në nivel kombëtar, ku raportet në kuptimin e balancave etniko-fetare ngjashmërisht përmbysen. Në këtë mënyre jo vetëm që Tetova do të shndërrohej në një qytet të të gjithëve dhe për të gjithë, por do të inkurajonte shmangien e paragjytimeve për trajtim të barabartë edhe në nivel kombëtar. Në këtë kuadër koncepti i sinkretizimit në kuptimin pozitiv të bashkëjetesës europiano-perëndimore bëhet një projekt thelbësor politik për të ardhmen e Tetovës, dhe mund të duhet të aplikohet edhe në zhvillimin urban të qytetit.

Kjo frymë pajtimi dhe uniteti e aplikuar jo pa sukses në mjaft vende të tjera të botës do të kontribuonte të ndërtonte imazhin e stabilitetit dhe të progresit, duke inkurajuar edhe zhvillim ekonomik lokal. Prezenca në Tetovë krahas besimit musliman e të krishterë, edhe të variantit fetar mistik të bektashinje është një shembull tjetër pasurie shpirtërore dhe tolerance që dëshmohet më së miri përmes modelit gjithëpërfshirës të mjediseve e hapësirës publike të Teqesë së Tetovës. Inkurajimi më tej i kësaj fryme mund të zhvillohet duke bërë një shpërndarje sa më të balancuar dhe transparente të investimeve komunitare në qytet; duke krijuar itinerarë dhe hapësira publike të përbashkëta midis komuniteteve; duke i shndërruar hapësirat urbane pranë institucioneve historiko-fetare në pika takimi dhe komunikimi publik; dhe duke i integruar ato në rrjetat dhe itinerarët social-turistikë të qytetit, apo në axhendat e festimeve publike ndëretnike/fetare etj.



## 5. Tetova, alternativa të ligjshme dhe eficientë urbane

Ka një mendim në Tetovë si në shumicën e qyteteve në rritje sot, se kjo rritje duhet të përballohet përmes planifikimit dhe investimit në zona tërësisht të reja zhvillimi, dhe kryesisht në periferi. Në fakt këtu ekipi i punës rekomandon zbatimin e një politike të kujdesshme dhe konservatore. Kjo jo thjesht për faktin se duhet mbrojtur toka bujqësore dhe mjedisi, por sepse Tetova ka një potencial të jashtëzakonshëm e të pashfrytëzuar toke dhe hapësire urbane në brendësi të qytetit. Evidentimi i këtij potenciali në terren dhe përmes sistemit kadastral të pronësisë është esencial. Pra, nevojat për zhvillim në të ardhmen duhet të vijë pikësepari nga efikasitetit i përdorimit të




tokës së lirë urbane, nga rikualifikimi i zonave të degraduara ekonomiko-industriale, apo nga transferimi i asetëve publike në nivel lokal etj; gjë që do të rriste edhe efektivitetin e infrastrukturës e shërbimeve aktuale urbane.

Vetëm atëherë mund të flitet për zhvillim në zonë krejtësisht të re. Për më tepër që Komuna duhet të mendojë të ofrojë alternativë zhvillimi urban të përballueshme financiarisht sipas shtresave të popullsisë dhe nivelit të tyre ekonomik, në se nuk dëshiron të inkurajojë më tej informalitetin.

**Literaturë referencë:**

- Fjalori Enciklopedik Shqiptar\_ ASHRSH, 1985
- Plani Hapësinor i Republikës së Maqedonisë
- Plani Hapësinor i Republikës së Kosovës, 2004
- Dokumenti i Politikave Hapësinore, Republika e Shqipërisë, 2007
- Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar të Malit të Sharrit, Kosovë
- Planing & Urban Design Standards, APA / WILEY
- Chicago Metropolis 2020, Chicago Region, 2003
- Growing Smart: Legislative Guidebook, 2002, Meck Stuart
- Town and Country Planing, Abercrowbie, Patrick, 1933











## PROJEKTI UNIVERSI TETOVA

Manifest për një vizion transformues të Tetovës

Sotir Dharmo

Materiali në vijim përmbledh një proces të gjatë hulumtimi të zhvilluar nga IKSH, Instituti Kërkimor Shkencor i U\_POLIS në bashkëpunim me Komunën Tetovë lidhur me eksplorimin e potencialeve dhe skenarëve të mundshëm të zhvillimit të sistemit urban dhe territorial të Tetovës.

Materiali që paraqitet në këtë manifest nuk është as vizion utopik dhe as projekt teknik. Ky material **synon të jetë një vizion zhvillimor, i cili e vendos Tetovën në raport me universin e saj të marrëdhënieve**, prej nga mund të burojnë mundësi të reja të paeksploruara më parë. Ky vizion synon të zbulojë përpara komunitetit të Tetovës mundësitë dhe potencialet e shumëfishta. Vetëm mbi këtë bazë, plani rregullues si një vizion më teknik do të jetë në gjendje të bëjë zgjedhje dhe të marrë vendime më të menduara.

Metodologjia e përdorur aplikon instrumente të analizës dhe dizajnit urban si eksploruese të potencialeve të pazbuluara të qytetit. Secila prej tematikave të trajtuara kanë disa linja të përbashkëta, por që shënojnë **impakte specifike me forcë katalitike** për të gjithë qytetin dhe territorin e Tetovës.

Frymëzimi nga shkalla territoriale që mund të jetë e nivelit bakllkanik, ndërkombëtar, kombëtar dhe lokal (metropolitan); kombinimi i këtyre niveleve territoriale me "shtresat" historike, zhvillimet kulturele e sociale dhe riinterpretimi i këtij materiali territorialo-historik për të krijuar hapësira urbane me përmbajtje sinkretike; mundësitë aktuale dhe potencialet e aksesimit të Maqedonisë dhe Tetovës në veçanti së bashku me derivatet hapësinore dhe sociale që ato krijojnë; konsiderimi i lidhjeve territorialo-ur-



bano-metropolitane si një instrument transformues për vetë qytetin; konsiderimi i “esencës urbane” që sjell nga historia pëlhura e Tetovës si element i fortë në gjenerimin urban dhe garantimin e identitetit, janë disa nga **linjat kryesore të zanafillave** frymëzuese dhe të zhvillimit të çdo projekti.

Projekti “Universi Tetova” synon të bëjë të kuptueshme se në ditët e sotme suksesi i qendrave urbane dhe garantimi i të ardhmes së tyre qëndron, së pari, në **të kuptuarit e thellë dhe pakomplekse të “vetvetes”**, të kuptuarit e gjuhës dhe “kodeve” shprehëse, si në dimensionin kohor, ashtu edhe në atë hapësinor, dhe riinterpretimi i këtij materiali në situata të reja; së dyti, **suksesi qëndron në eksplorimin e “vlerës së shtuar” që vjen si rezultat i pozicionimit territorial dhe “kohor”**, shfrytëzimit strategjik të avantazheve që i përcillen qytetit nga ky rrjet i gjerë marrëdhëniesh.

**Ne mendojmë se suksesi qëndron pikërisht në eksplorimin e këtij universi hapësinor dhe kohor marrëdhëniesh dhe në reflektimin e këtyre konkluzioneve në zhvillimin e qytetit. Nga ky këndvështrim material i paraqitur ka vlera përtej asaj që mund të kërkojë përgatitja e një vizioni për planifikimin e qytetit dhe mund të konsiderohet nga forcat përparimtare të qytetit si një “Manifest për ndryshimin e Tetovës”.**

Në vazhdim jepen disa ide udhëzuese të cilat përshkojnë materialin dhe “projekt-programet transformuese” të Tetovës të quajtura:

**Tetova sinkretike; Tetova 3T; Tetova esenca e hapësirës; Geni i Tetovës; Destinacioni Tetova; Tetova dhe korniza e ujërave.**

## 1. Vizioni "Përtej Tetovës" : "Pozita" 8 x 10

Ky është hapi i parë për të dalë nga "qerthulli i vetvetes" ku shpesh ndodhen të gjitha zonat urbane. Në këtë shkallë analizat dhe propozimet nisen nga shpjegimi dhe interpretimi i konceptit "përtej", pozita gjeostrategjike e Tetovës në kohë dhe momente historike të ndryshme.

Në këtë këndvështrim nga grupi i punës janë shtruar disa pyetje, të cilat kanë kërkuar thellim të mëtejshëm në materialet historike dhe dokumente të ndryshme arkivore.

Më poshtë jepen disa sqarime lidhur me kuptimin e konceptit "përtej" në termat e këtij studimi.

### **"Përtej" = përtej në kohë, lidhja me hapësirën kohore**

Nga çfarë thellësie kohore vazhdojnë të na vijjnë impaktet mbi hapësirën aktuale të qytetit? A ka periudha kur zhvillimi i hapësirës së qytetit ka kaluar përmes fazave dramatike ("mosha" të ndërprera dhe impakti i tyre sot)? A mund të shkaktojmë impakt pozitiv në hapësirën dhe sjelljen e qytetit përmes rikuperimit të riinterpretuar të tyre? Etj.

Këto arsytetime lidhen edhe me kuptimin e gjenerimit të qytetit në këtë shkallë hapësinore dhe kohore, si edhe me përgjigjen ndaj pyetjes "Përse Tetova është aty ku është?" Natyrisht që kjo përgjigje kërkon hulumtime historike dhe analizimin e skenareve të gjenezës së Tetovës në shkallë gjeo-kombëtare e lokale në periudha historike të ndryshme.

Hulumtimi me kujdes i hapësirave "përtej", në kohë dhe në territor, lidhet edhe me kuptimin e elementeve të "kudit gjenetik" fillestar të qytetit dhe proceset e gjenerimit të tij. Sikurse tregojnë edhe analizat e kryera në kuadrin e projekt vizioneve në vazhdim, këta "elemente të forta" territoriale, elementeve, të cilat "gjenerojnë" forma jete në fillesat e tyre, janë elemente natyrore dhe më pas edhe elemente të krijuara nga vetë njeriu. Disa prej tyre të konsideruara nga studimi janë: Mali i Sharrit, Lumi Pena, Lumi Vardar, Fusha e Pollogut, "nikja" natyrore në luginën e lumit, klima, trajektorja malore për Prizren, Pazari i vjetër etj.

Kjo ndihmon në zbulimin e "elementeve ideale" që ndikojnë në, fillesën e zonave të banimit, elemente ekzistenciale, të cilët mund të quhen "pa kohë" në kuptimin "universal" pasi janë pjesë e pandarë e imagjinatës urbane gjatë gjithë historisë njerëzore dhe pjesë e pandarë e "genit fillestar" të qytetit të Tetovës. Në kuptimin e projektit tonë, kjo do të "përkthehet" në pyetjen: A mund të identifikojmë në qytetin e sotëm të Tetovës pasqyrimin e elementeve ekzistenciale bazë të "Tetovës qyteti ideal?" Sa dhe si janë transmetuar përbërësit natyralë dhe artificialë të përmendur më sipër deri në ditët e sotme. Duke vazhduar këtë arsyetim është e domosdoshme të identifikojmë "esencat" e tipologjive territoriale nisur nga një kuadër më i gjerë se sa vetë ai i qytetit dhe elementet potenciale qytetformuese; të identifikojmë "refrenet" territoriale kryesore të konsideruara si elemente, që përsëriten në vazhdimësinë territoriale rur-urbane.

Në vazhdim mund të shtrojmë pyetjet: A ekziston akoma qyteti ideal "brenda" Tetovës së sotme? A mund të konsiderojmë "Enean" si venbanim para-rendës? A ka gjurmë të vazhdimësisë, apo thjesht kjo konfirmon edhe një herë se "Tetova e sotme është vendi i vërtetë ideal"?

### **"Përtej" = përtej në hapësirë, lidhja me hapësirën territoriale: Metro-Teto\_POLIS**

Thellimi i konceptit përtej në hapësirë lidhet me disa kërkime që kanë të bëjnë me "rrezen maksimale" ku Tetova ushtron influencën e vet, si edhe "rrezen" territoriale prej nga përcillen influencat në Tetovë. Kjo është e lidhur ngushtë me influencën e korridoreve 8 x 10 dhe nyjeve terminale më të afërta me to. Ky arsyetim na ndihmon të kuptojmë se cila është zona metropolitane e Tetovës, cili ka qenë procesualiteti historik në krijimin e saj dhe cili është stadi aktual dhe tendencat e sotme (TeGoShku, TePriGo, GoTeShku).

Gjithçka theksuam më sipër lidhet me të kuptuarit se cilët janë magnetët kryesorë në rajonin në studim dhe cilat funksione janë më të prirura të krijojnë aglo-koncentrime: pazaret rajonale, nyjet transportuale, objektet arsimore e shëndetësore, shërbimet rekreative, shërbime të tjera ndaj komunitetit etj.

Të kuptuarit e rrjedhshmërisë logjike që ekziston midis elementeve të forta potenciale qytetformuese; aglomerimit (si pasojë e gravitetit të elementeve të forta) si fazë fillestare e grupimeve njerëzore për qëllime ekonomike apo banimi; koncentrimin (apo koagulimit) si një fazë më e avancuar e konsolidimit dhe pavarësisht të polariteteve në shkallë metropolitane. E rëndësishme ka qenë të kuptuarit e formave fillestare të aglomerimit (gravitimit, grupimit) në raport me trajektoret gjeneruese lineare dhe ato "ishullore" dhe mënyrat e lidhjeve që ekzistojnë midis tyre dhe sistemit kryesor urban të Tetovës për të kuptuar sistemin që vepron si një i tërë dhe potencialet maksimale të sistemit. Rëndësi të veçantë këtu ka pasur identifikimi i polariteteve lineare historike përgjatë trajektores gjeneruese Gostivar, Tetovë, Prishtinë, si edhe qendrave urbane dhe rurale mbi këtë trajektore lineare gjeneruese.

Në një fazë të mëtejshme dhe më të avancuar të sistemit urban territorial metropolitane është e rëndësishme të kuptohet se si influencojnë këto koncentrime në krijimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të "fashave territoriale" dhe "arkipelagut", i kuptuar ky i fundit si "negativi" i fashave; hapësira e mbetur jashtë graviteteve. Kjo lidhet me përcaktimin e hapësirave "fluktuate" (= jashtë "graviteteve", "lundrojnë" të lira në territor) dhe me mënyrën e trajtimit të tyre; me kuptimin e tendencave / potencialeve për krijimin e "koncentrimeve" të reja në shkallë metropolitane dhe agregimin e mëtejshëm të polariteteve. Kjo do të kërkonte të mendonim që tani lidhur me nevojat për të rezervuar tokën për shërbime dhe funksione të reja në Tetovë, si në shkallë urbane, ashtu edhe territoriale.





## Vizion: hipoteza “qyteti nesër”, Tetova në shkallë rajonale

Ky vizion ka të bëjë me ripolarizimin e Rrjetit Policentrik Metropolitan mbi bazën e studimit të potencialit të kontekstit rur-urban dhe rikonsiderimin e graviteteve në shkallë territoriale dhe urbane: Tetova, Gostivari, Shkupi, Prizreni, Prishtina, Zona e aeroportit, terminallet e tjera të transportit janë vetëm disa nga “magnetët”, që mendohet se duhet të hyjnë në këtë “dialog të Tetovës përtej”.

Një Tetovë që mundëson shërbime dhe ushtron influencë në shkallë territoriale për të ringjallur “genet” e rilindjes së qytetit. Gravitetet e reja të krijuara nga korridore të fuqishme kombëtare dhe ndërkombëtare nuk janë me vetëm një vizion, por realitet i prekshëm: korridoret 8 x 10; si edhe Rruga Durrës-Kukës-Prishtinë, e sjell Tetovën në prag të mundësive të reja për të ringjallur lidhje historike me vlera dhe përfitime të shumëfishta, një Tetovë që identifikohet fuqishëm pranë këtyre korridoreve dhe që mund të kapërcejë paragjykimet dhe tabutë e sotme për një vizion të “Tetovës pa kufi”.

Projekti në këtë shkallë do të garantojë “daljen përtej hapësirës kohore” dhe “përtej hapësirës territoriale” të Tetovës së sotme si një pjesë e “terapisë kuruese” të problemeve në shkallë më të vogël. **Kështu “ndërprerja” e hapësirave kohore dhe territoriale të Tetovës së kaluar dhe asaj të pritshme do të transformojnë Tetovën e sotme.** Ky nivel arsyetimi ofron “hapësirën e munguar” dhe tregon se zgjidhja nuk mund të vijë vetëm nga ajo që tradicionalisht jemi mësuar të quajmë qytet.

Mbi këtë bazë a mund të perceptojmë një sistem elastik Metro-Pur-Urban i cili të funksionojë mbi bazën e “lidhjeve” të ndryshueshme (elastike) për funksione të ndryshme, për të cilat qyteti jep dhe merr shërbime.

Sikurse tregojnë disa nga “projektprogramet transformuese”, vizioni i “Tetovës përtej”, përcjell energjinë e tij deri në shkallën urbane dhe nënkupton rifuqizimin e “graviteteve” në rastet kur politikatat territoriale kanë krijuar “vrime të zeza” të hapësirës urbane, “gravitete” të cilat shtojnë një shtresë të re të kontekstit urban, por nuk e tjetërsojnë atë. Në këtë këndvështrim qyteti është parë si “fasha matricore” dhe “pole manjetike” të cilat sjellin risi funksionale, formale dhe sociale në Tetovë.

Këto ishin vetëm disa nga “dimensionet” e konceptit “përtej”, i cili na nxiti për këto arsyetime, të cilat mund të kenë bërë lexuesin të shkojnë edhe më “përtej”. E rëndësishme është “përkthimi” i konceptit në vizione fizike të prekshme, sikurse e tregojnë disa nga “projektprogramet transformuese” për Tetovën të paraqitura në vazhdim.



## 2. "Esencat e Tetovës" – Riesencializimi

Më poshtë jepen disa sqarime lidhur me kuptimin e konceptit të "esencës" në termat e këtij studimi; si mund të zbulojmë "esencën" e Tetovës; dhe sa "qytete" përmbledh brenda vetes qyteti i Tetovës.

Referenca për të identifikuar "Tetovat e ndryshme" do të jetë tek morfologjia urbane, pëlhurat dhe elementet që e formojnë atë. Duke konsideruar se hapësira është një shprehje shoqërore, Tetova tregon se transformimet shoqërore në periudha të ndryshme natyrshëm kanë çuar në forma të ndryshme të organizimit hapësinor. Shoqëria dhe hapësira transformojnë reciprokisht njëra-tjetrën. Pëlhura urbane konsiderohet si element i "fortë" që ruan qëndrueshmërinë në kohë. Edhe në rastet e dëmtimeve masive ajo ruan gjurmët e "esencës" fillestare.

Në lidhje me sa theksuam më sipër është e rëndësishme të konsiderohen disa çështje që kanë të bëjnë me procesin analitik të zbulimit të esencës, si p.sh.: cili është materiali që duhet "distiluar" / filtruar për të arritur tek "esenca"? Me "filtrim" do të kuptojmë një proces "reduktues" / thjeshtëzues që nxjerr në pah elemente specifike, të cilat janë në gjendje të "fjetur", pra që nuk i shohim në gjendje normale.

Një nga fokuset kryesore të filtrimit është ai historik, i cili jep mundësinë që të kuptojmë elementet e forta esenciale në kohë dhe transformimin e tyre. Filtrimi duhet të jetë në gjendje të pastrojë elementet e imponuara, (urbicidet) të konsideruara si ndërhyrje të dhunshme ndaj hapësirës urbane, të shfaqura zakonisht përmes shembjeve dhe shkatërrimeve të objekteve apo zonave, të cilat përfaqësojnë memorie të rëndësishme urbane.

Filtrimi dhe arritja e esencës në shkallë urbane dhe zbritja deri në shkallë njësie banimi dhe tipologjie banimi, mënyrat e agregimit të tyre, raportet me oborret dhe hapësirën qytetare na ndihmojnë të kuptojmë edhe proceset e gjenerimit në këtë shkallë, raportet historike dhe aktuale të njësive urbane dhe qytetit me tipologjitë, gjenerimin dhe konsolidimin e formës urbane (pëlhurave dhe organizmave urbanë).

Analiza e kujdesshme e "çarjeve" të strukturës urbane të Tetovës gjithashtu mund të na çojë në gjurmë të vjetra historike. Sikurse analizat më të detajuara të paraqitura në projektprogramet në vazhdim tregojnë se, këto çarje kanë për origjinë "ngurtësimin" e elementeve natyrore, si vija uji, itinerare të vjetra historike, apo janë treguese të vijave të bashkëstrukturimit urban të variacioneve tipologjike (natyral apo të sforcuar), që ka ndodhur në kohë të ndryshme.

Përdorimi me shumë kujdes i këtyre elementeve që gjenerojnë nga origjina e kohës, garantimi i vazhdimësisë së këtyre shenjave, por në një kontekst dhe kohë të re, ka të bëjë me riinterpretimin e esencës (genit) të Tetovës në dobi të zhvillimeve të ardhshme urbane dhe sociale. Këto kërkime do të garantojnë tranzicionin kontekstual në një mënyrë shumë më të ndryshme nga sa është bërë kjo përmes "gjurmës moderniste" të periudhës së ish-Jugosllavisë.





Vizionet e paraqitura në vazhdim të materialit, sidomos ai mbi sistemin e ujërave të Tetovës, ai mbi esencën e hapësirës dhe mbi riinterpretimin e genit të Tetovës kanë fillesat e frymëzimit të tyre në këtë parim të rëndësishëm analitik dhe zhvillimor.

**Vizioni: “riesencializimi” i Tetovës është zbulimi i esencës dhe riinterpretimi i saj.**

**Nga “esenca” ( vernakolare) në gjendje urbane të vetëdijshme**

Tetova “sjell” një shtresë të re të lexueshme: esencën e saj si një qytet organik. Kjo do të bëhet e dukshme përmes rinteprimit të elementeve konkrete, si ndërtime, gjurmë rrugësh, elemente gjelbërimi, elemente të peizazhit dhe të dizajnit urban etj. të lexueshme mbi hapësirat ekzistuese të qytetit. Projektprogramet e paraqitura në vazhdim të materialit “geni i Tetovës” dhe “esenca e hapësirës” janë shembuj të qartë të “zbulimit” të esencave “mbartëse” të Tetovës, të cilat mund të realizojnë tranzicionin drejt një Tetove që tregon më qartë “genet e ekzistencës” së saj.

Sipas këtij vizioni, Tetova mund të shihet edhe nga një këndvështrim poli-centrik Rur-Urban **në shkallë qyteti dhe metropolitane**, pasi janë zbuluar fillesat potenciale për rimagnetizime të reja në atë që mund të konsiderohet qytet sipas një vizioni të ri. Në këtë rast nënkuptojmë një qytet më “elastik” i cili duhet të “disagregohet” dhe “riagregohet” si një “puzzle” bazuar në lexueshmërinë e qelizave. Nga pikëpamja praktike kjo do të thotë se krijimi i lehtësive në sistemin e shërbimeve në përgjithësi, dhe ato të transportit e lëvizjes këmbësore në veçanti, e tregojnë këtë më në detaj sikurse dy projektprogramet transformuese “destinacioni Tetova” dhe “Tetova 3T”.

Mbajtja parasysh e këtij vizioni i kthen në avantazh ndërhyrjet e dhunshme që janë kryer në të kaluarën ndaj pëlhurës urbane, duke i përdoruar hapësirat e krijuara prej tyre si hapësira publike në favor të qytetarëve. Kjo bëhet e mundshme vetëm duke kuptuar qelizën urbane deri në esencë dhe duke e shpëtuar atë.

Një Tetovë që zbulon potencialet e “fshehura” në “qelizë” dhe i “përdor” ato mbars me “gravitet të ri” atë që është e fshehta e krijimit (marrëdhëniet origjinale midis qelizave agreguese, që në këtë rast nënkuptojnë si gjithçka që ndërvepron me diçka tjetër)

### 3. Operacionet “reframe” të hapësirës: Peizazh dhe dizajn urban

#### Projekti “sfida të dizajnit urban dhe peizazhit” në Tetovë

Më poshtë jepen disa sqarime lidhur me kuptimin e konceptit “reframe” në termat e këtij studimi. Së pari, është një qasje për të parë në mënyrë

pozitive situatën aktuale. Pëlhura urbane në Tetovë, sikurse ndodh edhe në shumë situata të tjera urbane nëpër botë, është e dëmtuar nga ndërhyrjet, por pikërisht këtu mund të gjejmë edhe "hapësirën" për të ndërmarrë veprimet e duhura në kohën e sotme. Kjo do të varet pikërisht nga mënyra se si arkitektët dhe planifikuesit urbanë do të jenë në gjendje të "lexojnë" me kujdes dhe ndjeshmëri situatën aktuale nga një këndvështrim tjetër dhe të "ndihmojnë" edhe të tjerët për të "parë" pozitivisht situatën. Ky është një moment psikologjik i rëndësishëm që kërkon forcën e bindjes për ndryshim si nga profesionistët, ashtu edhe nga autoritetet. Kjo do të thotë që elemente apo faktorë, të cilët në dukje të parë janë problematike t'i vendosim në një kornizë (frame) të re në atë mënyrë që të duken ndryshe. Kështu "kaosi" mund të shihet si "energji pozitive", si një "pasuri e tekstit urban" dhe mundësi për ta "rilexuar atë"; dëmtimet e pëlhurës si një mundësi për të rikrijuar hapësira të reja, multietniciteti si një mundësi për më shumë diversitet, etj.

Si mund të transformojmë pozitivisht mesazhin që qyteti i përcjell banorit?

Më parë duhet të identifikojmë p.sh. se ç'gjë në mes të "kaosit" nuk është "kaos". Për këtë na vijmë në ndihmë identifikimi i elementeve "të forta" artificiale dhe natyrale ("rezistencat" urbane janë elemente që kanë ruajtur vazhdimësinë në kohë). Në këtë këndvështrim mund të "zbulojmë" një rrjet të elementeve të forta në shkallë qyteti dhe "pranë-qyteti". Pjesë e këtij rrjeti mund të jenë edhe ato që në këndvështrim të parë duken si çarje urbane me origjinë të ndryshme (pozitive apo negative), "frakturat" e shkaktuara nga "përplasjet e gjuhëve të ndryshme" të dizajnit urban, etj.

"Projektprogramet transformuese" në vazhdim japin raste konkrete të kësaj qasjeje pozitive se si të transformojmë elemente të cilat në pamje të parë janë "patologjike" (një e kaluar që nuk e përjetojmë edhe sot) në elemente "gjeneruese" (një e kaluar që e përjetojmë edhe sot) të formës urbane dhe të jetës.

Trajtimi i këtyre çështjeve lidhet ngushtë me principet e dizajnit urban.

Si mund të rivendosim një raport të ri të hapësirës dhe njeriut në Tetovë? Në këtë këndvështrim është e rëndësishme të kuptojmë se cili është "dizajni" / "dizajnet" aktuale të Tetovës dhe si influencojnë ato, te banori dhe vizitori.

Cilat janë disa nga pikat më "të ndjeshme" nisur nga ky këndvështrim, ku duhet të aplikohen operacionet e "kirurgjisë plasike" apo "kirurgjisë së thellë"?

Raportet e Tetovës me natyrën janë ende një avantazh i madh për qytetin, por ato janë në një ekuilibër dinamik. A është ende Tetova një "qytet në sfond të natyrës", apo natyra gradualisht po vendoset në sfond të qytetit? Edhe në rastin e dytë në këndvështrimin pozitiv qyteti dhe natyra mund të konsiderohen si një simbiozë e peizazhit. Sipas kësaj qasjeje pozitive, është e domosdoshme të garantojmë përmes "operacioneve" të dizajnit urban dhe peizazhit një fluiditet më të mirë të "natyrës në qytet" dhe "qytetit në natyrë". Në këtë këndvështrim edhe hapësira boshe mund të konsiderohet si "element i fortë".

### **Vizioni Tetova nën një kornizë të re**

Projektet, sipas këtij vizioni, tregojnë se si do të “duken” kontekstet reale pas “rikornizimit”/rikontekstualizimit të “elementeve të forta” ekzistuese, p.sh.: qendra dhe segmenti qendër si “oda e madhe urbane”; çarshia e vjetër dhe rrugët e butikëve si “sallone” në qiell të hapur për ndërveprim social; “Përgjatlumsja” si një përçasje e re dhe më e shtuar me lumin si elementi kryesor i qytetit, duke e parë atë si elementin bashkues kryesor; “pazaret si pika të vërshimit rural në Tetovë”, si fillesa të koncentrimëve territoriale dhe metropolitane”; një Tetovë që merr “larmi ngjyrash” sikurse dhe vetë monumenti i saj më i vjetër, Xhamia e Larme.

Një Tetovë që nuk e ka kompleks ndryshimin, rritjen e vrullshme madje kaotike dhe që e tregon haptazi elasticitetin e saj “metamorfik”. Madje ky i fundit kthehet në një element specifik të dizajnit urban të Tetovës. Një Tetovë ku hapësira e saj “bujare” (“bujare” në këtë rast e kuptuar si shpesh e zhvilluar pa rregulla) arrin t’i përshtatet proceseve transformuese të nxitura nga ndryshimet sociokulturore moderne dhe të pritshme. Një Tetovë ku marrëdhëniet e njeriut më hapësirën janë më demokratike. Një Tetovë që ka hyrë në ciklin virtuoz, ku njeriu dhe hapësira “ngarkojnë” me energji pozitive reciprokisht njëri-tjetrin.

Projekti, sipas këtij vizioni, do të garantojë materializimin në projekte konkrete të koncepteve të mësipërme si në shkallë të detajit urban, ashtu edhe në shkallë qyteti dhe shkallë territori e detaji të territorit.

Një Tetovë që paraqet rrjetin alternativ hapësinor të bazuar në ringjalljen e elementeve “të forta” të fjetura: të fjetur në mendje dhe në hapësirë. Një Tetovë e djeshme që vjen në “sipërfaqe” për të “ndihmuar” Tetovën e sotme. Një Tetovë ku banori dhe vizitori kanë një shkallë më të lartë të lirisë së lëvizjes që krijon ndjesinë komode të qenies njerëzore të lirë të zgjedhë në hapësirë.

Nga “projektprogramet transformuese” të paraqitura në vijim të këtij materiali, ai i quajtur “Tetova sinkretike” më së miri synon të tregojë se e njëjta hapësirë fizike mund të rikontekstualizohet në një hapësirë të përjetuar ndryshe, e cila mbart brenda vetes një pasuri shumë më të madhe sesa ajo që duket në pamje të parë.

**Literaturë referencë:**

- The Regional City – P. Calthrope
- Doxiadis - Dynapolis
- OMA dhe konceptet e fashave urbane dhe territoriale
- The concept of urban catalysts – Logan, Attoe
- Collage City – C Rowe, F. Kotter
- L'architettura della città" – A. Rossi
- How the other half builds – Bhatt, Rybczynski
- Making great streets – A. Jacobs
- Urban Plazas; design review checklist – Marcus, Francis, Russell
- Greenways – Loring Lab Schwarz;
- Urban bikeways – Klein, Lardner
- Urban Waterways – Schneekloth
- Introduction to townscape – G. Cullen
- Community design Charrettes – watson, Floyd
- The generators of diversity – J. Jacobs; Social life of small urban spaces - Whyte
- Deleuze's Ontology and Creativity: Becoming in Architecture – James Williams







# D e s t i n i c i o n i



# Tetovë



- \* Tetova Euro-Balkanike
- \* Energjite
- \* Metropoli i Madh Maqedonas
- \* Terminali, nyje transporti
- \* Te shohesh Infrastrukturen si Arkitekture
- \* Aksese dhe levizje
- \* Destinacione

Eduina Jaupi

1

# Destinacioni Tetovë

Eduina Jaup

Po ta nisim historinë nga fillimi me një hap shumë të shpejtë, lindin këto pyetje: ku ndodhet Tetova; si arrihet; **çfarë e rrethon**; nga çfarë përbëhet; kush banon; çfarë ofron; **çfarë potencialesh ka?**

Përfundimi është një pikë kyçe e historisë, zhvillimi i Tetovës: duke njohur të gjithë këto **potenciale**; duke grumbulluar kaq informacione; histori; atëherë si mund të arrish në Tetovë, si mund të njihesh me të, si mund të kthehet **Tetova në bërthamë të vertetë të Ballkanit**, në destinacionin e tij kryesor?

## Destinacioni Tetovë

Mjafton të shohim një hartë të Ballkanit, pajisur me emërtimet e secilit shtet që e përfaqëson si dhe me gjithë korridoret europiane e ballkanike që lidhin këto shtete, menjëherë do të na binte në sy se si diku në qendër të saj, aty ku duket sikur mblidhen apo përkundrazi shpërndahen gjithë këto korridore, pozicionohet shteti maqedonas, pjesë e të cilit është qyteti i Tetovës.

Kjo panoramë e parë për qytetin është pikënisja e "Destinacionit Tetovë", spuntoja nga ku nisin hulumtimet dhe hipotezat për zhvillimin e tij. Konstatimi, në dukje i shpejtë, përforcohet gjithnjë e më shumë duke analizuar hollësisht kontekstin e një shkalle kaq të madhe të qytetit. Duke iu përmbajtur analizave pamore dhe fizike, kupton se si sistemi i gjithë shteteve dhe lidhjeve formon një strukturë shumë të fortë ndërvepruese, të ngjashme me formulat kimike, të përbëra nga atomet dhe numrat përkatës të valencave.

Në të njëjtën formë Maqedonia luan një rol kyç në këtë formulë, pasi thënë metaforikisht numri i saj i valencave është më i larti. Duke qenë në qendër të gadishullit, ajo krijon lidhje të mira jo vetëm me shtetet fqinje, por në të njëjtën kohë edhe me skajet e tij. Instrumentet primare që përdor janë dy akset e forta *cardo-decumanus* që e përshkojnë tejpërtej e që krijojnë nyjen nga ku dalin e mblidhen akset e tjera lidhëse ndërkombëtare, Korridori 8 dhe Korridori 10 Ndëreuropian. Korridoret pasohen nga një sërë lidhjesh të tjera ndërkombëtare me rëndësi jetike për Maqedoninë, akse që e lidhin me vende me potenciale të ndryshme, si qytetet-port, qytetet turistike, qytetet me ekonomi shumë të zhvilluar etj.

Si panoramë të dytë të Tetovës, ashtu si në të parën, do të kishim një qytet të evidentuar qartë në rolin e një nyje, një berthame apo një çerniereje nga ku përsëri metaforikisht energjia e formave të ndryshme, që rrjedh nga i gjithë Ballkani vjen e akumulohet e më pas transformohet në energji që i jep jetë vetë qytetit.

Në një "zoom in" të kontekstit ndërkombëtar në atë kombëtar konstatohet dhe një rol tjetër, një panoramë e tretë e qytetit. Me të njëjtën formë analize si më parë, me atë të aksesit dhe të lidhjeve, lexohet një sistem i ngjashëm, në këtë rast jo kimik, por më pranë atij biologjik. Prej mënyrës sesi ndërthuret ky sistem me organet kryesore, qytetet kyçe të Maqedonisë, dalin në pah dy unaza të ndara njëra prej tjetrës me aksin kryesor Veri-Jug (Korridori 10).

Unazat kombëtare, të cilat mund t'i emërtojmë si mushkëritë ekonomike të Maqedonisë, kryejnë përsëri funksionin jetik të shtetit. Pjesë e tyre është dhe Tetova, pozicionuar në mënyrë ideale tek mushkëria e parë, pranë kryeqytetit, Shkupit, Aeroportit dhe qyteteve të tjera të vogla të ngjashme


me të, si Gostivari, por pa humbur lidhjet edhe me mushkërinë e dytë duke qenë pranë qytetit të Kumanovës dhe Veleshit.

Kësisoj, pas gjithë analizave të mësipërme në shkallë të madhe, hipoteza Destinacioni Tetovë merr një formë më reale dhe më konkrete. Ajo lind nga energjia, që siç thamë, rrjedh nga Ballkani dhe drejtohet për në Tetovë e kalon nëpër organet jetësore të vetë shtetit maqedonas, mushkëritë ekonomike, prej të cilave lind një hipotezë e dytë, Metropoli i madh i Maqedonisë. Energjia më pas koncentrohet së fundmi në qytet, në pikën e vetme lidhëse momentalisht me rajonin, Stacionin e Trenit dhe Terminalin e Autobusave. Kjo është dhe çerniera e fundit e sistemit, nga ku më pas ajo shpërndahet nëpër gjithë qytetin duke zbuluar potencialet e dukshme dhe të padukshme të tij.

Por, përpara arritjes së kësaj çerniere të fundit lind nevoja e evidentimit më të qartë të itinerarit që përshkohet. Lind nevoja për të artikuluar më mirë instrumentet, me të cilat itinerari arrin destinacionin Tetovë një nga të cilët është mobiliteti.

Mobiliteti në format e tij të ndryshme, ajror, motorik, hekurudhor, këmbësor, teknologjik (internet, telefon etj.), energjetik (naftë, gaz natyror etj.), është një metodë njohjeje për Tetovën në rajon, njohje e cila bazohet kryesisht në një sistem të përbërë jo vetëm prej qytetit të Tetovës, por prej 5 pikave kyçe që do të formonin Metropolin e Maqedonisë: Gostivari, Tetova, Shkupi, Aeroporti, Kumanova. Këto qytete, pjesë e mushkërisë së shumëpërmendur, ndajnë të njëjtat karakteristika të qytetformimit, të strukturës së tyre të brendshme dhe ndjekin në formë lineare njëri-tjetrin, duke krijuar një strukturë të përbashkët unike. Mobiliteti është potenciali kryesor në Metropolin GO-TE-SKO-AIR-KU dhe është i formuluar shumë qartë në ferritor nga lidhja me anë të automobilave, që është një nga më të zhvilluarat sot; hekurudha, që evidentohet dhe kthehet në hekurudhën e një treni me shpejtësi të madhe, duke zvogëluar edhe më tej distancat; linja ajrore, nyje tjetër lidhëse me rajonin dhe me të gjitha akset e tjera lëvizëse; si dhe zhvillimi i mëtejshëm i mjeteve të komunikimit si telefoni apo interneti.

Metropoli funksionon më tej si një organizëm, ku çdo pjesë e tij përfiton nga tjetra, ku tendeca është për të shkurtuar distancë përherë e më shumë nëpërmjet unifikimit. Gjithë energjia që përballon Metropoli kthehet në një zhvillim për qytetet dhe zonat ende të pashfrytëzuara përreth tyre. E më i rëndësishmi është synimi për të arritur destinacionin e parë, destinacionin Tetovë pa hasur më barriera, duke mos pasur më distanca, duke mos e ndier kohën.




## Konteksti Ndërkombëtar

Duke qenë se spuntoja e projektit “Destinacioni Tetovë” nisët nga një shkallë shumë më e madhe e qytetit, duke u shtrirë në gjithë Gadishullin Ballkanik, analizat e para përquendrohen më së tepërmi në evidencime në hartë të elementëve me rëndësi për të gjithë, si: rajoni, shtetet kryesore, kufijtë fizikë e politikë, lidhjet infrastrukturore mes tyre me emërtimet përkatëse etj.

Konstatohet se Tetova zë në të vërtetë një pozicion mjaft të përshtatshëm e me një rëndësi të madhe gjeo-politike në qendër të gadishullit, aty ku shohim se kryqëzohen një sërë prej korridoreve përbërëse të tij. Ajo krijon lidhje të ngushta jo vetëm me shtetet fqinje, por luan rolin e një ndërmjetëse të të gjitha skajeve të Ballkanit.

Pozicioni i përshtatshëm i Tetovës nuk bën gjë tjetër veçse krijon një profil unik për qytetin në rajon, të aftë për të krijuar ndërveprime.





Ky vizion, i cili shtrihet në të ardhmen dhe që ndiqet nga sfida të mëtejshme, përbën hapin e parë drejt konsolidimit dhe formimit të Tetovës të së ardhmes e Metropolit të Ri të Maqedonisë. Nëpërmjet kësaj qyteti dhe Metropoli marrin përherë e më shumë rëndësi, duke vepruar përherë e më shpejt në fushën ndërkombëtare dhe shkojnë gjithnjë e më pranë plotësimit të nevojave të njerëzve.

Bazuar në këtë analizë dhe duke kaluar paksa përtej fizikës, mund të paraqesim në formë diagramatike idetë e mësipërme për një Maqedoni qendër, një sistem ideal lidhjesh ndërshtetërore, në formë yjësish apo valencash, një energji e tërë potencialesh që derdhen nga gjithë Ballkani në qytetin e vogël të Tetovës. Të gjitha këto jo më kot tregojnë veçse një gjë: një të ardhme të qartë, që ka ekzistuar aty dhe që me instrumentet e duhura do jetë shumë shpejt një e tashme e qytetit.



Lidhje ballkanike në Tetovë




Korridori 8

Në këto harta evidentohet dhe njëherë më qartë se si vetë Ballkani e favorizon qytetin për të arritur një pozicion të atillë, duke derdhur gjithë energjinë e tij që buron nga të katra anët e territorit në qendër, aty ku ndodhet Tetova. Këto energji janë korridore europiane, të cilat formulojnë gjithë sistemin ndërveprues të shteteve dhe lidhjeve të tyre. Zhvillimet intensive në rajonin ballkanik gjithmonë kanë ardhur në sajë të korridoreve strategjike. Dy nga më të rëndësishmit përshkojnë pikërisht rajonin e Maqedonisë madje dhe vetë qytetin e Tetovës.

Korridori 8 lidh shtete, si: Shqipëria, Maqedonia, Bullgaria të cilat përbëjnë një urë lidhëse mes Europës dhe Azisë Jugore, si një itinerar i rëndësishëm tregtar përgjatë shekujve. Zhvillimi i korridorit 8 Ndëreuropian ndikon pozitivisht në të tria vendet Ballkanike që ai përshkon dhe më gjerë. Ai bën një lidhje Lindje-Perëndim dhe rëndësia e tij konsiston në tendencën që ka zhvillimi i zonave të reja të banimit, nxitja e shërbimeve, tregtisë, turizmit dhe industrisë. Gjithashtu lidhja e porteve të mëdha në Adriatik (Vlorë, Durrës) dhe në Detin e Zi (Varna e Burgas) ka rezultuar në një transport me të shpejtë të mallrave.





Korridori 10



Maqedonia dhe Portet Ballkanike

Për më tepër Korridori 8 lidh 5 aeroporte ndërkombëtare (Tiranë, Dibër, Shkup, Sofje dhe Varna) dhe i jep akses 6 aeroporteve të tjera të vogla, duke i dhënë mundësi njerëzve të udhëtojnë më shpejtë nëpër këto shtete.

Por, suksesi i këtij korridori s'do të jetë aq shumë infrastruktura, por mënyra se si do të zhvillohet tregtia përgjatë tij. Ai do të sigurojë akses në tregun botëror dhe materiale për industrinë, gjithashtu do të nxisë edhe turizmin. Ndërsa përsa i përket Korridorit 10, mund të përmendet fakti që qëllimi i tij kryesor ka qenë lidhja e vendeve europiano-lindore me pjesën tjetër të Europës në mënyrë që të pësonte një zhvillim të mëtejshëm dhe në një hap me shtetet e tjera të zhvilluara. Në hartat e mësipërme evidentohen në mënyrë skematike korridoret ku vihet re dhe se si ato e përshkojnë Maqedoninë gjatë itinerarit të tyre.

Të 2 korridoret, që kryqëzohen pikërisht në qendër të Maqedonisë, formojnë një Cardo-Decumanus Ballkanik Kombëtar mjaft të dallueshëm dhe të rëndësishëm për qytetin e Tetovës.

Veç korridoreve europiane të sipërmendura, Maqedonia përshkohet dhe nga një sërë rrugësh të tjera me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare. E rëndësishme në këto raste është mundësia, që sjellin ato për lidhjen e vendeve me potenciale të ndryshme, si qytetet-port, ato zona me ekonomi të zhvilluar me ato të pazhvilluara, qytetet turistike etj. Më sipër tregohet edhe njëherë Maqedonia si bërthamë imagjinare duke u lidhur pa asnjë pengesë me të gjitha shtetet fqinje, dhe më tej në Ballkan. Tek ilustrimi i dytë në formë më konceptuale tregohet vetëm lidhja e qyteteve bregdetare dhe se si kjo arrihet




### Struktura territoriale e Maqedonisë

Më tej analiza ndjek të njëjtën linjë, por duke bërë një “zoom in” prej kontekstit ndërkombëtar në atë të rajonit të Maqedonisë. Duke e zmadhuar kësisoj shkallën e vëzhgimit të analizës në shkallë kombëtare arrijmë të zbulojmë se si dhe vetë brenda rajonit ka një ndërveprim që vazhdon linjën e akseve ballkanike.

Lidhja e fortë që ekziston me shtetet fqinje forcohet më tepër prej korridoreve brenda shtetit, po dhe dy korridore të rëndësishme që përmendëm më parë. Mënyrat e ndryshme se si formulohen këto lidhje sjellin konfigurime, ndër të cilat spikat ai i mushkërive perëndimore dhe lindore të Maqedonisë. Jo më kot bëhet një paralelizëm i tij me biologjinë. Mushkëria si pjesë jetike e organizmit kryen të njëjtin rol edhe në rastin e Maqedonisë.





Pjesë e tyre është dhe Tetova, e pozicionuar në mënyrë ideale tek mushkëria perëndimore, pranë kryeqytetit, Shkupit, Aeroportit dhe qyteteve të tjera të vogla të ngjashme me të, si Gostivari apo Kërçova, por pa humbur lidhjet edhe me mushkërinë e dytë duke qenë pranë qytetit të Kumanovës.

Nga tërë kjo analizë historike, hipoteza, pyetje dhe prej imazhit të qytetit parë përgjatë një përshkimi njëditor nuk kishte se si mos të lindin disa shkëndija të para rreth atij synimi që kishim në fillim, frymëzimit dhe lindjes së ideve, instrumente për Tetovën e të ardhmes.


### Mushkëritë Ekonomike të Maqedonisë



Konteksti Kombëtar

Nisur nga fillimi i analizës dhe duke ecur me hap të shpejtë, pyetjet na ndihmojnë të përgjigjemi: ku ndodhet Tetova, si arrihet, çfarë e rrethon, nga çfarë përbëhet, kush banon, çfarë ofron, potencialet që ka? Etj. Kjo pikëpyetje përfundon në një pikë kyçe të historisë, tek zhvillimi i saj: duke njohur gjithë këto potenciale, kaq informacione, histori, atëherë si mund të arrish në Tetovë? Si mund të njihesh me të? Si mund të kthehet Tetova në bërthamë të vertetë të Ballkanit, në destinacionin e tij kryesor? **Mobiliteti** është fjala kyç, është kodi që mbizotëron në çdo analizë të deritanishme, që është fizike, por që nuk është zërtëyer ende. Është instrumenti, me të cilin itinerari nisur nga Ballkani mbërrin në destinacionin Tetovë .





STARS

BETI ADRIATIK

Beograd

Nish

JEN

ajjeve

orice


Shkoder

Tirane

Selanik

Athine








Tetova, si qytet kyç i njërës prej mushkërive të Maqedonisë bën pjesë në një strukturë lineare qytetesh, të cilat janë aq të ngjashme si fizikisht, në formim apo dhe në forma të brendshme të qytetit.


Mobiliteti në forma të ndryshme të tij: ajror, motorik, hekurudhor, këmbësor, energjitik, teknologjik (email, telefon etj) do të ishte një formë njohjeje për Tetovën në rajon, njohje e cila bazohet kryesisht në këtë sistem të përbërë prej 5 pikash kyçe, që do të formonin Metropolin e Maqedonisë: Gostivari, Tetova, Shkupi, Aeroporti, Kumanova. Mobiliteti është potenciali kryesor në Metropolin GO-TE-SKO-AIR-KU dhe është i formuluar shumë qartë në territorin e tij.







Aksi hekurudhor, i cili përforcohet dhe i shërben tashmë trenit me shpejtësi të madhe.





Koncepti i krijimit të Metropolit të Maqedonisë është pjesë thelbësore e Destinacionit Tetovë. Shkallë-shkallë ai merr formë fizike e reale duke u konkretizuar në aksin linear Gostivar-Tetovë-Shkup duke thyer kësisoj barrierat, ngushtuar distancat dhe reduktuar kohën.


Duke i marrë në veçanti këto pesë pika-qytete kyçe e duke evidentuar lidhjet e tyre fizike me anë të analizave, përsëri në hartë shohim se relacioni mes tyre është ideal,



jo vetëm janë pjesë e mushkërisë, pjesës jetësore të Maqedonisë, por linjat ajrore, hekurudhore dhe ajo automobilistike të evidentuara më qartë në harta gati i kthejnë ato në një strukturë unike të përbashkët.

Ky mbetet qëllimi dhe roli final i Metropolit, të arrijë në destinacionin Tetovë me anë të korridoreve të formuara mirë, shtetërore dhe ndërshtetërore, me anë të hekurudhës që të siguron një tren me shpejtësi të madhe, me anë të aeroportit,

i cili nuk do të njohë me distanca me qytetin e Tetovës falë lidhjes së mirë me të dhe pse jo dhe me anë të mjeteve të tjera komunikuese të rinovuara, si emaili, interneti satelitor, telefonia celulare dhe kabllore, të siguruara në çdo kohë në çdo ambient. Energjia e Ballkanit do përplasej në Metropolin e madh të ri në forma të ndryshme, të rritjes së mirëqënies, ekonomisë, tregtisë, industrisë, turizmit, nivelit arsimor etj.



Të tria "panoramat" që na u shfaqën nga qyteti në analizat e mëparshme ishin jo pa arsye të shkallës së madhe. Ato ishin spuntoja, ngacmimi, inspirimi për analizat dhe hipotezat, që hidhen kur kalon në një "zoom in" akoma më të madh, aty ku sheh se si është vërtetë qyteti i strukturuar, se cilat janë potencialet e tij natyrore, fizike, sociale.

Ndonëse një qytet i vogël, Tetova të ngjall mjaft kuriozitet, teksa sheh se si forma e saj mban brenda një sërë faktorësh që nga elementet morfologjike, historike e deri ato politike.

Duke bërë qoftë edhe një lexim të shpejtë formal, në mund të arrijmë

ta zbërthejmë qytetin. Elementi që spikat i pari është skeleti linear i vetë qytetit, i përbërë nga linjat e forta të rrugëve, nga bërthama mjaft e dallueshme historike, nga ku mendohet të ketë lindur qyteti dhe nga objekte të forta "sinjal", që ndërthuren në pëlhurën hapësinore.


Më pas dallojmë se si rrugët përbëjnë më së tepërmi linja horizontale paralele që përshkojnë gjithë qytetin dhe që në të vërtetë janë ato linja, që përmenden që në shkallën më të madhe, njëra pjesë e Korridorit 8, njëra e aksit të Metropolit dhe linja të tjera që formohen prej morfologjisë së terrenit dhe të strukturës lineare të gjitha qyteteve dhe fshatrave që ndjekin aksin linear të tij.

Një lexim i dytë do të ishte duke u bazuar tek linjat e mësipërme horizontale, por duke shtuar edhe vertikalet, të cilat formohen prej lumit apo prej nevojës për të lidhur qytetin e ndarë horizontalisht. Si përfundim do të kishim qytetin e ndarë në formë unazash, të cilat veçohen nga njëra-tjetra si ishuj.

Me të njëjtën mënyrë një tjetër lloj paraqitjeje do të ishte ajo e unazave, të cilat koncentrohen në qendër dhe përhapen në formë valësh në pjesët e zhvilluara më vonë dhe ato periferike të qytetit.

Si ndërthurje e gjithë këtyre është dhe leximi në formë rrjete gati hipodamik, që ndjek më së tepërmi linjat reale të akseve, të horizontaleve, vertikaleve dhe lumit.

E gjithë kjo analizë shërben për të kuptuar se duke lexuar qytetin në mënyra të ndryshme dhe kaq të thjeshta, ai të lejon që me pak ndërhyrje të arrish ta transformosh në një qytet të organizuar mirë, ku potencialet e tij janë të dukshme dhe bëhen pjesë e jetës së vetë qytetit dhe banorëve të tij.



Linear




Ishullor



Koncentrik



Hipodamik



LIVINGCITY INVESTIGATION  
CONTINUES AS CITY  
IDEA PROJECT GETS  
UNDER WAY

MAGNETIC

TETUVO

631

DES



## Stacioni

Energjia që vjen prej Rajonit Ballkanik, e kalon nëpërmjet Metropolit koncentrohet në qytet, në pikën e vetme lidhëse momentalisht me të, Stacionin e Trenit dhe Terminalin e Autobusave, çernierin e fundit të sistemit nga ku më pas kjo energji shpërndahet nëpër gjithë qytetin, duke lidhur e zbuluar hap pas hapi potencialet e dukshme dhe të padukshme të tij.




Duke u kthyer pas në hipotezën kryesore, e cila ka për bazë relacionin e ngushtë që krijohet mes rajonit dhe qytetit, lind nevoja për ta konkretizuar atë më tej në kontekstin tetovar. Nëse Tetova do të veprojë si një destinacion i lindur nga energjia që thith nga Ballkani, siç evidentohet në të gjitha analizat e deritanishme, nevojitet që ajo të tregojë tashmë: cili është roli i saj në këtë bashkëveprim? Energjia që mund të gjenerojë ajo vetë për banorët e vizitorët e saj duke shfrytëzuar potencialet që zotëron, është mënyra më e mirë.

Nëse Stacioni është pika lidhëse dhe ka këtë rol në të ardhmen e Tetovës, duhet analizuar fillimisht se si pozicionohet dhe i imponohet momentalisht qytetit. Prej analizave në këtë shkallë evidentohet se Stacioni sëbashku me Terminalin e Autobusave ndodhen në periferi, në një zonë ish-industriale. Pozicioni është i favorshëm duke qenë se shumë pranë ndodhet by-pass-i dhe autostrada që e lidh me kryeqytetin, hekurudha dhe akse të tjera pjesë të Metropolit.



Ndërsa si pika potenciale të qytetit kemi elementet natyrore të tij, Malin e Sharrit e Kodrën e Diellit, pikë turistike, e cila i shërben tashmë rajonit







duke tërhequr jo vetëm banorët e Tetovës, por dhe turistë të huaj nga vende të ndryshme. Element tjetër natyror dhe strukturues i qytetit është lumi që përbën përsëri një nga potencialet më të rëndësishme e që pasohet më pas nga zonat e gjelbra të shpërndara spontanisht ne territor. Potenciale të tjera përbëjnë objektet historike, si Kalaja apo objektet e kultit, Xhamia e Larme, Hamami, Kishat, Teqeja etj. Pas nuk ngelen dhe elemente, si zona industriale, bujqësore, si dhe zonat sportive me dy stadiumet e qytetit të evidentuara në harta.



Unaza Balpases I Qendres Historike





Në vazhdim të hipotezave dhe prekjeve në qytet, pasi kemi analizuar më parë lexueshmërinë e strukturës së tij, mund të hedhim disa idese potencialet-energji të përmendura më sipër, do të mbërrijnë në Stacionin çernierë duke shfrytëzuar mobilitetin dhe akseset. Fillimisht bëjmë një rivlerësim të akseve kryesore ekzistuese, ruajmë funksionin e Bypass-it të qytetit, i cili lidh Tetovën me Shkupin dhe me Metropolin.

Ai do shërbejë jo vetëm për forcimin e kësaj lidhjeje, por edhe si eliminues i trafikut të makinave me tonazh të rëndë nga qyteti. Përgjatë itinerarit ai siguron akses dhe lidhje të zonave industriale, zonave bujqësore, të hekurudhës si dhe të universiteteve në hyrje të qytetit. Në këtë mënyrë funksionet dhe zhvillimi që merr zona përreth përbëhet kryesisht nga funksione ekonomike, tregtare dhe zhvillim i zonës industriale.



IN MANY WAYS THE ESSENCE OF THE CITY IS THE SUPREME COMING TOGETHER OF EVERYTHING OF IT ALL PEOPLE COME AND GO IT'S ALL MOVING THE BITS AND PIECES THAT FORM THE CITY — THEY'RE EXPANDABLE



Aksi tjetër që rivlerësohet është horizontalja e dytë që bën një lidhje tjetër të qytetit me rajonin, duke kaluar më parë një sërë fshatrash dhe rrethinash. Megjithatë, ky aks që nuk është i kompletuar tërësisht gjatë itinerarit të tij, nuk do të ketë vetëm këtë synim. Funkzioni kryesor i tij do të jetë ruajtja e potencialit historik të qytetit. Ai e evidenton këtë bërthamë historike, duke kornizuar skajet e saj dhe duke e lehtësuar atë tërësisht nga trafiku i makinave. Në sajë të tij zona kthehet në këmbësore, duke rivlerësuar edhe një herë rëndësinë e saj historike dhe duke e kthyer në zonë të vizitueshme nga publiku.

Funksionet kryesore që plotësojnë aksin do të kenë karakter tregtar, kulturor dhe do të ndërthuren veç akseve të makinave me një sens që largon fluksin nga qendra edhe rrugë të tjera këmbësore dhe biçikletash, të cilat përshkojnë zona të gjelbra në zonat përkatëse. Ky aks has përgjatë rrugëtimit fshatrat kryesore të Tetovës, teleferikun që të çon në pikën turistike të Kodrës së Diellit, Teqenë Arabati, varrezat dhe më pas i vjen për qark zonës historike duke takuar një tjetër objekt historik, Xhaminë e Larme e më pas përshkon pjesën tjetër të qytetit duke përfunduar tek zona sportive dhe stadiumet. Pas këtij rivlerësimi që i bëhet aksit, kuptohet se nevojitet, futja e transportit publik duke qenë se banorët do të kenë akses më të madh në këtë aks. Lëvizja me anë të autobusëve urbanë do të

ishte një nga zgjidhjet.

Përsa i përket zemrës historike, veç rrugëve këmbësore vizitorët do kenë mundësi të lëvizin edhe me anë të tramit që përshkon zonën në formë unaze. Akset e tjera që mund të rivlerësohen pasi përcaktohen këto dy më të rëndësishmet janë akset vertikale, të cilat do të shërbejnë si akse lidhëse dhe plotësuese të të dyjave.

Si përfundim vlen të rishikohet edhe njëherë, duke u kthyer një hap më mbrapa për të kuptuar se si Stacioni, si çernierë mban gjithë mobilitetin dhe strukturon pëlhurën e qytetit me anë të një organizimi më të mirë të infrastrukturës të akseve hyrëse dhe dalëse nga qyteti, qarkullimin e brendshëm që evidentohet më sipër, por veç kësaj, ai vetë ofron një arkitekturë të re, imazh të ri, shërbime të reja. Ai vetë kthehet në model të organizimit hapësinor, duke qenë se mbledh në strukturën e tij gjithë energjinë e qytetit, akset e biçikletave, makinave, autobusave, trenit. Mënyra se si të gjitha këto akse do përplasen dhe ndërthuren në një objekt të vetëm, do të jetë ajo që do ta kthejë terminalin në një pikë tunduese të vertetë për qytetin dhe vizitorët e tij. Kjo lidhje përforcon edhe njëherë Destinacionin Tetovë, energjinë humane të banorëve dhe të turistëve që vijnë. Tetova tashmë do të shndërrohet në një **destinacion** të ri dhe të fuqishëm i të gjitha guidave turistike në Maqedoni.










2


# Tetova 3T


Klaudjo Cari





Nisur nga studimet **gjeopolitike**, historike dhe ekonomike, **Tetova 3T** propozon **rikthimin** e një prej akseve historike **Tetovë - Prizren**, më të rëndësishëm për zhvillimin e rajonit. Kjo do të sjellë jo vetëm në rajon, por edhe në qytet, një **energji** duke krijuar **zona të reja** të gjelbra, sportive dhe çlodhjeje.






## Gjeopolitikat historike

Projekti vizion Tetova 3T (Porta e Re) nisët fillimisht nga hulumtime të natyrës, gjeopolitike dhe historike si pjesë e universit që Tetova zotëron. Nga gjithë potencialet natyrore, ekonomike dhe kulturore të Tetovës, një lidhje e cila mund të çonte më tej zhvillimin e qytetit dhe ta lidhte me të afërmit mungonte. Kjo lidhje e ndërprerë ishte rruga Tetovë – Prizren, duke i lënë këto dy qytete kaq afër dhe prap kaq larg. Në vazhdim të projektit “Tetova 3T” do të njihemi me të mirat që do të sillte rrëzja e këtij aksi për qytetin në veçanti dhe për rajonin në përgjithësi.

Tetova është një qendër ekonomike, kulturore dhe administrative, e cila gjendet në pjesën veriperëndimore të Maqedonisë. Ajo njihet që në kohët antike ku përmendet me emrin Enea. Një ndër faktorët që ka ndikuar në mbijetesën e saj ndër shekuj është edhe pozita gjeografike. Zona verilindore e Tetovës konturohet nga Kosova, më saktë: në Veri me Prizrenin dhe Veri-Lindje drejt Prishtinës. Ndërkohë drejtimet e tjera simetrike me të parat kufizohen nga dy qytete tepër të rëndësishme maqedonase: Shkupin (drejtimi jugor) dhe Gostivarin (drejtimi perëndimor). Ishte pozita e mirë gjeostrategjike e vendndodhjes në udhëkryq si dhe prania e pllajës pjellore të Pollogut që ua tërhiqte vëmendjen banorëve lokal e të huaj. Me ardhjen e Perandorisë osmane u zhvillua midis të tjerash më dukshëm kultura orientale. Vatër e saj në qytetin e Tetovës bëhet kompleksi i Teqes Bektashiane “Harabati Teqe”.

Një rrugë e rëndësishme tregtare ishte ajo midis Tetovës dhe Prizrenit, e cila lidhte Stambollin me Perëndimin. Kjo rrugë karavanesh sillte një numër të madh udhëtarësh në qytet, duke e shndërruar Tetovën në një qendër të rëndësishme tregtare, e cila rrethohej nga mali “Sharr” dhe mali i “Thatë”. Pikërisht në shpatet e malit “Sharr” shtrihej dhe rruga e vjetër, e cila sot nuk ka më ndikimin e dikurshëm në ekonomi pasi nuk frekuentohet si më parë. Sot është turizmi ai që zë një vend të rëndësishëm në ekonominë e Tetovës. Kryesisht si vende dhe objekte turistike janë të njohura: Hapësira e mbrojtur çlodhëse turistike “Kodra e Diellit (Popova Shapka)” në shpatet e malit Sharr, e njohur për zhvillimin e sporteve malore gjatë dimrit si dhe objekte të shumta me vlerë kulturore dhe historike brenda qytetit.



Këto vlera kulturore historike të Tetovës u veçuan nga vetë banorët gjatë intervistimit të bërë më parë në qytet, si pjesët më të parapëlqyera dhe të frekuentuara në jetën e përditshme dhe ditët e pushimit. Ndryshe nga vizita e dimrit, ku Tetova e mbuluar nga bora transmetoi një ndjesi paqeje dhe qetësie, në pranverë banorët na ndihmuan të njiheshim më nga afër me të mirat dhe problematikat e qytetit. Falë këtyre vizitave, u arrit përpilimi i disa vizioneve që do tentonin t'i rikthenin Tetovës energjinë, forcën dhe jetën e shëndetshme që gëzonte dikur.

Pozita gjeografike e Tetovës është ajo që nxit drejt imagjinimit të akseve të reja të komunikimit të saj me qytetet rrethuese, akse dikur ekzistuese që i kanë sjellë Tetovës avantazhe, por tashmë të lëna në harresë për një kohë të gjatë. Në bazë të këtyre të dhënave historike dhe analizës ekonomike, u arrit në konkluzionin se një rrjetë e këtij segmenti do të çonte në lulëzimin e qytetit të Tetovës sërisht, duke i rikthyer atij rëndësinë e dikurshme. Me krijimin e katër unazave ballkanike Tetova rikthehet si një akumuluese e të gjitha energjive të ardhura nga qytetet rrethuese brenda Maqedonisë, Serbi-Kosovë, Mali i Zi-Shqipëri, ku spikat së fundmi rruga Durrës-Kukës-Morinë-Prizren+Tetove, pjesë të së cilës janë ndërtuar dhe me mbarimin e tërë punimeve do të realizohet aksi më i mirë në rajon. Le të jetë ky fillimi i një epoke të re për Tetovën, i një epoke zhvillimi e integrimi si në shkallë rajoni, ashtu edhe në shkallë mbarëeuropiane, duke shembur këtë barrierë që ekziston midis Tetovës dhe Prizrenit e duke e kthyer atë jo më si një pengesë, po si një burim zhvillimi. Mali i Sharrit do të shndërrohet në një pikë joshëse turistike ashtu si vetë Tetova, ku të gjitha pasuritë natyrore të fshehura nën hijen e tij do të shpalosen me të gjithë madhështinë e tyre për vizitorët nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e me gjerë, duke i bërë tetovarët më krenarë për qytetin tashmë të rilindur.




## Akse historike

Tetova pikë nyje përgjatë korridoreve transportuale historike

GREQIA

Lidhja midis Tetovës dhe Prizrenit nuk është aspak diçka e padëgjuar, pasi po t'i referohemi historisë njihen disa faza evoluimi në këtë drejtim, sepse kjo rrugë ka ekzistuar edhe më parë. Gjatë periudhës otomane pjesë të trojeve Ballkanike funksiononin si një e vetme pjesë të Perandorisë Otomane. Alternativa e vetme e karavaneve për të përshkruar drejtimet: jug-perëndim (me dalje në detin Adriatik) ishte korridori "Via Egnatia" dhe në Veriperëndim rruga "Stamboll-Bosnie", e cila përfshinte aksin Tetovë-Prizren. Këto përshkoheshin nga tregtarë vendës e të huaj, sidomos venedikas, të cilët vinin nga përtej Stambollit nëpërmjet këtyre dy korridoreve të rëndësishme. Këto rrugë shtriheshin kryesisht në fushë me përjashtim të segmentit Tetovë-Prizren i cili ndahej nga Mali i Sharrit, duke i detyruar udhëtarët të ndalonin në Tetovë para se të kalonin këtë barrierë përmes luginës së lumit Pena. Jo rastësisht Tetova gjatë periudhës së sundimit otoman, mori emrin "Kalkandele", që do të thotë të depërtosh si shigjetë një mburojë (barrierë). Kështu të detyruar të kalonin natën në Tetovë, përpara kalimit të malit, rrugëtarët furnizoheshin me ushqime duke nxitur kësisoj në këtë qytet të vogël tregtinë, kulturat dhe shkëmbimet sociale dhe duke ndikuar në një zhvillim më të madh të qytetit. Prezenca e komplekseve fetare dhe haneve ndikuan më shumë që Tetova të shndërrohej në një pikë të favorshme tregtie, për shkak të ndalesave të karavaneve. Kjo ishte arsyeja pse Tetova u bë mjaft e rëndësishme në këtë periudhë.



## Viti 1913


Tetova vazhdoi të ishte për një kohë të gjatë një pikë e rëndësishme në lidhjen midis Stambollit dhe trojeve të tjera veri-perëndimore, Bosnje, Dubrovnik e Mal i Zi. Por një nga ndryshimet radikale që ndikoi në zhvillimin e mëtejshëm të Tetovës, ishte ai i krijimit të mbretërisë dhe më vonë Jugosllavisë. Brenda territorit të saj u përfshinë edhe Maqedonia e Kosova. Me këtë organizim të ri të hapësirës trajektoret ekzistuese nuk kishin më të njëjtën rëndësi. Nga koncepti i hapësirës unike ballkanike u kalua në fragmentizim dhe krijimin e kufijve e pikave doganore. Me ndarjet e reja territoriale u krijuan dhe akse të reja në shërbimin e shteteve përkatëse, por pa u kujdesur për impaktin jo të mirë që kjo do të kishte në pjesë të caktuara të rajonit, si për shembull në Tetovë. Këto trajektore më të shkurtra eklipsuan segmentin e dikurshëm Tetovë-Prizren. Në atë periudhë, natyrisht, që edhe tregtia e ekonomia u ndikua nga ky rrallim i lëvizjeve në këto treva.

## Lidhjet dhe gjeopolitikat e reja

Në bazë të këtyre të dhënave historike është arritur në konkluzionin se një rrethje e këtij segmenti Tetovë-Prizren, do të çonte në lulëzimin e qytetit të Tetovës sërishmi, duke i rikthyer asaj rëndësinë e dikurshme. Me krijimin e këtyre katër unazave ekonomike ballkanike, Tetova rikthehet si një akumuluese e të gjitha energjive të ardhura nga qytetet brenda mushkërisë ekonomike perëndimore të Maqedonisë, nga unazat Shkup-Kosovë-Serbi, Maqedoni-Shqipëri-Kosovë e Kosovë-Mali i Zi-Shqipëri.



## Analiza teritoriale në rang rajoni

Pozita gjeografike e Tetovës është mjaft e favorshme dhe paraqet potencial zhvillimi si në shkallë ballkanike-europiane ashtu edhe në atë rajonale ndërqytetare. Ajo ndodhet në qendër të disa qyteteve të tjera mjaft të rëndësishme, siç janë Shkupi, Prizreni e Gostivari. Ky është një tjetër avantazh i Tetovës, pasi ka mundësi bashkëveprimi e shkëmbimi me këto qytete. Kështu, gjithçka duket e favorshme për qytetin e Tetovës me një të ardhme më të mirë në horizont. Fatkeqësisht, ky zinxhir komunikimi ndërpritet nga mali "Sharr". Duke lënë të shkëputura Tetovën nga Prizreni dhe banorët e Pollogut nga Kosova e Shqipëria. Sa paradoksale aq dhe e vertetë, kaq afër dhe prap kaq larg. Është pikërisht ky devijim i kushtëzuar nga mali "Sharr" që e lë qytetin e Tetovës të përjashtuar nga ky rreth zhvillimi e komunikimi shqiptaro-kosovaro-maqedonas për njerëzit, mallrat dhe idetë.







# TETOVA 3T TUNEL zhvillim ekonomik Porta e Re aksë historike gjeopolitikat e reja TRAMVAJ TELFERIK zhvillim social

## hapësira të gjelbra TETOVA 3T gjeopolitikat e reja zhvillim kulturor hapësira të g zhvillim social aksë historike Porta e Re






## Akset historike dhe zhvillimi i qytetit

Nga ana formale Tetova është e përbërë nga dy akse pingul me njëri-tjetrin, të cilat zgjaten duke i dhënë një formë elipsoidale gjithë qytetit në drejtimin lindje-perëndim, që ka funksionuar pa barriera. Tetova fillesat me sa duket, i ka pasur pikërisht në kryqëzimin e këtyre dy rrugëve shumë të rëndësishme. Më pas u zhvillua në drejtim të fushës së Pollogut duke ndjekur rrjedhën e ujërave në zonë, drejt lumit Vardar. Ky ekspansion vazhdon ende deri në ditët e sotme ku dallojmë qartë formën elipsoidale. Unazat e qytetit ndërtuar në vite janë ende të paplota, për shkak se qyteti e ka marrë zhvillimin të ndjeshëm nga pjesa jugperëndimore (Zona Universitare). Për të plotësuar formën elipsoidale dhe kaluar zhvillimin në lindje, propozohet pikërisht plotësimi i dy unazave që do të çojë në një lidhje gjysmëunazore të mirëformuar.









## Porta e Re


Zhvillimi i Tetovës aktualisht graviton nga ana jugperëndimore, në zonën studentore, zonën sportive dhe atë qendrore. Për të bërë një balancim në territor propozohet që porta e re e qytetit të jetë e pozicionuar në anën lindore, pranë stadiumit. Pikërisht këtu do të përqendrohet i gjithë fluksi i hyrjes e daljes nga Tetova në Kosovë, madje dhe ai i drejtuar në Veri drejt Prizrenit. Ajo do të shndërrohet në një qendër të re për qytetin, ku do të përfshijë në brendësinë e saj një sërë aktivitete të reja. Thuhet që zhvillimi dhe emancipimi i një qyteti nuk dallohet nga ndërtesat shumëkatëshe që ka, por nga parqet dhe hapësirat publike të gjelbëruara. Këtu të gjithë njerëzit do të ndihen të vlerësuar dhe të barabartë. Përveç përfitimeve ekonomike që do të sillnin këto ndërhyrje në qytet do të përmirësonin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe jetesën e vetë banorëve, pasi ata nuk do të ndiheshin të ndrydhur apo të kërcënuar nga gjithë këto flukse që do të push-tonin qytetin e tyre, por do të shijonin kohën e tyre të lirë në parqet e gjelbëruara, në zonat sportive apo edhe në qendrat tregtare, madje tashmë ata kanë mundësi që në një kohë shumë të shkurtër të vizitojnë shumë zona të qytetit për shkak të përmirësimit të transportit.





## Lidhja e 7 pikave energjetike në qytet

Në brendësi të qytetit në bazë të analizave të detajuara kanë rezultuar shtatë pika potenciale: stacioni i trenit, qendra e qytetit, zona e Kishave, bërthama e vjetër, pazari dhe teqetë, Xhamia e Larme, Hamami dhe zona Universitare. Në projektin tonë pikërisht këto nyje energjie të qytetit shndërrohen në pika ndalese të tramvajit të propozuar, i cili do të lehtësonte së tepërmi lëvizjen dhe energjinë që krijohet në pjesën e vjetër të qytetit. Kjo i jep zgjidhje ekonomike edhe mobilitetit e transportit në qytet, që do të çonte në zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë së Turizmit.






## Akumulimi i energjisë dhe shpërndarja e saj

Në ditët e sotme Tetova është e zhvilluar në zonën jugperëndimore. Aty janë të përqendruara flukset kryesore për shkak dhe të funksioneve të rëndësishme që gjenden në këtë zonë, si universitetet e zonat sportive. Për t'i dhënë një gravitacion të ri funksionesh më të balancuara në të gjithë qytetin e përqendrojmë energjinë në anën tjetër të tij me anë të krijimit të së ashtuquajturës 'Porta e Re'.

Për të bërë një shpërndarje në mënyre uniforme të gjithë kësaj energjie të akumuluar propozojmë një tjetër mjet transporti përveç atij klasik automobilistik, teleferikun. Ky mjet transporti që ekziston në qytet për shkak të turizmit malor dhe sportit të skive, propozojmë ta zhvillojmë më tej duke e zgjatur në drejtim të Kalasë dhe në brendësi të qytetit, duke i dhënë dhe përdorimin në aspektin e turizmit historik dhe kulturor. Kështu, njerëzit mund të kenë akses të drejtpërdrejtë në qytet dhe në mal drejt resortit.







Prizren

Kaaja

Gostivar





Kosove

Shkupi



# Gjelberimi ne zonat malore



te

## Hapësirat e gjelbra për gjenerimin e jetës

Propozimi në këtë hap vjen për shtimin e hapësirave publike dhe të gjelbra në Tetovë. Hapësirat publike synojnë të jenë të ndikuara nga natyra, e cila është prezente në tri forma në Tetovë: në gjendje të egër dhe në dobi të Turizmit (zonat malore); e sistemuar në brendësi të qytetit (dekoracioni urban); fushat e sistemuar e të mbjella (burimet ekonomike). Shohim këtu që hallka e mesit sërish është e paplotë. Për këtë vjen propozimi i një parku, i cili do t'i shërbente gjithë qytetarëve të Tetovës dhe do të rriste zhvillimin e anëve perëndimore dhe lindore.

faktor



## Tetova 3T / Porta e Re

Porta e Re nuk do të jetë një hyrje alternative për qytetin e Tetovës, por do të ndryshojë tërësisht imazhin e saj. Tetova nga një qytet periferik do të shndërrohet në qendër, në një kryqëzim të ri që do të mbledhë flukse nga rajoni dhe më gjerë. Ajo do të jetë në gjendje t'u ofrojë banorëve një sërë shërbimesh të reja si administrative, ashtu edhe çlodhëse. Elementi kryesor rinovues do të jetë mobiliteti (transporti), i cili do të zhvillohet në tri drejtime të reja: hekurudhor (ku një linjë tramvaji lidh 7 pikat energjetike të qytetit me "Portën e Re" automobilistike nëpërmjet një ure të varur, një strukturë e lehtë, elegante, që do shndërrohet në pjesë identifikuese të imazhit të Tetovës); linja teleferike, e cila tashmë nuk do të përdoret vetëm në zonën malore, por edhe në brendësi të qytetit për zhvillimin e turizmit historik dhe tuneli, një mundësi për bashkimin e dy qyteteve, Tetovës dhe Prizrenit, duke sjellë zhvillimin ekonomik, turistik dhe social të zonës.







# XHAMIA E LARME, TETOVË









drejt një Tetove të qendrueshme

Giulia Maci  
Sara Rossi

3

# Water Flakes

Giulia Maci

Sara Rossi

Në Tetovë **uji është një element identifikues** gjatë periudhës së prurjeve pranverore, dhe reshjeve dimërore. Ky projekt nisi pikërisht nga uji për të **përcaktuar një strategji zhvillimi urban**. Këtu prezantohet elementi “Water Flakes” (Flokët e Ujit), një element frakturues që transformon hapësirën. “Floku Ujit” është si një **topografi e re urbane**, gjithashtu edhe një element mbledhës dhe filtrues i ujit të shiut: një proces ciklik, ku **uji dhe terreni** gjenerojnë në mënyrë të vazhdueshme vetveten.





## Flokët e Ujit

Giulia Maci

Sara Rossi





Ndryshime Historike të kufijve kombëtar të Maqedonisë

## Të dizenjosh kufij të rinj

Ballkani paraqitet si një territor tepër i fragmentizuar, ku përgjatë rrjedhës së historisë janë takuar dhe përplasur kultura, vizione dhe etni të ndryshme. Gjeopolitika ka dizenuar më shumë kufij sesa na shfaqen aktualisht. Në Ballkan termi "Kufi" është thelbësor dhe shpreh një element ndarjeje dhe mohim të kulturave të jashtme. Është e rëndësishme të mendohet kufiri si një element topografik, që i përket dy hapësirave, një sipërfaqe e shënuar si vazhdimësi dhe interpretim i kulturave. Në leximin e historisë së Ballkanit evidentohen dy tendenca: e para, mbi shkëmbimet midis popujve dhe e dyta kontravesale me të parën, ndryshimet midis popujve. Të njëjtët popuj që janë afruar me njëri-tjetrin për shkak të kulturës së përbashkët përpiqen të ruajnë dhe të përforcojnë fizionominë e tyre.

Konflikti i lindur midis këtyre dy tendencave është faktori përcaktues i historisë së këtyre vendeve. Është interesante të mendosh të ridizenjosh kufijtë e këtyre vendeve duke u nisur nga topografia dhe nga elementet e peizazhit. Malet e ndajnë hapësirën në lugina dhe janë këto të fundit që mbartin treva fizikisht dhe entografikisht të ndryshme. Por malet nuk janë barriera, përveçse nga pikëpamja meteorologjike. Ata zotërojnë një hapësirë çernierë, përreth së cilës zhvillohet një botë "fluide", ku shkëmbehen njerëzit, idetë, ndjenjat dhe besimet e tyre. Mjafton të vëzhgohet uniteti lingistik dhe kulturor që lidh duke tejkalluar malet, Tetovën, Gostivarin, Prizrenin dhe Prishtinën. Më pas janë rrjedhat ujore që tejkalojnë barrierat, tejkalojnë ngushticat e krahina dhe strukturojnë hapësirën.








Në qoftë se popuj të ndryshëm pijnë të njëjtin ujë, sistemet ujore mund të shndërrohen në element të riqepjes së ekosistemit dhe në mënyrë më të përgjithshme element të rikompozicionit territorial. Peizazhi paraqet elementin strategjik për të përmirësuar kualitetin dhe për të përforcuar identitetet e komuniteteve lokale. Në të njëjtën kohë nevojitet të lexohet peizazhi si një e mirë e përbashkët që ka nevojë për një projekt mbi ruajtjen dhe vlerësimin e tij. Rrjetat ekologjike dhe hidrografike mund të konsiderohen si baza të një projekti peizazhistik të integruar me Korridoret Europiane 8 dhe 10, që përshkrojnë Ballkanin. Uji shndërrohet kështu, nga njëra anë, në infrastruktura kulturore të territorit dhe nga ana tjetër, në një burim të rëndësishëm energjetik dhe ekonomik.

Edhe në shkallë kombëtare janë evidente ndarjet e brendshme, kështu pllaja e Pollogut, në të cilën dominon komuniteti shqiptar i Maqedonisë, vuan nga marginalizimi ekonomik. Rrjeti ujqor është lidhja më e rëndësishme e zonave pyjore malore dhe kodrinore dhe e peizazheve natyrore e zonave të mbrojtura. Ajo është pikënisja për të sjellë një politikë të re për manaxhimin e territorit. Shkrimtari Claudio Magris e përshkruan peisazhin si portretin e një personi të dashur, ku nëse përqendrohesh mund të lexosh rrudhat, vragat, shprehitë dhe të zbulosh historinë e të shkuarës së tij. Është e mundur të nisesh nga eksperiencia private e drejtpërdrejtë e njerëzve me territorin, për të arritur në hartimin e një strategjie ndryshe mbi zhvillimin e territorit. Nga një kartografi e brendshme vizionare në mund të dizenojmë një gjeografi të re.

**TË RIDIZENJOSH PEJSAZHIN**  
Sharr-Korab  
sistemi i maleve






“Forma fraktale” e qyteteve kontemporane është rezultat i rritjes urbane dhe fragmentizimit

### Struktura Ujore “Water Frames”

Tetova ka pësuar vitet e fundit një rritje të shpejtë: territori urban është përballur me fragmentizime dhe mosvazhdimësi. Mund të merren shumë shembuj të qyteteve bashkëkohore, të cilat kanë kaluar të njëjtën situatë si Tetova dhe të kuptosh sesa e vështirë ka qenë për to përcaktimi i saktë i limiteve të tyre. Siç ka vëzhguar François Choay, qytetet nuk integrohen në një kontekst natyror dhe kulturor, por i shtohen sistemeve infrastrukturore si Korridori 8 dhe 10, pra mungon “lidhja me territorin”. Me zhvillimin urban është humbur identiteti i qyteteve dhe vendeve, zonat natyrore dhe agrikulturore mbeten në harresë, ndërsa hapësirat funksionale të qytetit janë të paaksesueshme apo një pjesë e tyre përfundojnë në degradim të kushteve të jetesës. Është interesante të vëzhgohet prezenca e hapësirave boshe në Tetovë. Këto hapësira janë një rast i mirë për ta parë qytetin nëpërmjet tyre, si strukturuese për një Tetovë të re. Në këtë rast nevojitet një akt i përcaktuar nga ne si “vërshim ujor”, ku uji bëhet elementi për riprojektim të korridoreve natyrorë dhe lidhës i peizazheve të reja dhe të vjetra urbane. Në vend të shtimit të Brezave të Gjelbër të qyteteve-kopësht të viteve 800, duke riprojektuar dhe vënë së bashku hapësirat boshe në qytet, krijohet një mozaik “frakturash natyrore” që rilidhen me zonat e mbrojtura natyrore, siç është mali i Sharrit dhe lumi Pena.



**shkallë lokale:** transformon peisazhin dhe kthimi në hapësirë rekreative  
**shkallë urbane:** për përmirësim mjedisor  
**shkallë rajonale:** reciklues për mbrojtjen e pasurive mjedisore





Uji në Tetovë, element potencial pozitiv dhe identifikues.

Objektivi është krijimi i një peizazhi infrastrukturor, ku riprojektimi i hapësirave boshe në qytet paraqet një fazë fillestare të një projektimi më të gjerë drejt një zhvillimi urban mjedisor të qëndrueshëm (sustainable urban design). Aplikohet një strategji frakturimi, ku zgjidhet “Floku i Ujit” (molekula e ujit), si një element i përsëritur nëpër qytet, i cili modifikohet dhe transformon hapësirën. “Floku i Ujit” nga një anë, dizenjon një topografi të re urbane, nga ana tjetër, mbledh dhe filtron ujin e shiut apo borën. Uji më pas shpërndahet për përdorime të ndryshme publike, si: shatërvane, ujitje kopshtesh, element dekoracioni urban etj. Në mënyrë të tillë zgjidhet problemi i përmytjes së kanaleve të ujërave të zeza. Uji i tepërt rigjen rrugën e kanaleve historike të drenazhimit me destinacion final lumin.

Sistemi ka impakt në shkallë të ndryshme: në atë lokale, ku “Floku i Ujit” transformon peizazhin dhe kthehet në hapësirë infrastrukturore dhe rekreative; në shkallë urbane përdoret për përmirësimin mjedisor, deri në krijimin e një identiteti të ri; ndërsa në shkallë rajonale shndërrohet në riciklues për mbrojtjen e pasurive mjedisore. “Floku i Ujit”, i cili përsëritet duke variuar në formë dhe specifikë, nuk do jetë vetëm një formë e dallueshme, por krijues i një sistemi virtuoze që ofron mundësi të ndryshme mbi ruajtjen dhe përpunimin e ujit natyror. Aplikimi i principit të ngjashmërisë mundëson arritjen e variacionit brenda formës unike, një detaj i ngjashëm me një strukturë paraprake dhe njëkohësisht i ndryshëm. Ky trajtim sjell kompleksitet, variueshmëri dhe barazi.






## Strategjia Urbane mbi Mobilitetin

Gjithashtu rimendohet sistemi i qarkullimit motorik, çiklistik e këmbësor. Zona historike e qytetit shndërrohet në zonë me trafik të limituar, transporti publik është mjeti kryesor i transportit, duke limituar mjetet e kalimit të qytetit. Rrugët e transportit të shpejtë dhe linjat hekurudhore kalojnë në ekstremitetet e qytetit, ku parku ujor dhe rrjeti i gjelbër mundësojnë tejkalimin e barrierave infrastrukturore dhe riformojnë unitetin urban. Edhe rrugët kryesore, Iliria dhe Ilidenska janë riprojektuar me idenë e rivlerësimit të rolit shoqëror. Me anë të propozimit të sistemit “woonerf”, mundësohet ngadalësimi i trafikut, ndërsa parkimet janë të shpërndarë në mënyrë racionale. Ndalesat e reja të autobusit, dekori urban dhe vegjetacioni përcaktojnë një dimension të ri urban. Propozohet gjithashtu edhe një trajtim për rrugët me sens unik në zonën historike: veshje e re e dyshemesë urbane dhe vlerësim i vegjetacionit në funksion publik. Këto rrugë rezervojnë një dimension të ri më privat/të veçantë të qytetit.


- ◆◆◆◆ main streets
- ◆◆◆◆ one-way streets
- ◆◆◆◆ woonerf
- urban bus
- tramvia
- historical channels
- pedestrian paths
- urban bus station
- regional bus station
- tramvia station
- fountains of potable water
- restricted traffic area
- catchments
- linear park
- vacant spaces
- regional functions







**RRUGA LLINDENIT: EXISTING CONDITIONS**



7 meters of carriageways  
2.75 of bikeways  
4 meters of busways

Maintain the street free of parking and allocate car parking zones in secondary roads.

System of woodseef to slow down cars.

Use the pattern of paving or surface material and landscape elements to distinguish the carriageway from the other areas.

Introduce street trees to green the street, but also act as vertical elements to assist in calming traffic.

Separated bus way and integration between pedestrian areas and the bus stop.

**SYSTEM OF WOONERF: TRANSFORMATION**

**RRUGA ILLIRIJA: EXISTING CONDITIONS**



Adopte the minimum carriageway dimension for two-way traffic.

Provide an adequate level of car parking to meet local needs, within the direct vicinity of people's home.


Use ballards or other means to protect the areas directly in front of houses' entrances.

Make an interesting pattern of paving to indicate stop buses that is introduced into scheme.

Dehors with more of 2 meters of free public spaces, 30% of public space.

Use the pattern of paving or surface material to distinguish the carriageway from the other areas of pedestrian use.

**NEW STREET DESIGN: TRANSFORMATION  
PRINCIPAL ONE-WAY IN HISTORIC CENTER**



Continuum between carriageway and pedestrianway. Green is 20% of the street.


<the paving indicates home entrances and the difference between private and public spaces.

Introduce street trees to green the street, but also act as vertical elements to assist in calming traffic.

Pattern of street to underline the contact between green area and streets.



system of water supply and water purification




water flakes in urban voids



different dimensions of spaces and filters


## "Flokët e Ujit"

Elementi i "Flokëve të Ujit" ka një formë të thjeshtë, që të rikujton strukturën e një floku bore, ose dizainin e një sistemi natyror të ujërave. Kjo është një rrjetë e sheshtë që i përshtatet topografisë së territorit, duke e ndryshuar funksionin e saj në varësi të hapësirave që takon. Forma primare reduktohet në forma të thjeshta: "Water flakes" të malit, të kodrës dhe të fushës. Flokët e malit janë të pozicionuar në zonat më të larta të qytetit, kanë dimensione më të mëdha dhe mbledhin ujërat e shiut dhe të borës. Në këtë nivel ujërat filtrohen me anë të metodave natyrale, si rrezet UV, apo filtrimit nëpërmjet gurëve dhe rërës. Për të mbledhur ujë në "Flokun e Ujit", përdoret pjerrësia e terrenit apo vendosja e pendencave të qëllimshme. Nga ky nivel uji kalon në Flokët e Kodrinave, ku vazhdon filtrimi me sistemin e fitodepurimit dhe duke shfrytëzuar ende pjerrësinë e terrenit. Në këtë moment kualiteti i ujit arrin një nivel të tillë filtrimi, saqë mund të përdoret në hapësirat publike, duke paraqitur funksione të ndryshme, si: vaditje, dizain, pastrim etj. Degët e Flokëve të Ujit marrin forma të ndryshme apo zhduken nëntokë, duke krijuar modifikime të ambientit dhe duke përcaktuar hapësira të përshtatshme për aktivitete të ndryshme. Disa shembuj të shfrytëzimit të tyre janë si stola urbanë apo shatërvanë publikë; sisteme për vaditje apo komplekse lojërash me ujë për fëmijët. "Flokët e Ujit" janë një rrjet fleksibël, që do t'i sjellë jetë një peizazhi të ri ku evolucioni mjedisor zhvillon specificitetin e elementeve të ndryshme. Pasi uji mbërrin në Flokët






different system of water purification and storage



modification of form of flakes and redesign of public spaces




water flakes as water infrastructure and urban functions activators


Fushorë dhe prej këtej shpërndahet nëpër kanale (pjesërisht të dukshëm e pjesërisht nëntokësorë), i drejtohet lumit. Një element i thjeshtë i vendosur në shkallë të ndryshme, në morfologji të ndryshme të terrenit, krijon varietete topografike, klimatike dhe funksionale. Ky është një proces ciklik, ku uji është peizazhi dhe frakturat gjenerojnë vazhdimisht veten e tyre. Duke krahasuar kërkesat e funksioneve të hapësirave, reshjet mujore dhe aftësinë e akumulimit e të filtrimit të "Flokëve të Ujit", mund të arrihet në hartimin e një programi mbi funksionimin e sistemit. "Flokët e Ujit" mund të funksionojnë të lidhur me njëri-tjetrin, në mikrosisteme nga tri elemente apo edhe të veçantë.

Lumi është elementi qendror i këtij sistemi dhe rimendohet si një park që ndryshon fizionomi sipas stinës dhe sasisë së rrjedhjeve të ujërave. Shtrati i lumit Pena cilësohet si hapësirë e parë në lidhje me sasinë e prurjeve ujore. Në çdo nivel është caktuar një funksion i veçantë në lidhje me afërsinë e saj me ujin. Është e mundur të gjenden: zona pazari, parqe ujore dhe të gjelbëruara, zona për çlodhje apo edhe plazh.

Lumi në stinë të ndryshme ka nivele të ndryshme, këtu ai tërhiqet duke nxjerrë në pah hapësira të reja për qytetin. Edhe njëherë tjetër, ideja që gjeneroi projektin e trajtimit të shtratit lumor dhe krijimit të hapësirës urbane të qëndrueshme, rikthen ujin si element të bashkimi të hapësirave publike në qytet.




"Flokë Uji" të veçantë: mbledhje, purifikim dhe shpërndarje të ujit nëpër banesa.



.Sistem "Flokësh Uji" i trefishtë: shpërndarës urban dhe filtrim i plotë i ujit.








urban green park in low density area



urban green park and water flakes as a filtering element

## Eco-sustainable design

Seasonal changes of river levels become occasions to think about new urban functions



## Water crosses the city/ urban section






public square near the school area



water flakes as design elements of space










4

**Geni Tetovë**

Gjergji Dushniku

Duke analizuar territorin në të cilin gjendet Tetova, si dhe formën e zhvillimit të saj, zbulohet një **rrjetë gjenerative**, e cila përmban **qeliza parametrike me genin Tetovë**. Përdorimi i kësaj metodologjie për krijim, konsolidim, ritrajtim të pjesëve të qytetit, duke ruajtur **esencën Tetovë dhe gjenetikën** e saj... dirigjon këtë sistem të përbërë nga rrjedha ujore, itinerare, parcela etj .....



## Geni Tetovë / Hapësira gjenerative

Gjergji Dushniku

### Hyrje

Ky projekt tenton të krijojë një metodologji për studimin e qytetit, duke u kthyer në një instrument për të vepruar në qytet duke krijuar zona të reja, rigjallëruar zona ekzistuese dhe konsoliduar pjesë të ndryshme të qytetit; duke injektuar esencën Tetovë. Është e rëndësishme ruajtja, rigjenerimi dhe riinterpretimi i kësaj esence, që ky organizëm gjatë ndryshimeve që pëson mos të ndryshojë shpirtin e këtij vendi me identitet dhe karakter të fortë të quajtur Tetovë.

Duke kërkuar këtë esencë, studiohet territori në të cilin ndodhet qyteti, me mbivendosjen e elementeve siç janë frakturat territoriale, sistemet hidrike, frakturat bujqësore, si dhe itineraret historike. Të gjitha këto elemente kanë një sistem të tillë organizimi, i cili pas disa thjeshtimeve na ndihmon të zbulojmë një rrjetë gjeneruese për gjithë territorin, që përsëritet në qytet duke u përputhur plotësisht me strukturën urbane. Në këtë pikë rrjeta merr një logjikë parametrike që e kthen atë nga një zbulim në një instrument. Çdo qelizë e rrjetës duhet të përmbajë esencën ekzistencialiste të qytetit, pra genin Tetovë. Ky gen përmban pëlhurën urbane (pattern), forca, vektor si dhe vetë rrjetën. Pikërisht janë këto elemente që mund t'i përdorim për të konsoliduar, rikrijuar dhe rigjeneruar pjesë të qytetit apo dhe metropolin Tetovë që t'i përkasin, të kenë esencën, të kenë në kodin gjenetik të tyre Genin Tetovë.

Tetova ka karakteristikat për t'u bërë një qytet kontemporan. Nga ana hapësinore dhe strukturore, një qytet kontemporan është një kolazh i përbërë nga morfologji të ndryshme që duhen zbuluar. Kështu, procesformimi nis nga një proces morfogjenetik që bazohet në përkthimin formal të një kompleksiteti qëllimesh dhe jo nga paragjykime tipologjike. Në vizi-tat e vazhdueshme dhe në analizat e mëtejshme qëllimi ishte zbulimi se përse kishte këtë formë Tetova, e shtrirë rrëzë malit të Sharrit ku në mes të saj është lumi Pena. Të gjesh psenë është e rëndësishme sepse gjërat shprehen nëpërmjet formës dhe kjo të çon më pas në gjetjen e formës më të përshtatshme.

Qytetarët e Tetovës janë shumë të lidhur me malin, me ujin dhe me fushat ku shtrihet ky rajon. Janë shumë pranë me natyrën, njësoj si paraardhësit e tyre, nuk e kanë humbur këtë kontakt kaq të nevojshëm me natyrën në një kohë kur qytete të tjera e kanë humbur qëkuri këtë ndjesi. Kjo është pjesë e genit Tetovë. Këtë gjë unë e zbuloj vazhdimisht dhe në analizat e mëtejshme ku qyteti lind në pikëtakimin e fushës me lumin Pena. Rrugët radiale korrespondojnë mjaft qartë me rrjedhjet e ndryshme, që kanë si burim luginën e lumit. Edhe itineraret që lidhin vendbanimet rurale respektojnë këto rrjedha. Kështu dallojmë formën si një aspekt të fundmë të strukturës dhe bazohemi në leximin e qytetit dhe të arkitekturës si një tërësi e vazhdueshme, si pjesë e një sistemi, i cili ishte krijuar bashkë me lindjen e Tetovës. Duke thjeshtuar skemën zbulojmë një rrjetë që gjeneron këtë

sistem të përbërë nga rrjedha ujore, itinerare, parcela etj. Kështu, mesazhet e fshehura tek forma flasin përmes gjuhës së procesit të krijimit. Kjo është pjesë e genit Tetovë.

Rrjeta që gjeneron këtë territor të shtyn të mendosh për të krijuar një logjikë parametrike për t'a kthyer në një instrument. Kjo rrjetë gjenerative me logjikë parametrike përbëhet nga qeliza, ku secila prej tyre duhet të përmbajë genin Tetovë. Kjo mënyrë e të menduarit të qytetit na bën ta mendojmë atë si një organizëm të vazhdueshëm e pa paragjykim, qoftë ky negativ apo pozitiv, pa qendra të rëndësishme dhe më pak të rëndësishme, pjesë të mira apo jo të mira të qytetit, por duke e parë atë si një e tërë. Në këtë mënyrë, qyteti agregohet dhe disagregohet si një mozaik. Lidhjet e çdo pjese me njëra-tjetrën janë të pafundme, në varësi të individit që e jeton këtë hapësirë të gjeneruar si dhe faktorët e studimit. Më e rëndësishmja, ajo që duhet të ketë çdo qelizë e këtij organizmi, e kësaj rrjete, është geni Tetovë.

Tek qytetarët, tek sjellja e tyre, tek jeta sociale geni Tetovë është gjithmonë i pranishëm me zakonet, tiparet, traditat etj. Po në aspektin urban dhe formal kush është geni Tetovë? Janë disa elemente që të gjitha bashkë krijojnë genin Tetovë. Njëri element, ndër më të rëndësishmit është rrjeta gjenerative, e cila ndodhet kudo në qytet. Është e çuditshme sesi kjo rrjetë, megjithëse e fshehur, përputhet plotësisht në shumë pjesë të qytetit. Elementi tjetër është pëlhura urbane (pattern), që në këtë rast është ndarë në tre komponentë. Në pattern ekzistues, në vektor dhe në forca. Vektor janë vijat që ndajnë një pëlhurë urbane nga një tjetër, kurse forca janë vijat, të cilave pëlhurat urbane u referohen. Sigurisht elementet natyror kanë ndikim të drejtpërdrejtë në genin Tetovë. Janë pikërisht këto shtresëzime historike, formale dhe territoriale që duke u mbivendosur kanë më shumë gjasa të çojnë në një jetë urbane më nxitëse dhe në një qytet idealisht më gjithëpërfshirës.

Duke vazhduar logjikën e përkatësisë, e asaj që Tetovës i përket, zhvillimi i mëtejshëm i qytetit është i destinuar të jetë aty ku lindi, rrëzë malit e gjithmonë pranë natyrës. Kështu energjia e zhvillimit që është e pandalshme, do të kanalizohet për konsolidimin jo vetëm të pjesëve me potencial të qytetit, por edhe të qendrave të banuara rurale që shtrihen po rrëzë malit, ashtu si Tetova. Metropoli i ardhshëm do të jetë qyteti linear gjenerativ, ku çdo pjesë e tij do të ketë rrjetën e përkatësisë ku herë do ruajë karakteristikat e saj e herë do të ndërthuret me rrjetat e vendbanimeve pranë saj, duke mundësuar lindjen e pjesëve urbane pasardhëse, ku pjesët e genit të tyre do të jenë të dyja vendbanimet që mundësojnë lindjen e kësaj pjese të re. Kjo do të jetë e ardhmja, metropoli Tetovë.

## Nga frakturat territoriale te zbulimi i rjetës

Zbulimi i faktorëve ekzistencialë të Tetovës ishte një nga fokuset kryesore në këtë studim. Këta faktorë ishin forma aktuale e urbanizuar e Tetovës, frakturat territoriale, sistemet hidrike, itineraret historike, si dhe ndërhyrjet infrastrukturore.

Forma e Tetovës është e zgjatur sepse qyteti është i shtrirë përgjatë malit të Sharrit. Evidentojmë qendrën e qytetit, e cila është në pikën e përplasjes midis malit të Sharrit dhe lumit Pena.

Shumë i rëndësishëm është evidenti i frakturave territoriale, ku qartë dallojmë që Tetova, ashtu si dhe territori i saj, formohen nga lugina e lumit Pena në malin e Sharrit, e cila kur arrin në luginën e Pollogut shpërhapet në formë rrezore.

Frakturat territoriale janë të lidhura ngushtë, gati përrputhen me sistemin hidrik që përbëhet nga lumi Pena dhe rrjedhje ujore të tjera, që si burim kanë malin e Sharrit e me pas shpërndahen në fushë në formë rrezore.

Duke parë që këto fraktura territoriale ashtu si dhe sistemi hidrik, lidhin fshatrat përreth, analiza më pas është ajo e rrugëve historike dhe e lidhjeve që kanë ekzistuar kohë më parë midis qendrave të banuara në zonën përreth. Shumë interesant është konstatimi që itineraret historike që lidhnin këto qendra, gati përrputhen me frakturat territoriale, që mesa duket janë një faktor kyç në qytetformimin e Tetovës.




Frakturat territoriale



Frakturat bujqesore

Itinerare historike






Pasi vërejmë që këto trama territoriale nuk kanë ndikim vetëm në formën urbane të Tetovës, por ndikimi i tyre vazhdon edhe më tej në fushat e bujqësisë, mënyra sesi janë të punuara ato, leximi i drejtimeve të tyre përsëri vërteton rolin e madh të formimit të tyre dhe ndikimit nga frakturat territoriale, që në këtë rast e parashikonim pasi tokat e punuara orientohen vetë nga përdoruesit në mënyrë të tillë, që të ketë lehtësira në sistemin e ujitjes.

### Shumatorja e rrjetit

Duke vendosur të gjitha këto shtresa leximi bashkë kuptojmë më mirë pse Tetova është aty dhe pse është e organizuar në këtë mënyrë. Duke intensifikuar fashat më të forta të qytetformimit dhe duke e thjeshtuar ilustrimin vërejmë një lloj radialiteti që si fokus ka përplasjen e lumit Pena me fushën, pra me vetë qytetin.

Kjo skemë është në një shkallë territoriale, por përsëritet në mënyrë shumë të ngjashme dhe në vetë shkallën e qytetit, në organizimin e rrugëve dhe korridoreve urbane.

Pra zbulojmë një rrjetë të fshehur që dirigjon këtë sistem të përbërë nga rrjedha ujore, itinerare, parcela etj.



Ljubičev Polje

Fraktura teritoriale

Hekuruudhna

Hinnerore nistorike

Fraktura teritoriale



Fraktura agrikulturore


Formod urboarne

Luginna e Pollogut

Sistemi rruqor

Itinerare historike

Prijedna ujore




## Qyteti si vezë




antikitët



shek. XVII-XIX



drejt policentrizmit



qyteti kontemporan


## Tetova si vezë



antikitët



shek. XVII-XIX



drejt policentrizmit



qyteti kontemporan

## Qyteti si vezë

Në një studim formal dhe tepër përgjithësues për çdo qytetformim, mund të nxjerrim këto konkluzione lidhur me formën:

Që në kohët më të hershme, qyteti kishte bërthamën e vet dhe rrethohej me mure të fortifikuara. Më vonë rreth shek. XVII-XIX bërthama rritej dhe këto mure nuk ekzistojn më pasi pengonin zhvillimin e mëtejshëm.

Në kohët e sotme qyteti kontemporan mendohet si një qytet shumëpolësh me funksione të shpërndara në të gjithë territorin e tij, jo vetëm në qendër. Kalimi nga qyteti bërthamë në atë shumëpolësh bëhet me anë të një rrjete të rregullt, e cila bërthamën e ndan dhe e copëton në qeliza që shpërndahen në gjithë qytetin. Kjo mund të thuhet për një qytet të përgjithshëm.


Po në rastin e Tetovës ?

Tetova si formë qyteti është elips i zgjatur, që ndjek linjën e bashkimit të malit të Sharrit me fushën e Pollogut, ku bërthama e qytetit është tek pikëtakimi i kësaj linje me lumin Pena, kjo na bën të besojmë që edhe ndërtimet e para në këtë trevë kanë qenë pikërisht aty. Sot kemi të njëjtën strukturë, por sigurisht, më të madhe.

Zona 1

Çështja është sesi Tetova do të kalojë në një zhvillim policentrik? Në rastin e përgjithshëm të një qyteti kur bërthama ishte në qendër dhe qyteti zhvillohej rreth saj, përdornim një rrjetë të rregullt. Në këtë rast bërthama vendoset si fokus, zhvillimi i qytetit shpërhapet drejt fushës në mënyrë rrezore.


Pra në këtë rast, rrjeta që mund të përdorim, nuk është më një rrjetë e rregullt, por është e shformuar, në qendër të qytetit është e mbyllur drejt qendrës dhe sa më shumë shtrihesh drejt fushës, aq më shumë hapen rrezet. Kjo është edhe rrjeta gjenerative e zhvillimit të qytetit, metoda sesi mund të kthejmë




Zona 1




Zona 2



Zona 3



Zona 2



përputhen në këtë shkallë më të vogël. Pra, kjo rrjetë që si fillim na shërbeu për të kuptuar procesformimet që kishin ndodhur, tani vërteton që është kodi gjenetik i zhvillimit të qytetit, ku me anë të kësaj rrjete gjenerative mund të lexojmë qytetin në çdo shkallë.

Nuk duhet neglizhuar fakti se Tetova përveç rrjetit gjenerativ strukturues në shkallë territoriale dhe qyteti ka edhe disa motive specifike që lindin brenda rrjetit gjenerativ dhe në disa raste i nënshtrohet drejtimit gjenerues, në disa jo. Kjo krijon specificitetin e motiveve.

Zona 3

Tetovën në një qytet policentrik. Analiza në shkallë të vogël ishte e domosdoshme në këtë pikë për të parë nëse kjo rrjetë funksionon në këtë shkallë. Për këtë qëllim, zgjidhen 3 zona të rastësishme të qytetit, në pjesë të ndryshme të tij. Duke analizuar pëlhurat urbane të këtyre pjesëve dhe duke deduktuar se kujt i referohet ky patern, nxjerr një konkluzion shumë interesant. Rrugët, itineraret, hapësirat, pozicioni i ndërtesave, vijat bujqësore etj, të gjitha pa përjashtim i referohen fokusit të rrjetës gjenerative. Të gjitha kanë një orientim të qartë drejt bërthamës së qytetit. Ky fakt lidhet shumë ngushtë edhe me analizat në shkallë territoriale që

## Nga rrjeta gjenerative tek Tetova potenciale

Rrjeta gjenerative përbëhet nga qeliza parametrike, dhe në varësi të vijave horizontale dhe vertikale që përbëjnë këtë matricë, varet madhësia e qelizës. Sa më e vogël të jetë qeliza aq më shumë mund ta analizojmë në detaj. Qeliza përmban shumë faktorë, në varësi të sipërfaqes që mbulojnë, si dhe cilësive të asaj zone.


Kjo mënyrë na lejon që në analizat tona të krijojmë diagrama tematike duke kërkuar një ose disa faktorë të caktuar. Në këtë mënyrë qyteti trajtohet si një organizëm që ka lidhje të pafundme, por që këto lidhje janë të ndryshme.

Kështu mund të agregojmë dhe të disagregojmë si një mozaik zonat urbane në varësi të faktorëve që duam të analizojmë, pra qytetin e shohim pa paragjykim, duke e analizuar në bazë të cilësive që ka një zonë.


Qelizat mund të zmadhohen dhe të zvogëlohen pafund, mjafton që fokusin ta kenë të mirëpërcaktuar. Për analiza në shkallë qyteti na shërbejnë qeliza relativisht të mëdha dhe në shkallë më të vogël qeliza më të vogla.

Sipas kësaj metode duke futur në këtë rrjetë gjenerative faktorë të ndryshëm studimi në formë inputesh, ajo do të gjeneronte diagramat e faktorëve më potencialë, si p.sh. prania e ujit, zonat e urbanizuara, periudhat e zhvillimit të qytetit, zonat ekonomike, korridoret historike, disktriktet, funksionet etj. Kështu me rradhë mund të gjenerojmë diagrama, duke futur faktorët që dëshirojmë të analizojmë dhe që na ndihmojnë në procesin e të kuptuarit. Çdo qelizë e kësaj matrice, si në shkallë të madhe, si në shkallë të vogël, si dhe në diagramat e gjeneruara nga këta faktorë, duhet të përmbajë Genin Tetovë.

### Qeliza parametrike




x qeliza




x\*4 qeliza


### Agregim - Disagregim




### Diagramë faktoriale




Faktor : Qyteti i Tetovës




Faktor : Itinerare historike




x\*16 qeliza




Faktor : Zona më potencial




Faktor : Lumi




Faktor: Periudhat e zhvillimit



Faktor : Zona ekonomike dhe potenciale



Faktor: Distrikte



Faktor : Funksione

## Geni Tetovë

Çdo qelizë e rrjetës gjenerative përmban Genin Tetovë që është esenca e Tetovës dhe e përmban çdo pjesë e qytetit. Duke parë larmishmërinë e pëlhurave urbane në qytet, duket sikur kemi qytete brenda qytetit të Tetovës. Pra, asnjë pjesë e qytetit nuk është e njëjtë, por të gjitha duhet të përmbajnë esencën Tetovë, pra genin Tetovë.

Janë disa elemente që të gjithë bashkë krijojnë genin Tetovë. Njëri element, ndër më të rëndësishmit, është rrjeta gjenerative, e cila ndodhet kudo në qytet. Është e çuditshme sesi kjo rrjetë megjithëse e fshehur përputhet plotësisht në shumë pjesë të qytetit.


Elementi tjetër është pëlhura urbane (pattern) që në këtë rast është ndarë në tre komponentë. Në patternin ekzistues, pra në pëlhurën urbane të një zone e cila përbëhet nga itinerare, korridore, ndërtime etj.; vektorët që janë vija, të cilat formohen nga ndërprerja e paternave me karakteristika të ndryshme. Pra në momentin kur një pattern që ka tipare personalizuese përplasat me një tjetër, vija e përplasjes së tyre është vektor dhe elementi i fundit, por jo nga rëndësia, janë forcat që nuk janë gjë tjetër veçse vija që dirigjojnë drejtimin e një ose disa pattern-ave.


Të gjitha këto elemente, ku secili ka një rëndësi të ndryshme sipas pjesëve në studim, përmbajnë atë çfarë është Tetova, përmbajnë Genin Tetovë.

Janë pikërisht këto shtresëzime historike, formale dhe territoriale, që duke u mbivendosur kanë më shumë gjasa të çojnë në një jetë urbane më nxitëse dhe në një qytet idealisht më gjithpërfshirës. Mbivendosja e tyre krijon Hapësirën Gjenerative.

Pattern i qytetit

Geni = Pattern +






Patterne të ndryshëm brenda pattern-it të qytetit

"Qytetet" brenda qytetit

# Vektor + Forca + Rrjeta gjenerative



Vektor

Forca



Rrjeta gjenerative

Geni Tetovë = Pattern + Vektor + Forca + Rrjeta gjenerative

## Hapësira gjenerative

Hapësirat e krijuara nga mbivendosja e shtresëzimeve historike të genit Tetovë dhe përbërësve të tij, siç janë rrjeta gjenerative, pëlhura urbane ekzistuese, vektorët dhe forcat së bashku krijojnë Hapësirën Gjenerative.

Për të analizuar më qartë në mënyrë më praktike këtë metodë të shpjeguar më lart, janë zgjedhur




tri zona me karakteristika të ndryshme për të shpjeguar aplikimin e metodës në situata jo të njëjta. Zona e parë nuk ka zhvillime urbane, por priten të ndodhin, zona e dytë është disi e zhvilluar në aspektin urban, por ka nevojë për konsolidim dhe zona e tretë është e konsoliduar. Metodologjia është e njëjtë në të tria zonat, aplikimi praktik ndryshon.

Për sa i përket zonës së parë, kjo pjesë e qytetit ndodhet në vazhdimësinë e dy stadiumeve të qytetit pa ndonjë funksion të qartë urban. Sigurisht që është një pjesë potenciale për t'u zhvilluar në të ardhmen e afërme me idenë e një zone çlodhës ku do të mbizotërojnë hapësirat e gjelbra dhe terrenet sportive.

Pasi evidentojmë rrjetën gjenerative, pëlhurat urbane ekzistuese, vektorët, forcat si dhe frakturat territoriale që janë të shumta, zgjatojmë linjat e tyre në zonën në studim, duke paramenduar se çfarë do të kishte ndodhur në këtë pjesë të qytetit sikur kjo të ishte zhvilluar ose çfarë mund të ndodhte sikur të ishte lënë në proceset e pandalshme të zhvillimit. Kështu, nga mbivendosja e të gjithë këtyre faktorëve krijohet një pëlhurë urbane gjenerative e ndryshme nga pëlhura urbane, pasi kjo pëlhurë e re nuk përcakton rrugë, vija ndërtimesh apo karakteristika të tjera fizike, por përcakton itinerare, korridore, hapësira gjenerative.





Kjo pëlhurë gjenerative brenda saj krijon hapësira të ndryshme, por pjesa kryesore e saj është hapësira gjenerative, që është një hapësirë ku ndodhin shkëmbimet më të mëdha të energjive në zonë. Hapësira të tjera janë hapësira komplementare që plotësojnë zonat përreth, hapësirat e përcaktuara që kanë një funksion, hapësirat e shërbimeve, si dhe hapësirat dhomë.



Çdo vijë e kësaj pëlhure urbane gjenerative që praktikisht kthehet në një fashë funksionesh, është rezultat i njërit element të genit Tetovë. Kështu, duke vendosur një hierarki disa fasha janë më të rëndësishme se të tjerat. Kështu, fasha e gjeneruar nga frakturat territoriale ka trashësinë më të madhe dhe rëndësinë më të madhe. E kështu me radhë vijën rrjeta gjenerative pasi është gjithëpërfshirëse në qytet, vektorët dhe forcat kanë një ndikim të njëjtë, dhe në fund, kemi pattern-in ekzistues.



Kështu kemi krijuar një zonë të re, ku hapësira gjenerative është pjesë e genit Tetovë, pasi ka dalë si konkluzion nga studimi i elementeve që e përbëjnë atë. Për t'u theksuar është që vijat e kësaj pëlhure urbane gjenerative nuk janë detyrimisht elemente fizike, si rrugë, ndërtesa, parcela etj por ato mund të jenë energji njerëzish, radhë pemësh, sisteme sportive të mbyllura, itinerare biçikletash, tabela reklamash, tarraca të gjelbra etj.

Për sa i përket zonës së parë, kjo pjesë e qytetit ndodhet në vazhdimësinë e dy stadimeve të qytetit pa ndonjë funksion të qartë urban. Sigurisht, që është një pjesë potenciale për t'u zhvilluar në të ardhmen e afërme me idenë e një zone rekreative ku do të mbi-zotërojnë hapësirat e gjelbra dhe terrenet sportive. Për sa i përket aplikimit praktik në këtë zonë, nuk ka zhvillim



Zona 2









urban, kështu që kjo kërkon një intuitë të madhe për të kuptuar sesi zona “duhej” zhvilluar. Kështu, mbivendosja e faktorëve të genit Tetovë duhet seleksionuar, ku diku mban vijat nga rrjeta gjenerative, diku vazhdojnë frakturat territoriale e kështu me radhë, duke i kombinuar me një llogjikë urbane për zonën. Ky është një rast ku duhet të injektohet geni i Tetovës në një zonë të pazhvilluar.

Për sa i përket zonës së dytë, kjo pjesë e qytetit është një zonë mjaft vitale për qytetin e Tetovës. Në këtë pjesë është stacioni i trenit, terminali i autobusave dhe mund të kthehet në një zonë të gjallë, ku mund të organizohen koncerte të hapura, parqe të vazhdueshme etj. Për sa i përket aplikimit praktik të metodës, në këtë pjesë ndryshe nga rasti i parë është një pjesë e konsoliduar dhe një pjesë tjetër që shkon drejt konsolidimit. Pra, edhe në këtë rast diku ndjekim vijat e hapësirës gjenerative, vektorëve dhe forcave duke i ndërthurur me pëlhurën urbane ekzistuese. Ky është një rast që përmban genin e Tetovës, por duhet të forcohet dhe rigjenerohet.

Për sa i përket zonës së tretë, kjo pjesë e qytetit është tashmë e konsoliduar ku përdoret kryesisht për banim me një popullsi relativisht të madhe. Për sa i përket aplikimit praktik të metodës, në këtë pjesë kemi të bëjmë me injektim të genit të Tetovës në një zonë të konsoliduar. Vështirësia në këtë rast qëndron sesi do të arrihet kjo në një zonë ku nuk ka aspak hapësirë të lirë. Në këtë rast injektimi i genit Tetovë bëhet me anë të linjave që i mbivendosen zhvillimit urban. Këto linja kthehen në tarraca të gjelbëruara, në sisteme reklamimesh dhe në energji njerëzish në pamundësi për të ndikuar në krijim hapësirash përveç hapësirës gjenerative.





Generative space

Green roofs



Advertise

People energy


## Qyteti linear gjenerativ


Tetova është e destinuar të jetë aty ku lindi, pranë natyrës, rrzë malit të Sharrit me burimet e pafundme ujore. Por, këtë karakteristikë nuk e ka vetëm Tetova, por të gjitha vendbanimet që shtrihen rrzë malit. Të gjitha pa përjashtim kanë lindur në një të çarë të malit të Sharrit, që është lugina e lumit përkatës, i cili hapet në fushë në mënyrë rrezore dhe ndan qytetin përmes.

Kështu, duke shkuar pak larg, më lart është një metodë për konsolidimin e Tetovës dhe jo rritjen e saj drejt fushës. Por sigurisht që rritjen nuk mund t'a ndalë askush. Kështu mendohet, që e njëjta metodë që është shpjeguar më lart mund të aplikohet në të gjitha zonat rurale rrzë malit të Sharrit, që kanë të njëjtat karakteristika me Tetovën.

Energjia e zhvillimi që është e pandalshme do të kanalizohet për konsolidimin jo vetëm e pjesëve me potencial të qytetit, por edhe të qendrave të banuara rurale që shtrihen po rrzë malit ashtu si Tetova.

Metropoli i ardhshëm do të jetë qyteti linear gjenerativ ku çdo pjesë e tij do të ketë rrjetën gjenerative përkatëse, ku herë do ruajë karakteristikat e saj e herë do të ndërthuret me rrjetat e vendbanimeve pranë saj, duke mundësuar lindjen e pjesëve urbane pasardhëse ku pjesë e genit të tyre do të jenë të dyja vendbanimet që mundësuan lindjen e kësaj pjese të re. Kështu do të kemi lindjen e një geni të ri ku të gjitha këto vendbanime do të kenë Genin e Metropolit Tetovë.





Qyteti linëor gjenerativ  
Generative linear city










# TETOVO

## THE EXTRACT OF SPACE\_ TETOVO SKELETON CITY EKSTRAKTI I HARĚSIRĚS\_ Tetova Skeleton City

OLESJA LAMI




5

# Ekstrakti i Hapësirës

Olesja Lami

Tetova, një qytet tepër i larmishëm si në njerëzit që e "jetësojnë", ashtu edhe në tipologjitë ndërtimore që e formojnë. **"Ekstrakti i Hapësirës\_Tetova Skeleton City"** tenton të vërë përballë pjesë të ndryshme të qytetit dhe sesi ato mund të **komplementojnë** njëra-tjetrën, me **funksionet që strukturojnë hapësirën**, duke tërhequr gjithnjë e më shumë grupe shoqërore në hapësirat publike.



## Ekstrakti i hapësirës / Tetova skeleton city

Olesja Lami

### Hyrje

*“Real differences are differences of essences or attributes of a single substance” (Ndryshimet e vërteta janë ndryshime në esencë, apo attribute të një substance të vetme), cituar nga filozofia e Deleuze.*

Filozofia e Deleuze është përkthyer si raporti midis Fashës Skelet (një term që e cilëson hapësirën si element strukturues të qytetit) dhe Esencës së Hapësirës (vlerave reale që zotërojnë qendrat urbane). “Ekstrakti i Hapësirës” është ruajtja e funksionit parësor, amplifikimi i tij dhe shkrirja e pjesëve të tij me funksionet që vijnë nga “bërthamat, qendrat” e tjera.

Në këtë vizion mbi zhvillimin ekonomik, social, kulturor dhe ambientar të qytetit të Tetovës dhe të rrethinave të tij, jepet një zgjidhje alternative, e cila në qendër të saj ka funksionin që mbart një “bërthamë\_qendër” jashtëqytetase apo brendaqytetase. Vizioni nis nga një shkallë territoriale, ku përfshihet hapësira brenda trekëndëshit Gostivar-Tetovë-Shkup dhe shkallë shkallë futet brenda qytetit, duke arritur deri në trajtimin e një hapësire publike apo objekti publik. Projekti “Ekstrakti i Hapësirës\_Tetova Skeleton City” mundohet të përcjellë alternativa zhvillimi pa vendosjen e barrierave fizike ose mendore. Një vizion ku qyteti është i lirë të modulojë ose ristrukturojë formën e tij në përputhje me përhapjen e funksioneve nga qendrat drejt periferive. Një nxitje për zhvillim në përputhje me kërkesat e komunitetit është krijimi i hapësirave publike, të cilat ofrojnë komoditetin e hapësirave private, dizenjimi i hapësirës urbane në varësi të funksionit mbizotërues në zonë, për të krijuar diversitete (shkëmbime sociale, kulturore dhe ekonomike).

Tetova, një qytet i cili që në vizitën e parë më la një shije shumë ftuese, është një qytet që mirëpret edhe në ftohtësinë e dimrit, ku njerëzit që e jetësojnë krijojnë larmishmëri në kulturë dhe në përjetimin e hapësirave publike. Ajo që më bëri përshtypje ishte gjallëria që gjeje nëpër rrugicat e pazareve të fshehura pas fasadave të qytetit, qetësia e lagjeve periferike, apo pontecialit mbledhës të grupeve shoqërore që kishin qendrat historike. Megjithatë ndihej që të gjitha këto fragmente të qytetit mbeteshin si të humbura dhe i gjeje papritur në momentin kur



përballeshe me to. Në këtë aspekt shtrihet vizioni i paraqitur në këtë projekt “Ekstrakti i Hapësirës\_Tetova Skeleton City”, ku elementet formuese të tij bëhen më të dukshme dhe amplifikojnë potencialin që ato zotërojnë. Ky zhvillim shihet në relacion me shpirtin e komunitetit, me plotësimin e komoditeteve, që një hapësirë publike mund t’i ofrojë banorëve të qytetit.

Elementet kyçe të këtij projekti janë: 1. Fashat (“hapësira strukturë” mbajtëse të qytetit ose hapësira “Skelet”, term i përdorur për të krahasuar këto hapësira me skeletin njerëzor, strukturën mbajtëse të trupit të njeriut); 2. Bërthamat\_Qendra (pikat më potenciale brenda apo jashtë qytetit që mbartin “thelbin, identitetin” e qytetit); 3. Funkzioni, karakteristika e bërthamave, magneti për grupet shoqërore. Thelbi qëndron në evidentimin e qendrave më potenciale brenda fashave, ruajtja e funksionit që ato zotërojnë dhe amplifikimi apo përforcimi i këtij funksioni, duke e parë në relacion me qendrat e tjera. Nëse rezultati është lidhja e disa qendrave, të cilat plotësojnë nga ana funksionale njëra-tjetrën, atëherë do të kemi krijimin e një fashe në miniaturë, e cila do bëjë të dukshëm në qytet funksionin e saj parësor, duke sjellë zhvillim ekonomik, kulturor apo social brenda qytetit.

Dy janë referencat e drejtpërdrejta të marra nga qyteti: Tetova e mbuluar nga një shtresë e magjishme bore dhe moria e oborreve private të rrethuara me muret e larta apo gardhet e gjelbëruara. Në këtë tentativë hapësira publike mundohet të silllet si hapësira private, të ofrojë siguri, komoditet dhe fluiditet në lëvizje, duke u bërë një vend mbledhës e tërheqës për komunitetin. Hapësira do jetë një element më shumë që do të amplifikojë funksionin e përmbajtur nga qendra.

Duke e studiuar qytetin si në fragment, ashtu edhe në tërësinë që këto pjesëza krijojnë, formohet një “skelet-hipotezë” zhvillimi, i cili strukturon dhe bëhet burim i jetës së qytetit. Qyteti shihet si një organizëm i mirëfilltë, me disa shtylla kurrizore që mbajnë esencën e tij dhe ndihmojnë në vënien në lëvizje të çdo organi tjetër periferik të qytetit. Vizioni për një Tetovë të rikrijuar nga Esenca e Hapësirës është nxjerrja në pah e elementeve të saj bazike.

## “Refrenet Territoriale” & Skeleti Linear

### Analiza

Gjatë analizave të njëpasnjëshme, në fazën fillestare të projektit, tri më të rëndësishmet dhe që më pas ndikuan edhe në hipotezat për zhvillimin e Tetovës në shkallë territoriale dhe urbane, ishin: Refrenet Territoriale \_evidentim i elementeve natyrore; Klasifikime \_evidentim i elementeve “artificiale”; dhe Qyteti Linear \_forma e lindjes dhe krijimit të qyteteve dhe fshatrave përgjatë fushës së Pollogut.

Marëdhënia e ndërsjellë, që krijohet midis tyre, formonte gjithë tipologjinë karakteristike të zonës. Në vend të parë cilësova “elementet natyrore”, ato elemente historike që kanë formuar pllajën e Pollogut. Elementet e cilësuara natyrore janë: prezencat ujore, malet dhe fushat. Në pozicion të dytë qëndronin “elementet strukturues artificial”, të krijuara nga njeriu. Përmendim: korridoret (lidhjet automobilistike dhe hekurudhore); distriktet (zonat periferike me një profil të caktuar si zona industriale, studentore apo ekonomike) dhe qendrat (ku përfshihen zonat e banuara, qeveritare dhe turistike). Kjo shtresë i është veshur “refreneve territoriale” dhe së bashku kanë krijuar tipologjinë e formimit të qendrave të banuara të pllajës.

Gjatë vëzhgimit të detajuar të aksit JP-VL, Gostivar-Tetovë e më tej, ku përkrah tendencës së bashkimit dhe krijimit në të ardhmen të një qyteti linear, dallohet zanafilla e lindjes dhe zhvillimit të fshatrave dhe dy qyteteve kryesore. Në këto bashkësi banimi, të cilat kanë lindur në formë radiale (me një qendër dhe me rritje në formë rrezore) dhe lineare (pozicionim përgjatë akseve rrugore), dallohen të përsëriten tri elemente kryesore strukturuese: prezencat e lumenjve apo rrjedhave ujore, pozicionimi buzë shpatave malore; dhe tendenca e hapjes së urbanizimit drejt fushës.

Projekti është i strukturuar në pesë etapa.

1. Fasha rajonale
2. Fasha urbane
3. Trajtimi i zonave
4. Hapësira e jetuar
5. Fasha si vëllim





## Fasha rajonale

Kjo është hipoteza e parë e zhvillimit të hapësirës freqytetëshe, Gostivar-Tetovë-Shkup.

Për ngritjen e kësaj hipoteze është ruajtur si referencë forma e lindjes dhe zhvillimit të fshatrave dhe qyteteve të luginës së Pollogut. Kështu, zona është ndarë në fasha paralele, "Fashat Rajonale", me lëvizjen e rritjes VP-JL, duke sjellë në mënyrë të tillë këto avantazhe:

- Studimi shtrihet në të dy krahët e luginës, duke realizuar një lidhje të drejtpërdrejtë midis rezervave natyrore malore.
- Rrugët dhe lumi i Vardarit nuk do shihen si barriera, por si pjesë gjeneruese të fashave.
- Fashat do gjenerohen nga tipologjitë territoriale dhe do amplifikojnë funksionin e tyre dominues, duke u profilizuar në mënyrë të tillë me një drejtim të caktuar zhvillimi ekonomik.

Fashat Rajonale, të nxjerra nga drejtimi i lëvizjes së rritjes së zonave të banuara, janë trajtuar disa herë duke u përpunuar nga një vizion konceptual zhvillimi, në një vizion më konkret, ku propozimet i vishen kontekstit aktual. Pas Fashës Rajonale kalohet në një shkallë më të detajuar, në atë të Fashës Funktionale (e cila është një lloj Fashe Rajonale, por tashmë e veshur me funksionin mbizotërues).

Funksionet kryesore të paraqitura janë: zona rezidenciale, zona turistike, bujqësia, zona e mbrojtur, zona rekreative, zona universitare, zona ekonomike. Fashat funksionale pasi althernohen me njëra-tjetrën, krijojnë në terren një "motiv" zhvillimi për gjithë pllajën e Pollogut. Në një shkallë më afër, dallohet sesi këto fasha në vetvete kanë alternim të mëtejshëm të një pjese të funksioneve të përmendura më sipër, por gjithmonë me mbizotërim të funksionit parësor që i jep identitetin fashës. Etapa e fundit në shkallë rajonale përfundon në propozimin e Fashës Organike, e cila është ndjekja strikte e linjave territoriale.

Në këtë vizion esenca e hapësirës është "motivi" i zhvillimit, apo funksionet e alternuara brenda fashës, ndërsa "Skeleti" janë fashat në tërësinë e tyre.

OLESJA LAMI



# TOWARD MERGING PEOPLE AND BRINGING DIVERSITIES

Drejt bashkimit social dhe sjelljes së ndryshimit

# TETOVO




RECREATION  
CULTURE/ LEISURE  
INDUSTRY  
ECONOMY



RELIGION  
PUBLIC SPACE



SPORT AREA




## Fasha urbane


Pas vizionit në shkallë rajonale studimi ulet në shkallë urbane. Duke ruajtur të njëjtën logjikë si Fasha Rajonale, edhe Fasha Urbane bën lidhjen e dy rezervave natyrore, malin me fushën. Vizioni në shkallë qyteti, flet mbi përzgjedhjen e pesë fashave strukturoese për Tetovën, në raport me funksionin më të rëndësishëm që ato përfaqsojnë: a. Fasha Universitare; b. Fasha "Tetex"; c. Fasha Lumore; d. Fasha "Qendrore"; e. Fasha Sportive.

Për analizimin e fashave është propozuar një tjetër metodologji studimi, e cila fragmentizon fashat strukturoese. Fillimisht përcaktohen "bërthamat", qendrat më potenciale brenda fashës dhe më pas "zonat", hapësirat e ndikimit të bërthamës. Bashkësia e këtyre zonave formon "skeletin". Kështu forma e skeletit është e lidhur drejtpërdrejt me pozicionimin e "bërthamave" dhe forcën e ndikimit të secilës.

Çfarë janë bërthamat?

Bërthamat mund të jenë sheshe, kryqëzime rrugësh apo ndërtesa të përzgjedhura kundrejt potencialit, që ato mbartin për zhvillim ekonomik, kulturor apo social në të ardhmen.






Ndërsa zonat e mbulimit të tyre, apo kufijtë e mbulimit do të përcaktohen herë nga linjat territoriale natyrore apo artificiale (të shtuara nga njerëzit) dhe herë nga hapësirat private. Siç e përmendëm edhe më sipër, tërësia e këtyre zonave do të formojë "Skeletin" e Fashës.

Pra rezultati në fund është një fashë e fragmentizuar teorikisht dhe alternative, me zona që ndryshojnë në varësi të pozicionimit të bërthamave të tyre duke krijuar një Qytet "Skelet" \_ Alternativ në formën e strukturës, zhvillimit dhe krijimit të diversiteteve.

Si ndikon kjo formë studimi?



- Hapësira vlerësohet e barabartë në pjesë të ndryshme të qytetit.
- Qendrat\_ "Bërthamat" kthehen në pika potenciale për zhvillimin kulturor, ekonomik dhe social.
- Zonat komplementojnë njëra-tjetrën, duke e shtrirë funksionin e tyre nëpër qytet.
- Shihet përtej fasadës, duke ndërhyrë paralelisht në zonat më të frekuentuara të qytetit dhe ato më pak të frekuentuara.




### Trajtimi i zonave

Në këtë etapë vizioni jepet për një fragment brenda fashës, në mënyrë që të kuptohet sesi mund të zhvillohet ajo në vetvete. Nëpërmjet kësaj metode propozohet rivlerësimi i qendrave aktuale, amplifikimi i funksioneve të tyre dhe shihet mundësia nëse ato kanë nevojë për të plotësuar njëra-tjetrën. Në këtë mënyrë do të kemi një rritje të zhvillimit ekonomik, kulturor apo social, kudo nëpër qytet .

Në hartën e parë, një “zoom in” në fashën e përzgjedhur, tregohen qendrat dhe zonat e mbulimit të tyre, me funksionet aktuale që ndodhen në to, ndërsa me shigjeta janë treguar flukset e lëvizjes së njerëzve. Me shkrim të zi janë treguar funksionet që përmban realisht çdo zonë, ndërsa me rozë janë treguar funksionet që i shtohen zonës, duke e kthyer atë në një paralele të zonave të tjera.






Si lidhen zonat midis tyre?

Përzgjedhja e funksionit të shtuar bëhet në raport me funksionin mbizotërues në zonë dhe funksionin shtesë që do të përmbushë kërkesat e komunitetit.

Mënyra se si këto funksione do të shtrihen nga një zonë në tjetrën, do të jetë duke ndjekur flukset e lëvizjes. Në këtë mënyrë kemi një shtrirje të funksionit edhe në hapësira, ku më parë nuk ka pasur identitet, apo shkaktimin e përplasjeve funksionale të ndryshme, duke rikrijuar në këto momente miniqendra të reja të tipologjive ekonomike apo social-kulturore.

Me këtë metodologji studimi mund të trajtohen të gjitha bashkësitë zonale të fashës dhe duke dalë më tej deri në raportet e fashave me njëra-tjetrën.







# LET'S BUILD UP THE SPIRIT OF COMMUNITY

Të ndertojmë shpirtin e komunitetit

OLESJA  
LAM I




## Hapësira e jetuar

Tetova është një qytet me shumë gjendje, në dimër bora bëhet element dizenjues që bashkon hapësirën, duke zhdukur kufijtë fizikë të dyshemesë urbane. Hapësira është ambienti lidhës i funksioneve, që emetojnë “bërthamat” dhe propozimi bëhet lidhur me këtë fakt, përcaktimi i formës në varësi të funksionit.

Ky model studimi fillon me analizën mbi hapësirën, të cilën e ndajmë në private e publike dhe vlerësohet rasti nëse hapësira private do të ruhet, apo do të bashkohet me publike.

Etapa e dytë është trajtimi i hapësirës në varësi të funksionit mbizotërues në zonë, duke amplifikuar vetë funksionin. Kjo është emërtuar si “Hapësira pa Barriera”, e cila fton banorët në një ambient publik, ku risillet siguria dhe komoditeti i hapësirës private.

Kështu, hapësira merr disa emra në varësi të trajtimit të saj: “Hapësira si ndërtesë”, ku hapësira mund të kthehet në një objekt funksional, “Hapësira Fasadë, ku ndërhyrjet mund të jenë sipërfaqësore”, “Hapësira e shtuar, shtimi i një ndërtimi kundrejt atyre ekzistuese”, “Hapësira e mbyllur, ku hapësira ka vazhdimësi duke u bërë mobilje urbane, dysheme urbane apo mbulesë urbane.”






## Fasha si vëllim

Duke vazhduar zbritjen e shkallëve, tanimë në dizejimin e një objekti apo sheshi me metodologjinë e fashës si përzierje funksionesh, vjen propozimi i Fashës si Vëllim. Përkthimi i drejtpërdrejtë i vizioneve në shkallë rajonale dhe urbane, në një objekt në shkallë njerëzore sjell një perceptim më të prekshëm të konceptit të fashës, funksionit dhe hapësirës. I përzgjedhur për të pasqyruar këtë vizion është një objekt kulti, funksioni i të cilit mund të shihet i ndikuar nga pozicioni që ka në qytet, domethënë në raport me qendrat e tjera.

Në këtë shembull objekti i kultit rrethohet nga objekte ekonomike, kulturore dhe ambiente sociale publike. Duke e parë në raport me to, funksioni i objektit mundet të ndikohet nga influencat e jashtme, ku hapësira e kultit në ditët e zakonshme mund të jetë një vend turistik, një ambient koncertesh, një hapësirë tërheqëse për grupe të ndryshme sociale dhe në ditë të veçanta atij i vishen funksione të mirëfillta fetare. Por bashkimi me këto funksione të tjera nuk i ul rëndësinë funksionale që ajo vetë zotëron, pra në këtë rast sado qofshin funksionet rrethuese që ndikojnë në "Fashën si Vëllim", funksioni parësor që ajo do të ruaj është qëllimi primar i objektit. Më thjeshtë mund të thuhet që çdo ndërhyrje do të respektojë kushtet e vendosura nga vetë objekti, në respektimin e funksionit të tij.




## Përmbledhje

Gjithçka që u tha më sipër është vizioni për krijimin e një Hapësire Qytetase ku çdo objekt, hapësirë apo ambient publik respektojnë një sërë kushtesh, ku përfshihet: funksioni parësor i objektit, vlerësimi i çdo qendre kundrejt peshës që ajo gëzon në qytet dhe alternativat në zgjedhje, që i ofrohen banorëve në raport me kërkesat e tyre personale.

Në këtë mënyrë mëtohet të ristrukturohet i tërë qyteti, duke sjellë krijimin e potencialeve të reja për zhvillim, mirëmbajtjen dhe rritjen e rëndësisë së qendrave aktuale, rritjen ekonomike e turistike, për përmirësimin e jetës sociale. Tetova Skeleton City, një qytet i riformuar nga rivlerësimi i "bërthamave/ qendrave" të vjetra, në mënyrë të tillë për të formuar një organizëm më të shëndetshëm.







6

# Rrjetat Sociale

Ina Musai



**Sinkretizmi** është përpjekja për të **pajtuar besime të kundërta**, shpesh duke përdorur praktika mendimi të shkollave të ndryshme. Ky term do të thotë **"kombinim"**. Sinkretizmi mund të përfshijë **përpjekje për të bashkuar** dhe analoguar tradita të ndryshme tepër të **dallueshme dhe origjinale**, sidomos në teologji dhe mitologjinë e besimit.



## Rrjetat sociale/Oda urbane

Ina Musai

### Nga elementet e fjetura në katalizatorë socialë

Tetova, një qytet kompleks për sa i përket etnisë, fesë, vendndodhjes, duket se ka shumë energji brenda vetes. Ky plan vizion synon të nxjerrë në pah gjithë këto potenciale energjike të fshehura nën pëlhurën urbane të Tetovës. Kompleksiteti i kontekstit social është nxitja kryesore për t'i dhënë zhvillim këtij vizioni, duke tentuar drejt një hapësire publike të krijuar nga ky rrjet potencialesh.

Ky rrjet do të ndihmojë si katalizator në lidhjen e të gjitha hallkave të forta që e përbëjnë Tetovën. Duke filluar që nga historia e saj me pazarin e rëndësishëm, kultura dhe natyra, do të jenë ato që do krijojnë një zinxhir elementesh gjeneruese energjike, që do t'i japin qytetit shkëlqimin e dikurshëm.

Gërmimi i historisë do të jetë pika më e fortë mbështetëse për këtë vizion zhvillimi. Nga ky aspekt historik zbulohet se përjetimi i hapësirës publike është thelbësor për qytetin. Për të zhvilluar më tej këtë koncept duhet të lidhen të gjitha hallkat sociale të Tetovës, siç janë pazari, njësitë formuese të qytetit me karakter social, kullijet dhe Çarshia si pjesë urbane me karakter tregtar. Megjithatë, përveç këtyre elementeve sociale, si pazari që është dhe një nga më të rëndësishmit që nga lindja e Tetovës, ekzistojnë dhe elemente të tjera urbane, objekte të qytetit që kërkojnë rivlerësim përkatëse. Këto mund të ndahen në ky kategori të rëndësishme, elemente (objekte, hapësira etj.) që kanë humbur vlerën e dikurshme e që tashmë nuk kanë rëndësi për qytetin dhe elemente (objekte, hapësira etj.) që mbartin potencial ekonomik, social, kulturor e që gjenerojnë lëvizje, energji në qytet. Këto dy kategori mund të quhen ndryshe **elemente të fjetura dhe gjeneruese**. Rëndësia e zbulimit të tyre qëndron në faktin se hallkat sociale të qytetit duhet të vihen në kontekstin urban real. Duke qenë të tilla e të gjeneruara nëpërmjet hapësirës, krijohen evente sociale, që për qytetin kanë rëndësinë e katalizatorëve urbanë. Këta katalizatorë më pas i përshtaten jetës reale në vend dhe marrin të njëjtat karakteristika si kontekst social. Kështu, krijohen hapësira të reja publike, që synojnë drejt socializimit e ndërveprimit në gjithë qytetin.

### Lindja e energjive në rrjeta

Tetova si qytet i zhvilluar në histori ka pësuar shumë ndryshime dhe mbi të kanë ngelur gjurmët e kohës. Duke gërmuar mbi këto gjurmë tregohet se prania e lumit ka qenë thelbësore në vetekzistencën e qytetit. Pranë lumit Shkumbin mendohet të ketë ekzistuar bërthama e parë e qytetit. Kjo bërthamë me kalimin e kohës ka filluar të zbresë në drejtim të fushës, duke mbajtur si aks lumin. Gradualisht qyteti e humb karakterin e tij terpcëntrik dhe kjo bërthamë shpërhapet, duke i dhënë zhvillim gjithë kësaj pjese të qytetit. Gjatë periudhave të ndryshme kohore e pushtimeve të ndryshme, një nga gjurmët më të rëndësishme të Tetovës ka qenë dhe sistemi administrativ me anë të kullijeve. Kullijet ishin njësi administrative në kohën e Perandorisë Otomane. Ato shërbenin për të krijuar qytete nga e para ose

për t'i dhënë atyre zhvillim në pjesë të caktuara. Si njësi qytetformuese, brenda tyre duhet të ndërtohej zakonisht një çezmë publike, një xhami, një furrë buke, një hamam dhe duhet të kishin pjesën tregtare të zanatçinjve. Kjo rrugë tregtare ku të gjithë zanatçinjtë shisnin prodhimet e tyre, quhej Çarshi. Përveç se Pazar, kjo rrugë shërbente dhe si hapësirë për socializim midis njerëzve dhe si ishull sigurie e çlodhjeje për sistemin e transportit me karavane gjatë Perandorisë Osmane. Çarshia ishte dhe një vendtakim i rëndësishëm përveç Pazarit.

Pazari mund të jetë pika më e fortë ku mund të prekim Tetovën për të kuptuar vetekzistencën e saj. Itinerari i hershëm i karavaneve shndërrohet bashkë me historinë, por ruan ende traditën e dikurshme të Çarshisë së Epërme që për Tetovën do të thotë shumë. Ekzistenca e saj nxit hapësirë mendimi në lidhje me jetën sociale të këtij qyteti.

## Qyteti organik dhe ideal

Megjithatë duke lënë mënjanë zhvillimin historik, e duke gërmuar mbi kontekstin urban zbulohen shumë elemente të rëndësishme, të fshehura në qytet. Ajo që përbën kodin formues të qytetit në tërësi është mbivendosja e gjurmëve të qytetit organik ekzistues deri më sot, me ndërhyrjet e një kohe të caktuar të qytetit ideal. Në linjat territoriale dhe pëlhurën e Tetovës dallohen të gjitha gjurmët e qytetit të shtresëzuara në kohë. Secila periudhë, çdo pushtim dhe regjim politik ka qenë përcaktues në zhvillimin urban të Tetovës.

Ato elemente që e bëjnë të veçantë dhe më interesant konfiguracionin e qytetit janë gjurmët e tensionit midis ndërhyrjeve ideale njerëzore dhe ndërhyrjeve spontane. Të tilla ka shumë dhe mund të quhen **zona tensioni**. Por çfarë ndodh në këto zona tensioni?

Ky mund të quhet tension urban ku pëlhurat ndërhyjnë te njëra-tjetra duke shkaktuar mospërputhje me atë që vjen në vazhdim. Megjithatë, këto mospërputhje bëhen shkas për të lindur energji të reja në qytet.

## Tensionet midis pëlhurave, bashkekzistenca dhe lindja e energjive në rrjeta (sforcimet)

Në pëlhurën e Tetovës lexohen dhe ato hapësira, të cilat ndodhen në nyjet më të rëndësishme të qytetit. Kjo nënkupton se këto janë hapësira të veçanta, të cilat duke qenë po ashtu dhe nyje urbane, shërbejnë si nxitëset e para për lindjen e energjisë në qytet. Gjithë ky gjenerim nxit në kërkimin e asaj energjie të fshehur, që gjendet brenda kontekstit, por që ende nuk lexohet. Duke marrë një këndvështrim të teorisë së Aldo Rossi-t mbi elementet, të cilat ai i quan patologjike, dhe që në fakt janë elemente që nuk përjetojnë më në kohë, por qëndrojnë të fjetura, kuptojmë se të tillë në këtë qytet mund të gjejmë mjaft. Po kështu dhe elementet gjeneruese e mbase në to gjendet vërtetë energjia e munguar në këtë moment.

## Elementet patologjike (të fjetura) dhe gjeneruesit urbanë


Në të vërtetë, elementet patologjike janë elemente urbane, objekte të ndryshme, hapësira që kanë një vlerë të caktuar e që në një kohë të shkuar janë përjetuar në qytet, por tashmë qëndrojnë të fjetura duke mos pasur rëndësinë e dikurshme. Ndërsa elementet gjeneruese janë elemente urbane njësoj si të parat, të cilat gjatë gjithë kohës gjenerojnë energji në qytet dhe shërbejnë si pika referimi për qytetin. Të dyja këto lloje klasifikimesh të elementeve bëjnë të kuptohet se me siguri aty është fshehur ajo energji, që ka ekzistuar që në lindjen e qytetit. Në rastin e evidentimit të këtyre elementeve të fjetura, ajo që tregon vërtetë për thelbin e Tetovës është fakti se edhe pse të papërjetuara disa prej tyre detyrimisht mbeten gjeneruese. P.sh., objekte të tilla, si hamami mund të konsiderohen elemente gjeneruese ose si shembulli më i mirë i këtyre elementeve të fjetura (patologjike) të shndërruar në gjenerues, kjo për arsyen se ky objekt ende ruan të njëjtat vlera dhe ende përjetohet nga njerëzit edhe pse me funksion të ndryshëm, tashmë atë të galerisë së artit.

Qendra është elementi kyç, i cili deri diku mban të lidhur gjithë energjinë në qytet. Kjo pjesë e Tetovës mbetet gjithmonë gjeneruese për shkak të statusit urban që ka, por realisht gjenerimi i energjisë së vërtetë i një jete sociale, i një zhvillimi ekonomik aty, mungon. Duke u nisur nga ky problem kyç kuptohet se elemente të tilla Tetova duhet të ketë shumë, por që qëndrojnë të fshehura. Realisht ata duhet të jenë si rrjetë të lidhura fort, por jo të dukshme. Nxitje e kësaj ideje bëhet vetë konteksti social i Tetovës, prania e dy popullsive dhe e besimeve të ndryshme shikohet si gjenerues i një energjie të re. Të gjitha këto cilësohen si katalizatorë urbanë e bëhen shtysë për zbulimin e gjithë këtij rrjeti të fshehur.

## Rrjeti i fshehur i hapësirave publike

Një çështje e rëndësishme, që lidh ngushtë kontekstin urban me jetën sociale është hapësira publike dhe përjetimi i vërtetë që kanë njerëzit për të. Nga një vizitë sado kalimtare e që mund të ketë çdokush në Tetovë menjëherë do të nxitet të shikonte hapësirat e pamata të gjelbra që detyrimisht bëhen hapësira potenciale publike. Duke pasur një kontekst social tepër kompleks kuptohet se i gjithë ky potencial hapësinor publik shtresëzohet në të njëjtën mënyrë në përjetimin e vet.

Kështu që gjithë ky rrjet i fshehur ndahet sipas funksionit social, etnik dhe fetar. Të gjitha këto ndarje që mund të duken si barriera për shoqërinë ndihmojnë në një kompleksitet social, i cili shërben si katalizator urban. Duke u bashkuar të gjitha këto rrjeta ndihmojnë për të formuar një tërësi hapësinore të Tetovës, të cilën qyteti nuk e ka shikuar më parë si potencial autentik zhvillimi. Kjo tërësi hapësinore do të shërbejë si mbajtëse e shumë njësive funksionale, por me variacione të papritura. Kjo do të thotë se në rastin e këtij konteksti kaq kompleks social, këto njësi do të kenë funksion socializues në qytet. Këto hapësira marrin trajta të ndryshme, por nisur nga kultura shqiptare, ato marrin karakterin e odave tradicionale shqiptare.



Ky koncept mund të zhvillohet më tej duke u nisur nga studimi i kësaj hapësire interieri, por që në këtë rast odat përjetohen të lira në natyrë dhe në mjedise urbane. Kjo hapësirë e re publike trajtohet e tillë për t'u përshatur me shoqërinë tetovare. Duke ruajtur në këtë mënyrë privatësinë dhe mbylljen që ka shoqëria, këto oda janë hapësira ideale për të zhvilluar një hapësirë publike të këtij lloji.

Duke parë karakteret e veçanta të këtyre hapësirave, këto oda mendohet të jenë të grupuara dhe secili grup të jetë ndryshe nga tjetri. Aktivitet sociale brenda tyre do të jenë ato që do të bëjnë dallimin e këtyre shesheve urbane me karaktere të ndryshme.

## Etapat e zhvillimit të qytetit në kohë

Një këndëvshtrim i etapave të zhvillimit të qytetit dhe shtrijes së tij në periodha të ndryshme kohore

Bërthama e parë nga ku dhe ka marrë jetë qyteti i Tetovës mendohet të ketë qenë pranë lumit Pena (Shkumbin). Ky lumë ka qenë burimi i jetës për qytetin. Ai përshkohej nga itinerari i karavaneve tregtare, që arrinte nga Stambolli deri në Prizren e më tej. Tetova ka pasur konfiguracion linear për shkak të pozicionit të saj midis Gostivarit dhe Shkupit.

Bërthama e dytë e lindur në qytet është ajo që ndikoi në zgjerimin e qytetit në anën tjetër të lumit, e cila thithte edhe karavanet nga Perëndimi. Megjithatë, ende ruhej i njëjti itinerar tregtar tepër i rëndësishëm, Jug-Veriperëndim, i cili mbante gjallë jetën në qytet. Ajo që e dallon thurjen e pëlhurës së qytetit në fillesat e veta është natyra radiale, që ai merr duke e ndryshuar linearitetin e mëparshëm. Linjat e para radiale qytetformuese vijnë si pasojë e ndjekjes së linjave të territorit. Në këtë rast radialet e para ishin ndjekëset e rrëkeve të lumenjve.

Në etapën e tretë qyteti ruan të njëjtin konfiguracion dhe pjesa e kodrës është ajo që bëhet më e lidhur me qytetin, me anë të dy itinerareve të rëndësishme. Itinerari i parë lidhte me Prizrenin dhe tjetri me kalanë e ndërtuar gjatë shek XVII.

Etapa tjetër tregon shtrirjen e qytetit edhe sot. Bulevardi më i rëndësishëm, Ilindenska është i ndërtuar tashmë dhe po ashtu bërthama më e rëndësishme e qytetit. Në këtë moment krijohet kjo bërthamë e fortë rrëzë kodrës në ndërprjen e itinereve dhe lumit. Prej këtij lundin dhe radialet, të cilat çojnë në shtrirjen e qytetit drejt fushës. Në këtë kohë lind nevoja e gjysmunazave, meqë qyteti nuk ka më karakterin e dikurshëm linear.

Në kohën kur qyteti ka marrë formën e tij, ndërhyrjet e periudhës komuniste me elementë të tjerë dhe dëmtimi i pëlhurës organike, janë ato që krijojnë mbivendosje të qytetit ideal mbi atë organik.

Në ditët e sotme qyteti ka arritur në një stad të tij zhvillimi dhe shtrirja tij arrihet deri tek itinerari i rëndësishëm drejt Shkupit, përgjatë të cilit shtohet një shtresë tjetër organike informale.



## Bërthama e qytetit, lëvizja dhe zhvillimi i saj shpërhapur kudo


Bërthamat e qytetit vihen re të jenë përqendruar pranë lumit dhe dallohet sesi ato kanë zbritur drejt fushës, duke ruajtur lumin si aks. Më pas bërthama është ajo që ndikon në shtrirjen e qytetit dhe shpërhapjen e tij drejt fushës, duke u zgjeruar kështu në kohë dhe hapësirë.

## Kullijet, sistemi administrativ

Tetova ka një gjurmë të fortë qytetformuese gjatë periudhës otomane. Sistemi otoman i asaj kohe përcaktonte si njësi ndarëse administrative në qytet, kullijet. Këto funksiononin dhe si katalizatorët e parë për lindjen e qyteteve, po ashtu dhe për zhvillimin e tyre.

Kullijet përfshinin në territorin e tyre ndërtimin e xhamive, furra buke, hamame, çezmat, zonën tregtare të zanatçinjve etj.

Kryqëzimi i lumit dhe rrugës tregtare të hershme kanë qenë përcaktuesit e qytetit dhe aty pranë duhet të ketë qenë pjesa më e rëndësishme ku bëheshin shkëmbimet tregtare. Prej këtij funksioni edhe sot mbetet emri Çarshi. Ajo që dallon është se pazari ka qenë tepër i rëndësishëm në zhvillimin hapësinor të qytetit. Me lëvizjen e bërthamave shohim dhe spostimin e pazareve, dhe sot pazari ndodhet aty ku qyteti po pëson zhvillimin më të madh.



### Qyteti organik dhe ndërhyrjet ideale në pëlhurë

Në linjat territoriale dhe pëlhurën e Tetovës dallohen të gjitha gjurmët e qytetit të shtresëzuara në kohë. Secila periudhë, çdo pushtim apo regjim politik ka qenë përcaktues në zhvillimin urban të Tetovës. Ato që e bëjnë të veçantë dhe më interesant konfiguracionin e qytetit janë gjurmët e tensionit midis ndërhyrjeve ideale njerëzore dhe atyre organike njerëzore. Këto zona të quajtura zona tensioni nënkuptojnë pjesë të pëlhurës urbane, që dëmtohet duke mos u zhvilluar ashtu sic ka lindur në mënyrë organike, por duke ndryshuar drejtimin e zhvillimit të saj. Hapja e bulevardeve në ato pjesë të qytetit, të cilat kanë lindur shumë spontanisht, mund të konsiderohen si zona tensioni.

Një shembull i këtij lloji është dhe bulevardi Ilindenska, i cili në një farë mënyre ka dëmtuar pëlhurën urbane dhe mënyra sesi ai mbyllet në drejtim të verilindjes së qytetit jep një shembull të një zone tensioni. Megjithatë, vazhdimi i mbylljes së tij me rrugë të lindura organikisht tregon se pëlhura urbane e vetëkrijuar sërish përpiqet të ekzistojë mbi këtë ndërhyrje ideale që i është bërë asaj.

### Hapësirat nrye

Nga ky lloj konteksti urban nxjerrim në pah elementet e tij përcaktuese, prej të cilave janë dhe hapësirat nrye në qytet. Këto hapësira bëhen gjeneruese të qytetit dhe nxisin përdorimin e potencialit hapësinor të Tetovës.

Duke përdorur gjenerimin e elementeve të qytetit dhe duke marrë të njëjtën linjë mendimi me atë të Aldo Rossit, kuptojmë se qyteti mban të






fshehur dy lloje elementesh. Elementet të cilët ai i quan patologjike, në fakt, janë objekte të ndryshme në qytet ose hapësira, por që nuk përjetojnë më nga banorët. Shembuj të elementeve të fjetura ose ndryshe të quajtura nga Rossi patologjike, kemi në rastin e qendrës së qytetit. Vetë kjo hapësirë dhe qendra tregtare e ndodhur, përcaktohen në këtë rast si të papërjetuar më. Qytetarët nuk ndiejnë vlerën e tyre të dikurshme dhe energjinë që ato kanë rrezatuar më përpara.

Si element gjenerues mund të përcaktohen Hamami, i cili edhe pse dikur ka pasur një funksion dhe ka përcjellë energji në qytet, sot i shndërruar funksionalisht, vazhdon të ketë rolin e tij, duke ekzistuar si gjenerues në qytet. Të dyja këto lloje klasifikimesh të elementeve bëjnë të kuptohet se me siguri aty është fshehur ajo energji, e cila ka ekzistuar që në lindjen e qytetit. Ajo që tregon vërtetë për thelbin e Tetovës është fakti se edhe pse ato nuk janë të përjetuara disa prej tyre mbeten ekzistuese e aktive në qytet.


Konteksti social bëhet gjithashtu shumë i rëndësishëm për t'u lidhur me kontekstin urban. Në gjetjen e elementeve të fshehura në qytet të atyre të papërjetuara më, por gjeneruese, ndërtohet një rrjet i tërë elementesh, që thurin pëlhurën urbane të Tetovës. Rrjeti i elementeve sociale shërben si katalizator urban. Përdorimi i hapësirës si potencial zhvillimi kërkon një përcaktim më të mirë të karakteristikave, që këto hapësira kanë.



elementët e fjetur




elementët gjenerues









hapësirat e gjelbra

# Rrjetat Sociale, Gjeneruese të Qytetit





### Legjenda

-  pikat e kohezionit
-  hapësirat të përbashkëta të lira
-  hapësira publike fetare\_xhami
-  hapësira publike fetare\_kisha
-  hapësira publike etnike
-  hapësira publike etnike\_të llojit ODA

## Rrjetat sociale në qytet

Kompleksiteti social në Tetovë nxit drejt një sh-trësëzimi të hapësirave publike sipas karakteristikave dhe rrjetave sociale që ato përfaqësojnë. Sipas ndarjes së këtyre hapësirave kemi, pika të kohezionit që nënkuptojnë vendtakimin rastësor të gjithësecilit dhe përjetimin e këtij fakti gjithmonë në qytet. Hapësirat e përbashkëta të lira përfaqësojnë ato hapësira të përjetuara nga e gjithë popullsia në qytet, por që realisht janë hapësira që nuk kanë karakteristika të caktuara. Hapësirat publike fetare të të dyja besimeve përfaqësojnë jetën sociale që bëhet në këto objekte kulturi dhe sesi banorët e ndajnë hapësirën sociale së bashku. Hapësirat publike përfaqësojnë gjithashtu territoret ku banojnë popullsia shqiptare dhe ajo maqedonase, duke kuptuar në këtë mënyrë elementet e të dyja kulturave të ndryshme dhe sesi ata e përjetojnë hapësirën publike. Të gjitha këto përcaktime të hapësirës i japin larmi jetës urbane tetovare, duke mos u bërë pengesë për përjetimin publik të hapësirës në qytet.

### Oborri i brendshëm nxitës i hapësirës publike në mjedisin privat

Duke qenë se aspekti social mbetet tepër influencues në kontekstin urban, këto hapësira publike marrin karakterin e odave tradicionale shqiptare. Ky koncept mund të zhvillohet më tej duke u nisur nga studimi i kësaj hapësire interieri, por që në këtë rast odat përjetojnë të lira në natyrë. Kjo hapësirë e re publike trajtohet e tillë për t'u përshtatur me shoqërinë tetovare. Duke ruajtur në këtë mënyrë intimitetin dhe mbylljen që ka shoqëria ndaj publikut të gjerë, këto oda janë hapësira ideale për të zhvilluar një jetë publike të këtij lloji.

### Çfarë përfaqëson oda tradicionale në kontekstin urban?

Oda urbane shprehet si një koncept i ri për riformulimin e hapësirës publike. Nga oda tradicionale kuptojmë kompozicionin e saj dhe çdo detaj përbërës, duke i kthyer këto në funksione urbane.

Në këtë mënyrë arrihet që shumë nga eventet sociale që përjetojnë në mjedise të mbyllura për shkak të kulturës, tashmë të jetë e mundur që ato të kenë pjesën e tyre në këto sheshe.



- elementet e odes:
- \_sofra
  - \_divani
  - \_perde
  - \_llampa e vajgurit
  - \_tavani i punuar
  - \_dyshe meja me qilim

ODA URBANE



KARAKTERISTIKAT E ODAVE NE QYTET



\_gjelberimi\_afersia me qendren\_karakterit i mbyllur i hapësirave\_prania ne zonen industriale\_afersia me lumin\_ekzistenca e nje xhamie si qender\_tekstura e ndryshme dhe e ngjajshme



## Nivelet e odave

Duke qenë një koncept me karakter disi kompleks, këto oda mund të klasifikohen në nivele të ndryshme.

### Odat sipas parcelës

Në këtë mënyrë bëhet një ndarje e odave sipas parcelës në të cilën ato ndodhen, duke kuptuar kështu edhe shtrirjen e tyre në një zonë të caktuar të qytetit.

### Dendësia



Dendësia është po ashtu faktor i rëndësishëm në zona të caktuara dhe po ashtu të aktivitetit të përditshëm në të.

### Vendndodhja

Mënyra sesi këto oda do të organizohen në hapësirë duhet bërë dhe sipas vendndodhjes së tyre, duke pasur parasysh dhe faktin e afërsisë me ndërtesa të tjera, çka mund të jetë thelbësore për ekzistencën dhe eventit brenda odës.

### Itinerarët

Në mënyrë që të gjitha odat të funksionojnë si mikroorganizma brenda qytetit, duhet që midis tyre të ketë një lidhje të fortë. Por itineraret lidhëse që janë të nevojshme në këtë rast, janë të tilla që nuk funksionojnë si itinerare të zakonshme rrugë kalimi. Këto do të quhen itineraret e kohës së lirë, me funksionin e promenadës, ku qytetarët mund t'i shfrytëzojnë për të pasur mundësinë e vizitës së odave. Në këtë rast itineraret do të jenë nxitëset e hapësirës publike në oda, duke u bërë kështu njësi matricore që kompozojnë itinerarin me aktivitet social.



## Oda funksione me anë të teksturës



## Oda si mbartëse e eventeve




Hapësirat e lira që përjetojnë ndonjë aktivitet social, janë ato të cilat shndërrohen në këto oda urbane që bëjnë dhe hapësirën publike në qytet.

Përmirësimi i këtyre shesheve urbane në konceptin e ri të odës, mundëson krijimin e një hapësire publike të jetuar, duke u bërë gjithëpërfshirëse në një rrjet social të gjerë në qytet.

Këto oda vendosen në kontekstin hapësinor ekzistues e kështu ndërhyrjet e vogla mund të jenë tepër domethënëse për jetën në vend. Mobilimi urban i këtyre shesheve do të jetë më pas katalizatori për rritjen e cilësisë prej tyre.

Këtu paraqitet një situatë nga pjesa e qendrës së qytetit në bulevardin Ilindenska. Ajo që duhet kuptuar në këtë rast është ideja sesi rruga mund të përjetohej si këmbësore edhe në rastet kur nuk është e tillë, si edhe ndryshimi i përjetimit të hapësirës gjatë orëve të ndryshme të ditës.

## Oda urbane si kornizim i hapësirës publike



Jo vetëm odat do të jenë sheshe urbane ku përjetohet hapësira publike, por dhe itineraret lidhëse të këtyre odave do të jenë po aq të rëndësishme. Duke qenë në të njëjtin funksion, në këtë rast itinerari bëhet pjesë publike e lëvizshme dhe oda mbetet njësi matricore përbërëse e tij.

Për shkak të vendndodhjes së tyre, odat kanë attribute hapësinore të ndryshme dhe kjo është ajo që e plotëson rrjetin e tyre në qytet. Odat pranë lumore do të jenë sheshe urbane me karakterin më natyral brenda qytetit dhe do të risjellin sërisht lumin si diçka që përjetohet prej së largu. Ajo që paraqitet në këtë kolazh është një event real por i vendosur në kontekstin e Tetovës, duke i dhënë qytetit një frymë tjetër perëndimore.







Një hapësirë publike shumë e rëndësishme e që ka qëndruar e tillë në të gjitha kohët, është pjesa e pazarit e përjetuar nga të gjithë banorët. Rruga e butikeve është një ndër ato që gjithmonë ka funksionuar si e tillë. Tashmë kësaj rruge mund t'i jepet një tjetër imazh, duke i ruajtur identitetin dhe duke i veshur asaj gjithashtu një karakteristikë tjetër që mund të ketë oda urbane.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i qytetit të Tetovës është dhe industria, e cila ka luajtur një rol të madh në ekonominë e qytetit. Pjesa më e rëndësishme e fabrikës së prodhimit të tekstileve tashmë e lënë pas dore i rikthehet funksionit publik dhe eventit social. Rehabilitimi i kësaj zone, si edhe vënia sërish në përdorim e fabrikës, mund të ishin pjesë të rëndësishëm të plotësimit të një ode urbane me karakter industrial.







### Situatë nga odat urbane me karakter fetar


Këtu tregohen pjesë nga jeta e brendshme e këtyre objekteve të kultit. Ajo që është e dukshme, është përjetimi i këtyre hapësirave nga të gjitha moshat. Sjelljet e njerëzve të cilët shfaqin interesa të ndryshme janë pjesë e itinerareve të ndryshme. Megjithatë, ato bashkohen në të njëjtin vend, duke treguar kështu se kërkojnë të jenë pjesë e hapësirës publike pavarësisht karakterit që merr ajo.



## A MIXTURED DESTINATION

Ajo që synohet në këtë rast është transparenca e këtyre hapësirave publike me karakter fetar dhe lejimi i publikut të gjerë të marrë pjesë në të tilla evente sociale, duke bërë të mundur që kultura, tradita dhe besimi fetar të mos jenë pengesë e bashkimit të njerëzve dhe socializimit e gjithë qytetit me vetveten dhe me të tjerët.





Në këtë rast përjetimi i hapësirës në këto oda me karakter fetar është edhe më i larmishëm. Megjithatë, duke marrë shkas nga aktiviteti social që ndodh në to, këtyre odave u jepet një nxitje, në mënyrë që këto aktivitete të jenë joshëse për gjithë njerëzit.







Karakteristikë e shoqërisë tetovare janë dhe “kafanat” e lagjeve të shpërndara nëpër qytet. Ato janë një shenjë shumë e mirë socializimi dhe uniteti midis njerëzve.

“Kafenetë e lagjeve” mund të transformohen në oda me karakter kafenesh, ku sërish të ruhet e njëjta traditë e vetëshërbimit. Megjithatë, ato mund të kenë një mënyrë ndarjeje sipas grupmoshave, duke pasur kështu dhe një larmi të imazhit të tyre e të eventit social që mund të ndodhë në to.

## Oda e hapur e Tetovës

Qendra e qytetit ka qenë pika më e rëndësishme, e përshkruar kështu dhe si element i papërfjetuar tashmë, po ashtu edhe gjenerues. Në këtë rast, qendra kërkon rivitalizimin e saj të plotë. Kolazhi i qendrës në këtë rast synon imazhin e ri të funksionit ekonomik, social dhe urban që duhet të ketë qendra e Tetovës. Megjithatë, mes gjithë këtij utopizmi urban në qendër të qytetit, ajo që lexohet është energjia që shpalos gjithë qyteti dhe njerëzit, si edhe mënyra sesi ata e përjetojnë këtë hapësirë që shërben edhe si publike.

Imazhi i ri i qendrës jepet i tillë duke e trajtuar këtë hapësirë të madhe publike të qendrës si odë urbane që qëndron në mes gjithë këtij rrjeti odash me karakteristika të ndryshme.



CITY CENTER AS AN ODA







### City in search of an author

*"Gods of two species protect the city of Leandra". Some "follow the families". The others "belong to the house". "We will call the first one Penates and the other Lares. The true essence of Leandra is subject of endless debate. The Penates believe they are the city's soul, even if they arrived last year, and they believe they take Leandra with them when they emigrate. The Lares consider the Penates temporary guests, importunate, intrusive; the true Leandra is theirs."*

Tetovo is a city with a lost and separated history. If you ask to the inhabitants some informations about the old city, everyone narrates a different version. Some tell about an ancient ottoman part near the river, other tell about the orthodox quarter near Cyril and Methodius church. But the most part of people answers with an empty look : "I don't remember." And the past seems to dissolve along the river or into the narrow streets of the hill. It is a two names-city and with a complex identity, still to define. It is difficult to build a future on a contested memory but it is necessary to look beyond and to imagine the future Tetovo. It doesn't seem exist, as elsewhere, an image in which all inhabitants can relate to when they think about their city.

Tetovo has two universities, but it isn't an university city: the lack of services, the absence of entertainment places or meeting spaces for the students. There are beautiful mountains and artistic and historical buildings but Tetovo is not a tourist destination. There is a large factory area but it can not be called an industrial city. The city is lacking of a distinctive vocation and it feels a kind of suspension and wait.

The mountain of Popova Shapka, the spring of Banja, the painted mosque, the churches and Ecolog building. The citizens speak about these elements with pride. It is necessary to start from here to find a new urban identity. The important thing is that this image of Tetovo is expression of all communities inhabiting the city: Albanian people, university students, the Macedonians, the old people ...


Along the Illyria way, a lively street full of shops and cafes you can arrive in the great square, then you continue your walk along the Ilidenska street, a place of great change and renewal. In the last years Tetovo has seen a great urban growth and a big sprawl but the city center continues to be the most popular, most loved part of the city. Services are concentrated in the central area and some peripheral areas suffer from this urban imbalance.

The inhabitants request near to home services, an efficient road system, an improvement of public transport. In the contemporary urban society mobility is certainly a necessary condition to accede to goods and services and "the freedom of movement" is an important aspect for a full and active participation in society. Accessibility is an fundamental aspect to rethink the city in terms of spatial equity . Meeting people, asking them what they like or what they would like to change is a starting point to learn to see the city from another point of view: that of the persons who live every day in this city. When we asked to the inhabitants which would be the first action that they undertake if they were the mayor of Tetovo, they spoke about: green spaces, cleanliness, infrastructure, new water distribution system and new architectures. These voices are like little touches of color to paint the Tetovo that will be.


1. Which are three reasons you like living in Tetovo?




2. Which places do you visit more frequently in the city?



3. What do you miss more from Tetovo when you leave (for a long period of time or short one)?




4. Which building you like best in Tetovo?




5. Which building would you like to erase from Tetovo?




6. What would you like to change in the city?




7. Which are three main issues that you are concerned more about the city?




8. Which places do you visit more during free time?



9. Which are the most important neighbourhoods (the most visible parts) the city?




10. Which is the most beautiful street of Tetovo? Why?







11. Which is the most potential natural element of Tetovo?



12. Do you know anything about the history of the city? Which has been its origin?



13. Which do you think can be the main economy in the city and what do you think about the ex-industrial areas?






14. Which would be the first three actions that you undertake if you were the mayor of Tetovo's municipality?



15. Free comment.. if you have something to say.

# TETOVO 250 INTERVIEWS

home



## Permbledhje Ekzekutive

Në periudhën Janar-Korrik 2010, Komuna Tetovë Maqedoni dhe Instituti Kërkimor Shkencor IKSH i Universitetit POLIS, Shkolla Ndërkombetare e Arkitekturës dhe Politikave të Zhvillimit Urban, në bashkëpunim me Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, iniciuan një proces vizionimi për zhvillimin urban të qytetit të Tetovës.

Vizionimi përfshiu praktika dhe instrumente të përthithjes së mendimit qytetar dhe konsultimit me persona e komunitete, si edhe institucione kryesore lokale e kombëtare. Procesi përfshiu edhe studimin e dokumenteve të politikave rajonale/ kombëtare të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, shoqërisë dhe ekonomisë, sidomos planin e Zhvillimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë. Studimi i shembujve dhe përvojave të ngjashme ndërkombetare ka qenë gjithashtu pjesë e këtij procesi.

Dokumenti në vijim më shumë se sa një plan urbanistik është një vizion inspirues strategjik, që bashkë me Termat e Referencës, të cilat po hartohen nga Zyra për Urbanizëm e Komunës Tetovë do të përbëjnë dokumentat bazë për hartimin e Planit Rregullues të Tetovës, i cili do të hartohet në një fazë të dytë përmes një gare publike. Vizioni "Universi Tetova" ndërton mbi potencialet e pasura dhe të palexuara të qytetit, duke fuqizuar potencialet dhe përkthyer problemet në avantazhe.

Disa nga rekomandimet kryesore të këtij vizioni të cilat mund të përcillen edhe në fazën e hartimit të planit rregullues janë të shprehura më poshtë:

1. Rilindja e Tetovës do të vijë nga eksplorimi i plotë i vlerave territoriale dhe historike, pjesë e të cilave është vetë Tetova. Shfrytëzimi i pozitës mjaft të favorshme gjeografike dhe strategjike të Maqedonisë dhe të Tetovës në rajonin e ballkanit, dhe sidomos në lidhje me disa nga korrido-

ret strategjike rrugore në këtë rajon me impakt europian gjeneron disa projekte të rëndësishme. Fuqizimi i avantazheve të korridoreve mbareuropiane 8 dhe 10, është një motiv i madh inspirues për vetë të ardhmen e qytetit të Tetovës. Rigjallërimi i impaktit të korridoreve historike (via Egnatia dhe korridori otoman i shek. XVII-XIX) në kushtet e reja gjeopolitike të rajonit është një tjetër epërsi. Këtu spikat lidhja e Tetovës me Prizrenin me anën e një projekti infrastrukturor-mjedisor të veçantë përmes malit të Sharrit, i cili kërkon koordinim edhe me planin strategjik/hapësinor të Republikës së Maqedonisë dhe të parkut të Sharrit, hartuar nga autoritetet e Republikës së Kosovës.

2. Forcimi i marrëdhënieve ndër-urbane në hapësirën rajonale Gos-tivar-Tetovë-Shkup-Kumanovë, dhe sidomos të metropolit të Maqedonisë Shkup-Tetovë. Lidhja e tyre me një projekt treni të shpejtë, që integron format e ndryshme të transportit ajror ndërkombëtar (aeroporti); transportit hekurudhor rajonal-lokal, dhe ato rrugor (autostrada), me transportin publik urban-qytetës në Tetovë dhe ndër-urban (Pollog), do të krijonte një situatë ëin-ëin për çdo qendër të banuar, dhe në mënyrë të veçantë për Tetovën. Kjo do të rriste nga ana tjetër efikasitetin e shërbimeve/ infrastrukturës, kompetivitetin e metropolit të Maqedonisë dhe të ekonomisë së gjithë vendit, kundrejt metropoleve/vendeve të tjera në rajon. Themelimi i një autoriteti koordinues metropolitan që vizionon/ndjek/zbaton projektet e kësaj shkalle është i domosdoshëm. Rikonceptimi dhe modernizimi i terminalit hekurudhor të Tetovës, jo vetëm materializon këtë ide, por gjithashtu ndërton një imazh të ri modern për qytetin, duke funksionuar si një "hub" lidhës edhe për transportin publik qytetas.

3. Tetova ka nevojë për një skemë të re të transportit publik qytetas dhe gjithë levizjes së njerëzve, mallrave dhe makinave brenda saj. Vendosja e zemrës historike të qytetit nën një regjim këmbësor, kombinuar me qarkullimin e kufizuar të transportit publik do të rrishte shanset e konservimit dhe aksesit më të mirë për turistët. Investimi në përmiresimin e akseve të qarkullimit brenda në qytet, si dhe të portave lidhëse me Shkupin, Gostivarin, Popova Shapkan, Kaçanikun e Prizrenin, kombinuar me një sistem gjysëm-unazash Lindje-Perëndim rrit mobilitetin. Kjo kërkon gjithashtu integrimin me korridoret radiale të qarkullimit (qendër-periferi) me forma alternative lëvizjeje, si zonat këmbësore, rrugët për biçikletat, itinerare historike/turistike etj., të cilat do të rrisnin depërtueshmërinë dhe përshkrueshmërinë e mobilitetit duke e humanizuar. Terminali i qytetit, portat hyrëse (stadiumi, universiteti, teleferiku, kalaja) dhe qendra e qytetit, duhet të jenë referencat për këtë sistem të alternuar qarkullimi urban.

4. Potenciali i jashtëzakonshëm natyror: lumi Shkumbin plot energji; mali i pasur me gjelbërim, ujë e borë, janë një mundësi e pashfrytëzuar për Tetovën. Risjellja e lumit në jetën e qytetit si element mobilues urban, do të ndihmonte në krijimin e një mikroklimë më të balancuar ndaj diferencave dimër-verë. Pasuria ujore mund të përdoret me më kujdes për të ngritur një sistem të qendrueshëm me disa përdorime, përfshi atë familjar, publik, bujqësor etj. Natyra e bukur në verë dhe bora në dimër duhet të vendosen në funksion më të mirë të potencialit sportivo-turistik të Sharrit. Rehabilitimi i teleferikut dhe hoteleve në zonën turistike të sharrit e rrit më shumë këtë potencial. Përdorimi më i mirë i të gjitha burimeve natyrore, sjellë në zhvillimin e qytetit konceptin e “qendrueshmërisë” afatgjate, e cila influencon një kulturë të re jetese.

5. Rizbulimi i ‘kudit gjenetik’ të qytetit, ringjallja, përdorimi dhe fuqizimi i elementeve të trashëgimisë kulturore, historike e natyrore, është thelbësor në nisjen e një procesi rihvillimi urban, mbështetur nga komuniteti dhe sipërmarrja private. Kjo do të shërbejë në rikonfirmimin e identitetit të Tetovës, duke i dhënë asaj një imazh bashkëkohor, ku e kaluara dhe e ardhmja nuk janë në konflikt por plotësojnë njëra-tjetrën. Këto projekte synojnë “ringjalljen” e “elementëve të fortë”, si p.sh. “Sahat-kulla”; “Përgjat-lumsja”; “Pazaret, si pika të vërshimit rural në Tetovë” etj. Në këtë mënyrë plani rregullues do të garantojë kalimin e suksesshëm nga “esenca” vernakolare në gjendje urbane të vetëdijshme.

Arti i të ndërtuarit bazohet në një “gen paraekzistues”; “asgjë nuk vjen nga asgjëja” dhe pavaresisht nga ndryshime të mëvonshme, gjithmonë ruhen të qarta principet bazë të kaluara përmes arsyes dhe ndjenjave. Këto janë një “bërthamë” rreth të cilave koordinohen zhvillimet dhe varjacionet në lidhje me formën. Një nga okupimet kryesore duhet të jetë, zbulimi i origjinës së shkakut të parë.

6. Heqja dorë nga skemat tradicionaliste e moderniste që e copëzojnë qytetin, dhe promovimi i një koncepti dizjani/zhvillimi mbi bazën e “potencialeve maksimale të hapësirës urbane”, do të kontribuonte në zbutjen e diferencave dhe rritjen e cilësisë së jetës në qytet. Këto ide alternative, lidhur me leximin e hapësirës, çojnë në rikonceptimin e hapësirës publike përmes gjenerimit të projekteve, si ato të “Odate Urbane”, “Qytetit Skeleton”, apo “theksimit” të hapësirave aktualisht të degraduara përmes zhvillimit të “portave të qytetit” në hyrjet e tij etj. Këto projekte përveçse katalizatorë urbane të fuqishëm, janë edhe instrumenta që ndihmojnë në përmirësimin e imazhit të qytetit. Koordinimi me institucionet e trashëgimisë duhet të jetë garanci, në mënyrë që zhvillimet e reja të mos dëmtojnë historinë. Balancimi i zhvillimit në pjesën perëndimore të qytetit (zona universitare), me atë lindore (zona e stadiumit), do të ishte i nevojshëm për të shmangur disbalancat social-ekonomike dhe gjenerimin e trafikut të panevojshëm. Përdorimi i projekteve të reja infrastrukturore, jo vetëm në aspektin e funksionit, por edhe në krijimin e imazhit të ri, bëhet esencial.

7. Përdorimi i metodologjive të reja analitike dhe projektuale në shkallë urbane dhe arkitektonike... Vizioni i paraqitur, nënkupton që hartimi i planit rregullues duhet t’i hapë rrugën “leximeve alternative”, sikurse dhe “vetëtransformimit” të qytetit, i cili mund të nisë “së brendshmi” përmes zbatimit të projekteve konkrete me fuqi katalitike në shkallë urbane; dhe “së jashtmi” përmes zbatimit të projekteve katalitike me rreze territoriale. Kjo kërkon që leximi i qytetit dhe arkitekturës të konsiderohen si një tërësi/unitet i vazhdueshëm, si pjesë të një sistemi. Në lidhje me këtë, planit rregullues i del si detyrë të eksploroj hapësirat ligjore, për të përdorur metodologji jo tradicionaliste, të cilat akomodojnë këtë lloj transformimi.



private  
public  
recreation  
activities

inner space

"inside neighborhood"-space

alternative space

inner space

CULTURAL SPACE

public  
leisure time

"inside neighborhood" space

private property

TETOVE

SHKUP